

RAPORTI VJETOR I INSTAT

2024

Tabela e Përmbajtjes

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave	2
Lista e Shkurtimeve.....	3
I. Sistemi Kombëtar Statistikor	4
Parimet e statistikave zyrtare	4
Zbatimi i objektivave strategjikë 2022-2026 të Sistemit Kombëtar Statistikor	6
II. Zbatimi i PSZ për vitin 2024	8
III. Censet.....	12
Censi i Popullsisë dhe Banesave	12
Censi i Bujqësisë	13
IV. Veprimtaria e Institutit të Statistikave – INSTAT	14
Historiku, vizioni, misioni, vlerat	14
Integrimi Evropian	16
Koordinimi i Projekteve	25
V. Menaxhimi i Cilësisë.....	28
Ngarkesa e të Intervistuarve.....	30
VI. Teknologjia e Informacionit	35
VII. Komunikimi dhe Publikimet	36
VIII. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)	44
IX. Organigrama dhe baza ligjore	45
X. Veprimtaria e organizmave mbështetës të prodhimit statistikor	49
Veprimtaria e Bordit Drejtues	49
Veprimtaria e Këshillit të Statistikave	50
Veprimtaria e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave	51
XI. Zbatimi i Rekomandimeve	52
Zbatimi i rekomandimeve të Kuvendit	52
XII. Burimet financiare dhe njerëzore	57
Burimet Financiare	57
Burimet Njerëzore	60
Aneksi nr. 1 Të dhënat kryesore.....	63
Aneksi nr.2 Publikimi i të dhënave të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023	63
Aneksi nr. 3 Memorandumet e Mirëkuptimit	64
Aneksi nr. 4 Lista e Nomenklaturave në fuqi	65

Të nderuar,

Instituti i Statistikave (INSTAT) ka kënaqësinë t'ju paraqesë, në rolin e Koordinatorit të Sistemit Kombëtar Statistikor, Raportin Vjetor të Veprimtarisë Statistike për vitin 2024, në zbatim të ligjit nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare" dhe ligjit nr. 30/2022 "Për Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026".

Raporti vjetor reflekton përpjekjet dhe angazhimin e INSTAT-it dhe të gjithë Sistemit Kombëtar Statistikor, prodhues dhe kontribues, në realizimin e aktiviteteve statistikore në përputhje me Parimet Themelore të Statistikave Zyrtare, Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane dhe standardet ndërkombëtare.

Ky raport përmbledh përpjekjet dhe arritjet e institucionit tonë dhe agjencive statistikore në sigurimin e të dhënave cilësore, të besueshme dhe të krahasueshme, që shërbejnë si bazë për vendimmarrjen dhe hartimin e politikave të bazuara në statistika zyrtare. Në raport do të gjeni një pasqyrë të punës së kryer, të sfidave të hasura dhe të planeve për të ardhmen, me synimin për të rritur numrin e produkteve statistikore dhe për të siguruar një sistem statistikor të qëndrueshëm.

Viti që lamë pas ishte sfidues, por njëkohësisht i pasur me arritje të rëndësishme. Pas sulmit kibernetik të shkurtit 2024, falë bashkëpunimit me institucionet publike, sektorin privat dhe organizatat ndërkombëtare, kemi ringritur dhe përmirësuar infrastrukturën teknologjike. Prezantimi dhe publikimi i rezultateve kryesore të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 brenda 6 muajve dhe rezultatet e detajuara në nivel qarku dhe bashkie brenda 10 muajve, kanë rritur transparencën në procesin e prodhimit të statistikave zyrtare. Janë publikuar 175 njoftime statistikore për media dhe 7 botime tematike sipas metodologjisë dhe standardeve evropiane. Gjithashtu, janë forcuar kapacitetet e institucionit, jo vetëm nëpërmjet trajnimeve brenda institucionit, por dhe duke numëruar 131 pjesëmarrës, të cilët kanë qenë anëtarë në grupe pune për tema të ndryshme statistikore, në nivel evropian dhe global.

Viti 2024 shënon edhe 100-vjetorin e shërbimit statistikor zyrtar shqiptar. Historia e shtetformimit ka treguar se pjesë e çdo reforme zhvillimore është edhe ngritja e sistemeve të konsoliduara statistikore. Megjithëse në brishtësinë e tij, përpjekjet e elitës shqiptare kanë rezultuar në hedhjen e hapave të parë për ngritjen e zyrave statistikore në institucionet publike, deri në prodhimin dhe publikimin e statistikave konkrete në disa forma. Fondi i arkivit që disponon INSTAT, mbështetur edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Biblioteka Kombëtare dhe Muzeu Kombëtar, mundësoi ngritjen e një muzeu lehtësisht të vizitueshëm pranë ambienteve tona.

Mbi të gjitha, hapja e negociatave për Kapitullin 18 "Statistikat", më 15 Tetor të vitit që shkoi, ishte një nga sfidat dhe njëkohësisht mundësitë kryesore për të siguruar që ky sistem grumbullon, analizon dhe publikon statistika sipas standardeve evropiane. Përfshirja e këtij kapitulli në grupin themeltar të kapitujve tregon edhe një herë rëndësinë dhe vëmendjen që duhet t'u kushtohet statistikave në jetën sociale, ekonomike dhe mjedisore, për hartimin e strategjive kombëtare dhe sektoriale dhe marrjen e vendimeve bazuar në evidenca.

Në një kohë kur të dhënat luajnë një rol thelbësor në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, ne vazhdojmë të angazhohemi për të përmbushur standardet më të larta të cilësisë dhe përputhshmërisë me praktikat ndërkombëtare, duke rritur vit pas viti besueshmërinë e përdoruesve dhe cilësinë e shërbimit tonë. Partneriteti dhe bashkëpunimi me aktorët e tjerë kryesorë në vend dhe jashtë tij mbetet faktor kyç në plotësimin e detyrimeve ndaj komunitetit tonë, duke shprehur edhe një herë profesionalizmin dhe duke rritur besimin e publikut ndaj informacionit statistikor që ofrojmë.

Falenderoj ekipin e INSTAT-it, institucionet partnere dhe të gjithë aktorët e përfshirë për përkushtimin dhe profesionalizmin e tyre. Besimi dhe mbështetja juaj na inkurajojnë të vazhdojmë përmirësimin e Sistemit Kombëtar Statistikor në shërbim të qytetarëve dhe institucioneve të Shqipërisë.

Me respekt,

Drejtor i Përgjithshëm
Dr. Elsa DHULI

Lista e Shkurtimeve

CAPI	Intervistë nëpërmjet kompjuterit (<i>Computer Assisted Personal Interview</i>)
CATI	Intervistë nëpërmjet telefonit (<i>Computer-Assisted Telephone Interviewing</i>)
CAWI	Intervistë nëpërmjet web-it (<i>Computer Assisted Web Interview</i>)
ESA	Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (<i>Evropean system of national and regional accounts</i>)
ESSPROS	Sistemi i Integruar Evropian për Mbrojtjen Sociale (<i>European system of integrated social protection statistics</i>)
GFSM	Manuali për Statistikat Financiare të Qeverisë (<i>Government Finance Statistics Manual</i>)
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik (<i>Geographic Information System</i>)
GNPIE	Grupet Ndërinstitucionale për Integrimin Evropian
GSBPM	Modeli për Planifikimin e Fazave të Prodhimit Statistikor (<i>Generic Statistical Business Process Model</i>)
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ISTI	Sistemi i Integruar i Prodhimit Statistikor (<i>Integrated System Technology</i>)
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PPB	Produkti i Brendshëm Bruto
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
PRODCOM	Klasifikimi Statistikor sipas Produkteve Industriale (<i>Production Communautaire</i>)
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
SALSTAT	Projekti për Statistika të Forta Vendore Shqiptare
SIMONA	Sistemi për aksesimin nga jashtë të të dhënave mikro
SKS	Sistemi Kombëtar Statistikor
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë

I. Sistemi Kombëtar Statistikor

Sistemi Kombëtar Statistikor në Shqipëri përbëhet nga tërësia e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare, sipas Programit të Statistikave Zyrtare. Përkufizimi, veprimtaria dhe aktivitetet koordinuese janë të parashikuara në legjislacionin për statistikën zyrtare.

Aktualisht, prodhuesit e statistikave zyrtare janë:

- a) Instituti i Statistikave dhe zyrat statistikore rajonale në varësi të tij;
- b) Banka e Shqipërisë;
- c) Ministria e Financave;
- ç) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

Agjencitë statistikore zhvillojnë, prodhojnë dhe shpërndajnë statistika zyrtare, të cilat lidhen me fushën e kompetencave të parashikuara në legjislacionin për organizimin e funksionimit të tyre, si dhe në përputhje me parimet e statistikave zyrtare, të përcaktuara në legjislacionin për statistikën zyrtare.

Parimet e statistikave zyrtare

Për të siguruar besueshmërinë e publikut në statistikën zyrtare, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore udhëhiqen nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane. Këto parime përcaktojnë standarde për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane, për të siguruar statistika cilësore dhe për të arritur besueshmërinë e përdoruesve në to. Parimet e statistikave zyrtare, që përmban ky kod, janë të përafëruara edhe në ligjin për statistikën zyrtare, përkatësisht në nenet 4 e 5 të tij.

Në vitin 2024 është punuar për të forcuar dhe siguruar qëndrueshmëri në zbatimin e parimeve, ku mund të veçojmë:

- a) **"paanshmëria"**, që nënkupton mënyrën objektive dhe të pavarur të prodhimit të statistikave, të lira nga çdo presion politik ose i grupeve të tjera të interesuara, veçanërisht lidhur me përzgjedhjen e teknikave, përkufizimeve dhe metodologjisë më të mirë të përshtatshme për të arritur objektivat e vendosur. Ajo nënkupton disponueshmërinë e statistikave në një kohë sa më të shpejtë për të gjithë përdoruesit.

Në drejtim të këtij parimi, INSTAT është fokusuar në përcaktimin e burimit të të dhënave administrative që janë përdorur për prodhimin statistikor, duke vendosur edhe standardet përkatëse të metodologjisë së prodhimit. Këto standarde janë reflektuar në raportet e cilësisë, të cilat i janë vënë në dispozicion publikut nëpërmjet faqes elektronike zyrtare.

Nga ana tjetër, prodhuesit e statistikave zyrtare kanë mbajtur kontakte të ngushta me median për njoftimin e publikut mbi datat e publikimit të rezultateve apo zhvillimet e konferencave.

- b) **"besueshmëria"**, që është karakteristikë e statistikave për të matur sa më mirë që të jetë e mundur realitetin, të cilin ato janë parashikuar të përfaqësojnë. Parimi i besueshmërisë nënkupton përdorimin e kriterëve shkencorë për zgjedhjen e burimeve, metodave dhe procedurave të prodhimit statistikor.

Në drejtim të besueshmërisë, prodhuesit e statistikave zyrtare janë fokusuar në adaptimin e praktikave më të mira nga ana shkencore për arritjen e produkteve cilësore. Eurostat dhe Kombet e Bashkuara nxjerrin vazhdimisht udhëzime statistikore të këtij aspekti.

- c) **"pavarësia profesionale"**, që i referohet personelit të INSTAT-it ose të agjencive statistikore, gjatë zbatimit të programit, të cilit nuk i lejohet të kërkojë ose të marrë udhëzime nga Qeveria, autoritetet e

tjera shtetërore, partitë politike ose çfarëdo lloj grupi tjetër i interesuar, veçanërisht në përzgjedhjen e burimeve të të dhënave, metodave dhe procedurave statistikore, në përmbajtjen, formën dhe kohën e shpërndarjes, si dhe në zbatimin e konfidencialitetit statistikor.

Pavarësia profesionale e prodhuesve statistikorë zyrtarë është e garantuar me ligj. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet VKM nr. 650, datë 10.11.2017 "Për angazhimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për ruajtjen e besimit në statistika" ka konfirmuar garantimin dhe mbrojtjen e pavarësisë profesionale të INSTAT-it nëpërmjet mbështetjes në ruajtjen e besimit të publikut në statistikat zyrtare. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave garanton sigurimin e burimeve të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve dhe përmirësimin e cilësisë statistikore.

- ç) **"kosto-efektiviteti"**, që është përdorimi më i mirë i mundshëm i të gjitha burimeve të disponueshme dhe kufizimi i barrës së atyre që përgjigjen. Puna dhe kostoja që kërkon prodhimi i statistikave duhet të jenë në përputhje me rëndësinë e rezultatit të kërkuar.

Për të siguruar kosto-efektivitetin, INSTAT operon institucionalisht me strukturat e ngritura në drejtim të respektimit të kuadrit ligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Planifikimi i hershëm i aktiviteteve ka ndikuar në vlerësimin në kohë reale të efektshmërisë së parashikuar, duke përdorur sa më pak burime financiare dhe duke shmangur aktivitetet e dubluara.

- dh) **"konfidencialiteti statistikor"**, që është mbrojtja e të dhënave që lidhen me njësi statistikore të veçanta, të cilat janë marrë direkt për qëllime statistikore ose indirekt nga burime administrative ose të tjera kundër çdo shkeljeje të së drejtës së konfidencialitetit. Ajo nënkupton parandalimin e përdorimit jo-statistikor të të dhënave të marra dhe zbulimin e paligjshëm.

Për të siguruar konfidencialitetin statistikor dhe mbrojtur të dhënat personale, INSTAT ka miratuar udhëzime dhe rregullore për t'u respektuar rigorozisht nga personeli i përfshirë në prodhimin statistikor.

Të dhënat e mbledhura trajtohen sipas metodës "Me një drejtim të vetëm" dhe nuk i jepet akses asnjë strukturë apo institucion tjetër, pavarësisht statusit juridik të tij. Së fundmi, INSTAT po punon ngushtësisht me AKSK-në për të forcuar më tej sigurinë ndaj sulmeve kibernetike dhe mbrojtjen e informacionit statistikor.

- d) **"transparenca"**, që është e drejta e atyre që përgjigjen të kenë informacion mbi bazën ligjore, qëllimin për të cilin janë kërkuar të dhënat dhe masat mbrojtëse të marra.

Në interes të transparencës, INSTAT jo vetëm ka vënë në dispozicion të publikut çdo informacion mbi metodat e përdorura për prodhim statistikor, por edhe ka publikuar çdo angazhim të ndërmarrë në aspektet e vendimmarrjes dhe llogaridhënies. Kështu, në faqen zyrtare janë bërë publike dokumentacionet e mbledhjeve që ka zhvilluar Këshilli i Statistikave, Bordi Drejtues dhe organizmat e tjerë. Faqja zyrtare e INSTAT-it përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për të interesuarit mbi procedurat që duhet të ndjekin për marrjen e të drejtës së hyrjes në të dhëna, formatet që duhet të përdorin, etj. Programi i transparencës respektohet sipas kërkesave të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit.

Zbatimi i objektivave strategjike 2022-2026 të Sistemit Kombëtar Statistikor

Objektivat strategjikë për zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor janë të parashikuar në Ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”. Çdo objektiv është shoqëruar me masa zbatuese konkrete, si dhe me treguesit përkatës për matjen e performancës dhe raportimin e ecurisë së tyre.

Gjatë vitit 2024 janë shënuar arritje në drejtim të përmbushjes së objektivave strategjikë zhvillimorë të SKS-së. Siç vihet re në tabelën e mëposhtme, vlerat e pjesës më të madhe të indikatorëve të performancës kanë pësuar rritje krahasuar me një vit më parë.

Tabela 1: Indikatorët e performancës 2023-2024

Indikatorët e Performancës	2023	2024	Trendi
Infrastruktura			
Nr. i agjencive Statistikore	3	4	↑
Nr. i Memorandumeve/Marrëveshjeve të bashkëpunimit	39	42	↑
Nr. i trajnimeve	14	8	↓
Nr. i pjesëmarrësve në grupet ndërkombëtare të punës si anëtarë /Numri i takimeve	8/112	13/131	↑
Nr. i pjesëmarrësve në grupet ndërkombëtare të punës si vëzhgues/Numri i takimeve	104/112	118/131	↑
Prodhimi			
Nr. i burimeve administrative të përdorura	51	51	→
Nr. i data point në databazën e Eurostat për SKS	5,335,020	7,035,303	↑
Nr. i treguesve në nivel bashkie	187	231	↑
Nr. i aktiviteteve me përmirësim në afat	2	6	↑
Nr. i aktiviteteve me përmirësim në frekuencë	0	1	↑
Nr. i aktiviteteve të dokumentuara në GSBPM	83	89	↑
Nr. i raporteve të cilësisë	56	57	↑
Përdoruesi			
Nr. i takimeve konsultative-informuese me përdoruesit	78	13	↓
Nr. i publikimeve	171	175	↑
Nr. i botimeve tematike	12	7	↓
Nr. i klikimeve (page views)	3,020,981	1,190,082	↓
Indeksi i Nivelit të përgjithshëm të kënaqësisë së përdoruesve	4.02	4.03	↑

Gjatë vitit 2024, ecuria e arritjes së objektivave strategjike të SKS është si vijon:

Objekti 1: Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht acquis communautaire lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integrimit Evropian. Kapitulli 18 “Statistikat” i acquis është konsideruar nga BE si një ndër kapitujt kryesorë të nevojshëm për t’u përfruar me standardet evropiane. Për këtë arsye, ai bën pjesë në grupin Themeltar (Cluster 1) të akteve komunitare (acquis). Në aspektin përafres, gjatë vitit 2024 u miratua në Bordin Drejtues të INSTAT Projekt-Udhëzimi “Për zbatimin e një kornize të përbashkët për Statistikat Evropiane në lidhje me personat dhe njësitë ekonomike familjare, bazuar në të dhënat në nivel individual, të mbledhura nga kampioni”.

Përsa i përket vlerës së indikatorëve të performancës për këtë objektiv, vlen të vihet në dukje **rritja prej 32% e numrit të të dhënave (datapoints) të SKS** të publikuara në databazë të Eurostat krahasuar me një vit më parë, duke e çuar numrin gjithsej të tyre në 7,035,303. Në harkun kohor 10 vjeçar, të dhënat e transmetuara kanë pësuar një rritje të konsiderueshme, duke rritur ndjeshëm dhe publikimin e tyre në nivel evropian.

Në vitin 2015 ky numër ishte vetëm 188,393 *data points*. Numri i *data points* për vitin 2024 sipas agjencive statistikore rezulton të jetë: INSTAT 3,559,032 *data points*; Banka e Shqipërisë 768,556 *data points*; Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore 3,476,271 *data points*. Përsa i përket zbatimit të rekomandimeve të Eurostat-it, duke marrë parasysh natyrën e rekomandimeve të *Peer Review* dhe kushtet e reja legjislative në të cilat operon SKS, mund të themi se këto rekomandime janë përmbushur plotësisht. INSTAT është në pritje të raundit të ri të këtij ushtrimi, i cili do të shërbejë për përcaktimin e objektivave zhvillimore në harkun kohor 2027-2031.

Objektivi 2: Plotësimi i nivelit të plotë të kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare. Objektivi parashikon rritjen e numrit të statistikave të prodhuara, duke përafëruar sa më tepër kërkesat e përdoruesve për të dhëna. Numri i publikimeve për vitin 2024 ishte 175 nga 171 publikime që ishin një vit më parë. Sipas parashikimeve të Programit të Statistikave Zyrtare, janë prodhuar 1,012 tregues statistikorë dhe 66 tregues statistikorë në aspektin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm. Në kuadër të plotësimit të nevojave të jashtme për të dhëna, janë plotësuar 51 pyetësorë statistikorë të kërkuar nga institucione statistikore apo organizata të ndryshme ndërkombëtare. Në harkun njëvjeçar, në faqen e INSTAT-it janë shënuar 1,190,082 klikime. Rezultatet e anketës së kënaqësisë së përdoruesve për vitin 2024 treguan një rritje të nivelit të kënaqësisë me 0.01 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, duke e çuar këtë vlerë në shkallën 4.03 pikë nga 5 pikë të plota.

Objektivi 3: Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuar Evropiane dhe ndërkombëtare. Në kuadër të këtij objekti, Sistemi Kombëtar Statistikor është angazhuar në adoptimin e klasifikimeve të reja ndërkombëtare që mundësojnë përafrimin, harmonizimin dhe krahasueshmërinë e statistikave të prodhuara në vendin tonë me ato të vendeve të tjera evropiane apo ndërkombëtare. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2024 Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën miratoi Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev 2.1, akt i cili është dërguar për miratim pranë Këshillit të Ministrave. Në zbatim të masave prioritare për realizimin e këtij objekti, ka vijuar gjithashtu puna progresive në drejtim të cilësisë statistikore. Përsa i përket menaxhimit të kontrollit të cilësisë së produkteve statistikore, janë publikuar 57 raporte cilësie në krahasim me 56 të tilla gjatë vitit 2023. Ky tregues dëshmon përpjekjen për t'i ofruar përdoruesve në mënyrë transparente informacionin e nevojshëm mbi standardet dhe metodat e prodhimit statistikor, si dhe informacion mbi cilësinë e statistikave të prodhuara. Nga viti në vit është rritur numri i aktiviteteve të dokumentuara sipas standardit ndërkombëtar të proceseve statistikore (GSBPM), ku deri në vitin 2024 janë dokumentuar 89 aktivitete krahasuar me 83 të tilla të dokumentuara deri në fund të vitit 2023.

Objektivi 4: Përfshirja e institucioneve shtesë prodhues në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare. Zgjerimi i Sistemit Kombëtar Statistikor nënkupton shtimin e institucioneve prodhuese dhe furnizuese me të dhëna, rritjen e gamës së produkteve statistikore të prodhuara dhe kapaciteteve profesionale të stafit të angazhuar. Në këtë kuadër, në zbatim të vendimit të Kuvendit nr. 15/2024, datë 08.02.2024 “Për miratimin e Planit Vjetor 2024 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore mori statusin ‘Agjenci Statistikore’, përgjegjëse për prodhimin e statistikave të Bilancit Energjetik. Përsa i përket nivelit të disagregimit të të dhënave të marra nga burimet administrative, numri i institucioneve që ofrojnë të dhëna në nivel mikro është 4, vlerë që përkon me parashikimin e PSZ-së. Numri i bazave të të dhënave mikro (regjistrave statistikorë) nga institucionet furnizuese është 15, numër i njëjtë me atë të vitit të kaluar. Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të stafit të SKS-së dhe përmirësimit të cilësisë së produkteve statistikore, më 29 Mars 2024 u zhvillua trajnimi i stafit të SKS për Cilësinë Statistikore dhe Auditet, ndërsa në datat 21-23 Tetor 2024 u zhvillua trajnimi lidhur me Cilësinë Statistikore dhe GSBPM, për punonjësit e rinj të INSTAT.

Objektivi 5: Modernizimi i mëtejshëm i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare. Modernizimi i vazhdueshëm i metodave të grumbullimit dhe prodhimit statistikor është gjithnjë e më shumë në fokus të Sistemit Kombëtar Statistikor, pasi përbën mekanizmin kryesor për prodhimin e statistikave në përputhje me standardet e kërkuara nga Eurostat-i dhe teknikat moderne ndërkombëtare. Duke qenë se ndër hallkat kryesore të procesit të prodhimit statistikor është ajo e grumbullimit të të dhënave, gjithnjë synohet modernizimi i metodave të këtij procesi, si: metodat me telefon, web, laptop, tablet (CATI / CAWI / CAPI). Në këtë aspekt, në vitin 2024: u ndërtua 1 aplikacion CATI, u përditësuan 6 aplikacione CAWI dhe u ndërtuan 3 aplikacione CAWI; një vrojtje statistikore kaloi nga metoda e mbledhjes së të dhënave me letër (PAPI) në metodën CAPI, për të cilin u ndërtua aplikacioni përkatës, si dhe u përditësuan 21 aplikacione CAPI. Modernizimi i teknikave dhe metodave të grumbullimit statistikor ka sjellë dhe ulje të nivelit të ngarkesës së të intervistuarve, si një ndër aktivitetet përmirësuese të ndërmarra në zbatim të rekomandimeve mbi Vlerësimin e Cilësisë (Peer Review) 2018.

Objektivi 6: Rritja e besimit të publikut në SKS dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur. Rritja e besimit të publikut në Sistemin Kombëtar Statistikor përbën një ndër platformat kryesore mbi të cilat SKS ngre dhe mbështet veprimtarinë e tij prodhuese. Matja e besimit në statistika realizohet nëpërmjet Anketës së kënaqësisë së përdoruesve, ku një ndër variablat është besueshmëria e përdoruesve në profesionalizmin dhe pavarësinë e sistemit. Nga anketa e kënaqësisë së përdoruesve 2024, treguesi i besueshmërisë së përdoruesve në të dhënat e INSTAT arriti vlerën 4.19 pikë, duke pësuar një rritje prej 0.15 pikë krahasuar me një vit më parë, ku kjo vlerë ishte 4.04 pikë nga 5 pikë të plota. Sa i përket referimit ndaj produkteve statistikore në media, për vitin 2024 numri i përmendjeve rezultoi: 2,870 herë në përmbajtjen e 1,477 artikujve të botuar në shtypin shqiptar; 37 herë në faqet e para të gazetave dhe revistave të përditshme; 1,320 herë në përmbajtjen e 1,162 kronikave në lajmet kryesore të televizioneve më të ndjekura në Shqipëri; 17,625 herë në përmbajtjen e 8,586 artikujve të publikuara në portalet online. Organizimi i takimeve/aktiviteteve me fokus ndërgjegjësimin statistikor dhe shmangien e keqinterpretimit të statistikave është një ndër masat e rëndësishme të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e besueshmërisë. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2024 INSTAT-i ka zhvilluar 13 aktivitete të tilla me grupe të ndryshme përdoruesish.

II. Zbatimi i PSZ për vitin 2024

Referuar Planit Vjetor të PSZ 2024, Sistemi Kombëtar Statistikor kishte planifikuar të realizonte 106 aktivitete statistikore, të cilat të ndara sipas agjencive statistikore rezultojnë si vijon:

INSTAT përgjegjës për 93 aktivitete statistikore, Banka e Shqipërisë përgjegjës për realizimin e 9 aktiviteteve statistikore, Ministria e Financave përgjegjës për 2 aktivitete statistikore. Risi për vitin 2024 ishte përfshirja e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore në Sistemin Kombëtar Statistikor si agjenci statistikore, përgjegjëse për realizimin e 2 aktiviteteve statistikore mbi bilancin energjitik.

Realizimi gjatë vitit 2024

Sistemi Kombëtar Statistikor realizoi 100 aktivitete statistikore, por nuk arriti të kryente publikimin e të dhënave për 6 aktivitete statistikore. Numri i data points për Shqipërinë në databazën e Eurostat për vitin 2024 ishte 7,035,303, duke shënuar një rritje prej 32% krahasuar me vitin 2023.

Më poshtë paraqitet një informacion më i detajuar mbi ecurinë e zbatimit të Planit të PSZ 2024 sipas agjencive përgjegjëse.

- INSTAT kishte planifikuar realizimin e 93 aktiviteteve, nga të cilat realizoi 88 aktivitete, duke siguruar prodhimin dhe publikimin e një game të gjerë treguesish në fushën e statistikave demografike dhe sociale, në fushën e statistikave ekonomike, në fushën e statistikave sektoriale dhe në fushën e statistikave të mjedisit. Këto tregues ndihmojnë në hartimin e politikave sociale dhe ekonomike, me qëllimin final të zhvillimit dhe përmirësimit të mirëqënies shoqërore dhe në monitorimin e impaktit të këtyre politikave në aspektet e ndryshme të jetës në vend. Për 5 aktivitete statistikore, si Publikimi i Statistikave Gjimore, Statistikave të Forcave të Punës, Statistikave mbi Produktin e Brendshëm Bruto në nivel rajonal, Anketën e Edukimit të të Rriturve dhe Statistikave të Mbrojtjes Sociale, nuk u publikuan të dhënat në kohën e parashikuar. Kjo vonesë është rezultat i impaktit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të përditësimit të të dhënave demografike pas në seri kohore, të cilat bazohen në rezultatet e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023. Përditësimi i serisë pas kohore të të dhënave demografike është një proces i domosdoshëm për të siguruar që statistikën të pasqyrojnë sa më saktë ndryshimet strukturore demografike të popullsisë dhe për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të publikuara.
- Banka e Shqipërisë planifikoi 9 aktivitete statistikore, të cilat i realizoi sipas planit, duke prodhuar tregues statistikorë mbi llogaritë financiare, statistikën monetare, investimet e huaja direkte, bilancin e pagesave, pozicionin e investimeve ndërkombëtare, borxhin e jashtëm bruto, etj.
- Ministria e Financave planifikoi 2 aktivitete statistikore, të cilat i realizoi sipas planit, duke prodhuar statistikën financiare të qeverisë sipas GFSM2014 dhe statistikën tremujore të borxhit.
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore planifikoi 2 aktivitete, nga të cilat arriti të realizonte 1 aktivitet statistikor, duke prodhuar treguesit mbi bilancin e përgjithshëm energjistik, në nivel vjetor. AKBN nuk publikoi të dhënat mbi energjinë, në nivel tremujor. Arsyeja kryesore e mosrealizimit të këtij aktiviteti lidhet me ristrukturimin e drejtorisë përkatëse në AKBN, duke sjellë mungesë stafi dhe duke mos favorizuar kështu përgatitjen e statistikave të energjisë.

Në vijim paraqitet një informacion më i detajuar mbi ecurinë e zbatimit të PSZ sipas fushave statistikore.

Fusha “Statistikat Demografike dhe Sociale”

Fusha mbi Statistikat Demografike dhe Sociale mbulohet nga INSTAT. Për vitin 2024 ishte planifikuar realizimi i 30 aktiviteteve statistikore dhe prodhimi i 445 treguesve statistikorë. Janë realizuar 26 aktivitete statistikore nga të cilat dhe janë prodhuar 397 tregues që lidhen me: popullsinë; të huajt me leje qëndrimi dhe azil-kërkuesit; punësimin dhe papunësinë; konsumin e njësive ekonomike familjare; nivelin e jetesës; arsimin; shëndetësinë; mbrojtjen sociale ESSPROS; krimet; kulturën. Për prodhimin cilësor të treguesve të kësaj fushe janë kryer në terren: anketa mbi buxhetin e familjes, anketa mbi të ardhurat dhe nivelin e jetesës, anketa mbi forcat e punës. Për 4 aktivitete të tjera statistikore (Statistikat Gjimore, Statistikat e Forcave të Punës, Statistikat mbi Anketën e Edukimit të të Rriturve dhe Statistikat e Mbrojtjes Sociale) përdoruesve do ju vihen në dispozicion informacionet pas përditësimit të serisë kohore të të dhënave demografike të viteve të mëparshme bazuar në të dhënat e Censit 2023, të cilat janë në proces realizimi.

Numri i data points për Shqipërinë në databazën e Eurostat për fushën e Statistikave Demografike dhe Sociale për vitin 2024 ishte 1,402,042, duke shënuar një rritje prej 38%, krahasuar me vitin 2023.

Ndër aktivitetet kryesore të ndjekura me shumë prioritet ishte puna voluminoze për publikimin sipas afateve të parashikuara në kalendarin e publikimeve, të rezultateve kryesore dhe të atyre në nivel rajonal (qark/bashki dhe njësi administrative) të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023. Informacioni i detajuar mbi publikimet dhe të dhënat e përditësuara në databazën statistikore gjendet në faqen zyrtare të INSTAT, në seksionin “Censet”. Gjithashtu gjatë vitit janë kryer aktivitete mbështetëse statistikore të cilat kanë kontribuar në arritjen e objektivave në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të prodhimit statistikor, për zbatimin e strategjive në të cilat INSTAT kontribuon me të dhëna, si dhe në kuadër të integritetit evropian. Ndër këto aktivitete mund të veçojmë përmirësimin e statistikave vitale në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të

Gjendjes Civile. Ky aktivitet u mbështet nga projekti SALSTAT, i cili zhvilloi trajnime për punonjësit e zyrave rajonale të Gjendjes Civile në qarkun Lezhë. Gjithashtu, gjatë vitit 2024 ka vijuar pilotimi për analizimin e të dhënave të Anketës së Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare në 6 Bashki kryesore. INSTAT ka vijuar me ndjekjen e Strategjisë Ndërsektoriale për të Miturit 2021-2025, Strategjisë për Barazinë Gjinore 2021-2030, Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2021-2025, Planit Kombëtar të Moshimit 2020-2025, Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2024-2030 dhe Planit të Veprimit 2024-2026, Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030 në Shqipëri, Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030 dhe Planit të veprimit për zbatimin e saj, Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale 2024-2028, Strategjisë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Viktimave të Krimit 2024-2030, Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026. Një tjetër aktivitet mbështetës statistikor ka qenë dhe zbatimi i projekteve statistikore në kuadër të programit IPA 2019 dhe IPA 2022 mbi “Mbrojtjen Sociale, ESSPROS”, “Të ardhurat dhe Nivelin e Jetesës” dhe “Anketën Forcave të Punës”.

INSTAT realizoi për herë të parë anketën e “Lëvizjeve migratore dhe karakteristikat socio-ekonomike”, aktivitet i cili ishte jashtë parashikimit të PSZ për vitin 2024. Nga kjo anketë do të sigurohet informacion mbi karakteristikat socio-demografike të anëtarëve të familjeve me histori emigracionin/imigracionin/rikthimi, historiku i punësimit, remitancat, zotërimi i pajisjeve afatgjatë apo tokë bujqësore etj.

Fusha “Statistikat Ekonomike”

Kjo fushë mbulohet nga INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave. Për vitin 2024 ishte planifikuar realizimi i 20 aktiviteteve statistikore për prodhimin e 241 treguesve statistikorë. Gjatë vitit u realizuan 19 aktivitete statistikore, nga të cilat janë prodhuar 237 tregues mbi: Llogaritë Kombëtare me frekuencë vjetore dhe tremujore, statistikave monetare, statistikave financiare të qeverisë, statistikave të borxhit publik, statistikave strukturore të ndërmarrjeve, statistikave afatshkurtra të ndërmarrjeve, etj. PBB në nivel rajonal nuk u publikua në kohë për shkak të përditësimit të serisë kohore të të dhënave demografike të viteve të mëparshme bazuar në të dhënat e Censit 2023, të cilat janë në proces realizimi.

Numri i data points për Shqipërinë në databazën e Eurostat për fushën e Statistikave Ekonomike për vitin 2024 ishte 744,437 duke shënuar një rritje prej 115%, krahasuar me vitin 2023.

Fokusi kryesor ka qenë rritja e nivelit të përafrimit të Statistikave Ekonomike me kërkesat e *acquis communautaire*, duke përmirësuar metodologjitë në përpilimin e treguesve statistikorë; prodhimin, publikimin dhe transmetimin e treguesve të rinj, si dhe në zgjerimin e serive kohore të transmetuara në EUROSTAT, për treguesit e llogarive kombëtare, statistikave të demografisë së ndërmarrjeve dhe statistikave afatshkurtra.

Në kuadër të rishikimit radhor të treguesve të llogarive kombëtare, Instituti i Statistikave, në përputhje me Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane dhe Politikën e Harmonizuar Evropiane për Rishikimin e Statistikave Makroekonomike (sipas ESA 2010), publikoi me datë 27 Shtator 2024 seritë e përditësuara kohore të Llogarive Kombëtare në terma vjetorë dhe tremujorë.

Nga ky rishikim u arritën:

- Përmirësime metodologjike në fushën e Llogarive Kombëtare në përputhje me standardet ndërkombëtare, të cilat u realizuan me mbështetjen e Bashkimit Evropian përmes projekteve IPA-Shumëpërfituese dhe Eurostat;
- Përdorimi i burimeve të reja statistikore dhe përmirësimi i atyre ekzistuese, duke sjellë optimizimin e afateve të përpunimit dhe publikimit të të dhënave, të cilat janë në përputhje me kërkesat e programit të transmetimit ESA 2010;

- Përdorimi i metodave të avancuara statistikore dhe integrimi i tabelave Burim-Përdorime në vlerësimin e treguesve të llogarive kombëtare, duke sjellë rritjen e cilësisë dhe të plotshmërisë së treguesve të prodhuar.

Në kuadër të rritjes së nivelit të krahasueshmërisë dhe përputhshmërisë së treguesve në fushën e statistikave ekonomike, me standardet e Bashkimit Evropian, INSTAT prodhoi dhe publikoi për herë të parë:

- Setin e plotë të Llogarive Kombëtare sipas Sektorëve Institucionalë;
- Vlerësimin e PBB-së me metodën e të ardhurave, duke eliminuar mospërputhjet statistikore ndërmjet tre metodave të vlerësimit të PBB-së: metodës së prodhimit, metodës së shpenzimeve dhe metodës së të ardhurave;
- Prodhimin dhe transmetimin për herë të parë të treguesve kryesorë lidhur me demografinë e ndërmarrjeve, si: ndërmarrje të reja dhe të punësuar në to, ndërmarrje të mbyllura, të falimentuara, etj.

Të gjitha përmirësimet në fushën e Statistikave Ekonomike shënojnë një hap të rëndësishëm drejt harmonizimit të statistikave zyrtare të Shqipërisë me rregulloret dhe standardet e BE-së.

Një tjetër aktivitet mbështetës për statistikën e fushës ekonomike ishte zbatimi i projekteve në kuadër të programeve shumë-përfitues IPA 2019 dhe IPA 2022 lidhur me Statistikat Financiare të Qeverisë, Statistikat e Deficitit të Tejkualuar dhe Statistikat Afatshkurtra të Biznesit.

Fusha “Statistikat Sektoriale”

Kjo fushë mbulohet nga INSTAT dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Për vitin 2024 ishte planifikuar realizimi i 45 aktiviteteve statistikore për prodhimin e 354 treguesve statistikorë. Gjatë vitit u realizuan 44 aktivitete statistikore, nga të cilat u prodhuan 328 tregues statistikorë mbi: bujqësinë, energjinë, transportin, turizmin, tregtinë e jashtme, çmimet, shkencën, teknologjinë dhe inovacionin. AKBN nuk publikoi të dhënat mbi energjinë, në nivel tremujor. Ristrukturimi i drejtorisë përkatëse në AKBN, ka sjellë shtyrje në kohë në përgatitjen e statistikave të energjisë.

Numri i data points për Shqipërinë në databazën e Eurostat për fushën e Statistikave Sektoriale për vitin 2024 ishte 4,847,724, duke shënuar një rritje prej 23%, krahasuar me vitin 2023.

Rritja e cilësisë dhe shtimi i treguesve statistikorë lidhur me “Statistikat sektoriale” ka qenë në fokus për vitin 2024, me qëllimin për t’i mundësuar politikbërësve të hartojnë strategjitë e duhura për planifikimin, zhvillimin dhe monitorimin e aktiviteteve në sektorët e kësaj fushe. Zhvillimet kryesore në këtë fushë lidhen me përmirësimet metodologjike dhe rritjen e nivelit të përputhshmërisë së këtyre statistikave me kërkesat e Akteve Komunitare. Gjatë vitit 2024 vijoi puna përgatitore për Censin e Bujqësisë. Informacion më i detajuar për këtë aktivitet është dhënë në kapitullin nr. III “Censet”.

INSTAT publikoi për herë të parë treguesit kryesorë për shpenzimet dhe personelin për aktivitetin e Kërkim-Zhvillimit, si dhe transmetoi në Eurostat të dhënat përkatëse së bashku me raportin e cilësisë. Gjithashtu, gjatë vitit 2024, janë realizuar aktivitete mbështetëse statistikore që lidhen me: ndjekjen e Strategjisë Ndërsektoriale Agjenda Dixhitale e Shqipërisë 2022–2026, kontributin në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030; pjesëmarrjen e Shqipërisë në raportin "European Innovation Scoreboard 2024". Një tjetër aktivitet mbështetës statistikor ka qenë zbatimi i projekteve statistikore në kuadër të programeve shumëpërfutuese IPA 2019 dhe IPA 2022, lidhur me Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, Indeksin e Çmimeve të Banesave dhe Matjen e Fuqisë Blerëse.

Fusha “Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain”

Kjo fushë mbulohet nga INSTAT. Për vitin 2024 u parashikua realizimi i 11 aktiviteteve statistikore për prodhimin e 50 treguesve statistikorë të cilat u realizuan me sukses sipas planit duke prodhuar tregues mbi: llogaritë fizike dhe monetare në mjedis, ujin, zhurmat, mbetjet, etj.

Numri i data points për Shqipërinë në databazën e Eurostat për fushën e Statistikave të Mjedisit dhe Multidomain për vitin 2024 ishte 40,997, duke shënuar një rritje prej 7.9 %, krahasuar me vitin 2023.

Ndër aktivitetet kryesore në fushën e statistikave të mjedisit ka qenë realizimi i mbledhjes së të dhënave mbi mbetjet e ngurta urbane. Ky aktivitet u mbështet nga projekti SALSTAT dhe u realizua në bashkëpunim të ngushtë me bashkitë në vend.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, u transmetuan për herë të parë në Eurostat treguesit mbi llogaritë e emetimeve në ajër, llogaritë e flukseve të energjisë dhe llogaritë në pyje.

Aktivitete të tjera mbështetëse në kuadër të programeve IPA 2019 dhe IPA 2022 ishin aktivitetet mbi Statistikat e Llogarive Ekonomike në Mjedis dhe Statistikat e Ujit.

Në lidhje me Informacionin Statistikor Rajonal dhe Gjeohapësinor, ka vijuar procesi i përditësimit të vazhdueshëm të njësive statistikore, përditësimi i gjeodatabazës dhe mbështetja gjeografike e vrojtimeve statistikore të vitit. Në kuadër të projektit SALSTAT ka vijuar puna në lidhje me ndërtimin e regjistrit statistikor të ndërtesave dhe banesave (ASBDR). Gjatë vitit 2024 u finalizua aplikacioni web i Regjistrit dhe lista e dokumentave bazë të regjistrit, si dhe janë përgatitur skenarë të ndryshëm (use cases) për përditësimin e tij. Punë e vazhdueshme është kryer mbi komponentin e teknologjisë së informacionit të regjistrit mbi ngritjen e infrastrukturës së nevojshme në funksion të tij.

Përsa i përket klasifikimit statistikor të njësive territoriale, është transmetuar në Eurostat lista e njësive administrative lokale LAU (Local Administrative Unit) dhe klasifikimi Degurba (Shkalla e Urbanizimit). Në vitin 2024 ka nisur zbatimin e projektit statistikor mbi “Statistikat e Qytetit/informacioni gjeografik”. Gjithashtu gjatë vitit u përgatit informacioni hartografik për botimin e Vjetarit Statistikor Rajonal, duke u bazuar në informacionin statistikor rajonal dhe gjeoinformacionin.

Të dhënat kryesore të 4 fushave statistikore, të publikuara gjatë vitit 2024 në zbatim të Planit Vjetor 2024 mbi 4, gjenden në aneksin nr.1 të dokumentit.

III. Censet

Brenda pesëvjeçarit të Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026 është parashikuar zhvillimi i dy censeve: Censi i Popullsisë dhe Banesave dhe Censi i Bujqësisë.

Censi i Popullsisë dhe Banesave

INSTAT realizoi në vitin 2023 Censin e Popullsisë dhe Banesave 2023. Numërimi i popullsisë dhe banesave përfundoi në fund Nëntori të vitit 2023. Gjatë vitit 2024 vijoi me përpunimin e të dhënave të mbledhura gjatë censit për realizimin e publikimeve sipas parashikimeve. Gjatë përpunimit të të dhënave INSTAT zbatoi një sërë rregullash dhe procedurash gjithëpërfshirëse për të garantuar që në asnjë fazë të mos cënohet konfidencialiteti i të dhënave dhe mbrojtja e tyre. Të dhënat e mbledhura kaluan nëpër procese të rëndësishme statistikore si pastrimi, përpunimi dhe tabelimi, praktikë statistikore e cila siguron që informacioni që ndahet me publikun është cilësor, i saktë dhe i besueshëm. Rezultatet e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 u publikuan sipas kalendarit të publikimit dhe shpërndarjes, si më poshtë :

- Qershor 2024: U publikuan rezultatet kryesore të Censit në nivel kombëtar;
- Tetor 2024: U publikuan rezultatet e Censit në nivel qarku/bashkie dhe njësie administrative (12 publikime të dedikuara);
- Dhjetor 2024: U publikua Geo – DataHub / WebGIS;

- Qershor 2024 - 31 Dhjetor 2025: Analizat tematike mbi tematika të ndryshme.

Publikimi i rezultateve kryesore (Qershor 2024), si dhe atyre në nivel rajonal (Tetor 2024), u shoqëruan me organizimin e dy konferencave me pjesëmarrjen e aktorëve të interesuar në fusha të ndryshme. Eurostat në takimin vjetor me nënkomitetin për Çështjet mbi Ekonominë, Financat dhe Statistikat, vlerësoi punën e INSTAT për publikimin e rezultateve të Censit në një kohë relativisht të shkurtër. Informacioni i detajuar gjendet në aneksin nr.2 të këtij dokumenti.

Gjithashtu, në kuadër të pasurimit të faqes zyrtare të INSTAT me treguesit e prodhuar nga Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023, në seksionin dedikuar Censeve u publikuan të gjitha tabelat me rezultatet kryesore dhe detajimet përkatëse, si dhe u përditësua databaza statistikore.

Faza e pas numërimit

INSTAT, gjatë vitit 2024, zbatoi strategjinë e publikimit të të dhënave gjeohapësinore, bazuar në rezultatet e Censit 2023 dhe statistikat rajonale. Në këtë kuadër është ndërtuar platforma *Geodata Hub* e INSTAT-it (<https://geodatahub.instat.gov.al/>) dhe është modernizuar faqja e *webGIS* (<https://instatgis.gov.al/>), si nga pamja grafike ashtu dhe nga funksionaliteti, duke i dhënë përdoruesve mundësinë e shkarkimit të të dhënave gjeografike dhe atyre statistikore. Në *WebGIS* aktualisht janë paraqitur mbi 370 harta me tregues të ndryshëm nga të dhënat e Censeve 2011 dhe 2023 dhe harta me tregues rajonalë bazuar në Vjetarin Statistikor Rajonal 2023. Puna po vazhdon për ngarkimin e treguesve të tjerë rajonalë për vitin 2024, si dhe treguesve nga Censi 2001.

Censi i Bujqësisë

Censi i Bujqësisë është planifikuar të zhvillohet në përputhje me rekomandimet e FAO-s, për raundin e censeve 2020 dhe rregulloren e KE 1091/2018, mbi Statistikat e Integruara të Fermave.

Aktualisht, strategjia e Censit është në proces përditësimi dhe miratimi zyrtar varet nga miratimi i Projektligjit për “Censin e Bujqësisë”, i cili pritet të miratohet sipas Planit Kombëtar të Integrimit Evropian për periudhën 2024-2026. Ky projektligj ka kaluar një proces të gjatë konsultimesh me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë dhe po ndiqen hapat e mëtejshëm zyrtarë për miratim.

INSTAT gjatë vitit 2024 ka vijuar punën përgatitore për realizimin e Censit të Bujqësisë, në bashkëpunim me partnerë kombëtarë, si: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Ministria e Financave, etj, dhe me institucione ndërkombëtare si FAO, EU, Banka Botërore, të cilët mbështesin në mënyrë të vazhdueshme me ekspertizë.

Për realizimin e këtij aktiviteti, INSTAT është në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me të cilën ka nënshkruar edhe një Memorandum Bashkëpunimi. Bashkëpunimi me MBZHR ka patur fokus kryesor përgatitjen për zhvillimin e Censit, si vënie në dispozicion të regjistrave administrativë që kjo ministri disponon, finalizimin e dokumenteve strategjike të Cens-it, së bashku me draft-pyetësin e Censit të Bujqësisë.

Në të njëjtën kohë, Komisioni Evropian ka mbështetur INSTAT-in nëpërmjet asistencës teknike për realizimin e Censit të Bujqësisë, e cila është fokusuar në dy komponentë:

1. Aspektet metodologjike, duke përfshirë përgatitjen e pyetësit të Censit të Bujqësisë;
2. Mbështetje në zhvillimin e një aplikacioni për grumbullimin e të dhënave të Censit të Bujqësisë, duke përdorur metodën CAPI (intervistë personale me ndihmën e kompjuterit).

INSTAT, në vitin 2024, nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Institutin e Statistikave të Francës (INSEE) për ndërtimin e platformës për grumbullimin e të dhënave të Censit të Bujqësisë. Gjithashtu, janë zhvilluar takime me ekspertë të Bashkimit Evropian që mbështesin Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) për përgatitjen e aplikimeve mbështetur nga projekti IPA Kombëtare, ku mbulohen disa aktivitete të Censit të Bujqësisë. Një tjetër takim i rëndësishëm është zhvilluar me përfaqësues të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), ku është diskutuar mbi përpunimin e pamjeve satelitore dhe përditësimin e hartave, duke përfshirë inventarin për serat dhe të dhënat mbi sipërfaqen e përgjithshme që ASIG disponon.

IV. Veprimtaria e Institutit të Statistikave – INSTAT

Historiku, vizioni, misioni, vlerat

INSTAT-i është institucioni prodhues kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, i themeluar në vitin 1993 në zbatim të ligjit nr. 7687, datë 16.03.1993 “Për statistikën”. Në atë kohë, Instituti i Statistikave ishte institucion qendror në varësi të Këshillit të Ministrave, i cili kishte për kompetencë të miratonte numrin e punonjësve të drejtorive apo sektorëve të statistikës në ministri e institucione qendrore, si dhe drejtorive të statistikës në rrethe. Në varësi të drejtpërdrejtë të Institutit të Statistikës u krijuan drejtoritë e statistikës në rrethe ndërkohë që drejtori i Institutit të Statistikës miratonte drejtorët ose përgjegjësat dhe punonjësit e statistikës në ministri apo institucionet e tjera qendrore, me propozim të titullarit përkatës.¹ Këshilli i Statistikës ishte organ konsultativ, drejtohej nga drejtori i Institutit të Statistikës, i cili miratonte edhe përbërjen e këtij Këshilli.

Në vitin 2004, në zbatim të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, për herë të parë në legjislacionin e statistikave zyrtare u përfshinë detyrimet e prodhuesve të statistikave zyrtare për zbatimin e parimeve të statistikave zyrtare sipas *acquis communautaire*. Instituti i Statistikës u quajt “Institut i Statistikave” dhe mori akronimin “INSTAT”. Me ndryshimet që pësoi ligji në vitet 2010-2013, u formalizua për herë të parë “Sistemi Kombëtar Statistikor” dhe INSTAT u ngarkua me detyrën e koordinatorit të këtij sistemi. INSTAT u pozicionua në varësi të Kryeministrit dhe punonjësit u bënë pjesë e shërbimit civil. Këshilli i Statistikave mori kompetenca vendimmarrëse, ku vlen të përmendet detyrimi për kryerjen e një procedure publike rekrutimi për titullarin e INSTAT-it dhe propozimin e kandidatëve Kryeministrit për emërim. Për herë të parë Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it emërohej për një kohë të caktuar prej 5 vjetëve, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.²

Sipas ligjit të vitit 2004, për herë të parë prodhuesit e statistikave u detyruan të operonin sipas një programi pesëvjeçar të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili përkon me periudhën 2007-2011.

Në vitin 2018, legjislacioni për statistikat zyrtare u rishikua në tërësinë e tij me qëllim përafrimin e plotë me kërkesat e Rregullores (KE) 223/2009 “Për statistikat evropiane”. Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” përafroi jo vetëm standardet e kësaj rregulloreje, por edhe parimet e statistikave zyrtare të parashikuara në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. Për të garantuar pavarësinë profesionale dhe rritjen e besueshmërisë së publikut në statistika, INSTAT u krijua si institucion i pavarur i cili i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it u ngarkua të përfaqësonte Sistemin Kombëtar Statistikor, si dhe të nxirrte udhëzime e standarde për prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare, me qëllim që të sigurohej zbatimi i parimeve të statistikave zyrtare sipas neneve 4 dhe 5 të ligjit të lartpërmendur. Këshilli i Statistikave rimori kompetencën e një organi këshillues. Kuvendi i Shqipërisë emëron Drejtorin e Përgjithshëm në vijim të

¹Neni 7 i Ligjit nr.7687, datë 16.03.1993 “Për statistikën”

²Neni 9 i Ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar

një procedure publike transparente përzgjedhje. Programi pesëvjeçar zbatohet sipas një Plani Vjetor i cili gjithashtu miratohet nga Kuvendi.

Sipas raporteve të tyre periodike të progresit, reforma legjislativë për prodhimin e statistikave zyrtare në vend është mirëpritur nga Eurostat dhe Komisioni Evropian.

Viti 2024 shënoi 100 vjetorin e krijimit të zyrës së parë të statistikave zyrtare. Më 26 Dhjetor 2024 Instituti i Statistikave organizoi një aktivitet të veçantë për të shënuar 100-vjetorin e statistikave zyrtare në Shqipëri. Në kuadër të këtij përvjetori historik, u prezantua Muzeu i Statistikave, një hapësirë e veçantë që ekspozon botime të statistikave të cilat datojnë nga viti 1923 e deri më sot, si dhe pajisje të ndryshme teknologjike dhe mjete pune të përdorura ndër vite nga statisticienët. Në këtë muze u paraqitën dokumentet dhe publikimet e para statistikore, si dhe objektet dhe teknologjitë e hershme të mbledhjes së të dhënave nëpërmjet të cilave punonin statisticienët tanë. Ky muze është vlerësim për të gjithë ata që kanë kontribuar në zhvillimin e statistikave zyrtare, një pasqyrë e rëndësisë së tyre në ndërtimin e politikave kombëtare dhe të ekzistencës së hershme të shtetit shqiptar. Të ftuar ishin ish-punonjës të INSTAT, përfaqësues të Ministrive, të Këshillit të Statistikave, të botës akademike, organizmave ndërkombëtare, etj. Ky aktivitet përforcon angazhimin e INSTAT për të ruajtur dhe promovuar historinë dhe rëndësinë e statistikave zyrtare, duke i dhënë brezave të rinj mundësinë për të mësuar nga trashëgimia e vyer e këtij institucioni.

Misioni, Vizioni, Vlerat

Misioni

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika asnjansë, transparente dhe të përditësuar, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit.

Vizioni

INSTAT, si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare dhe koordinatori i sistemit kombëtar statistikor, synon të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikorë.

Vlerat

Profesionalizmi:

- Besueshmëria
- Objektiviteti
- Bashkëpunimi dhe Komunikimi
- Identifikimi me INSTAT
- Të qënurit i orientuar ndaj përdoruesve
- Të qënurit i orientuar ndaj cilësisë
- Orientimi ndaj zgjidhjeve
- Iniciativa
- Përgjegjshmëria

Integriteti:

- Respekti ndaj njëri tjetrit
- Dinjiteti
- Barazia
- Respektimi i mendimit ndryshe

- Mbështetja ndaj njëri tjetrit
- Shkëmbimi i njohurive

Motivimi:

- Përfshirja në procese
- Fleksibiliteti
- Dhënia e *feedback*
- Qëndrueshmëria

Integrimi Evropian

INSTAT po punon intensivisht në kuadër të zbatimit të hapave drejt Integrimit Evropian. Pas marrjes së raportit *screening* të Komisionit Evropian, për Kapitullin 18 “Statistikat”, INSTAT ka përgatitur Pozicionin Negociues për Kapitullin 18. Bazuar në gjetjet e Komisionit dhe të takimit bilateral, janë përgatitur për çdo fushë dhe nënfushë të Kapitullit planet konkrete, me afatet kohore përkatëse, për arritjen e standardeve evropiane dhe përafrimin me *EU acquis*.

Më 15 Tetor 2024, u hapën negociatat për Kapitullin 18 “Statistikat”, si pjesë e Grupit të parë të kapitujve.

Duke qenë se për Kapitullin 18 mbi “Statistikat” kërkohet një transpozim në legjislacionin kombëtar, INSTAT ka përfshirë 1 projekt udhëzim të Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT dhe 1 projektligj në Planin Kombëtar të Integrimit Evropian (PKIE) në 2024-2026, për miratim në vitin 2025.

Në Dhjetor 2024 u miratua në mbledhjen Bordit Drejtues të INSTAT, projekt-udhëzimi i Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT “Për krijimin e një kornize të përbashkët për statistikat evropiane në lidhje me personat dhe familjet, bazuar në të dhënat në nivel individual të mbledhura nga kampioni”, parashikuar për miratim në katërmujorin e 3-të 2024. Lidhur me projektligjin “Për Realizimin e Censit të Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore”, INSTAT ka përgatitur draft projektligjin, por miratimi i tij ka kaluar si kompetencë tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nga Kryeministria. Për këtë arsye, projektligji u shty për miratim në PKIE 2025 - 2027 në katërmujorin e tretë dhe institucioni përgjegjës për raportimin e projektligjit do të jetë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr.94, datë 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin Evropian”, INSTAT zhvilloi takime periodike sipas kalendarit të parashikuar në Paketën e Semestrit dhe Integrimit Evropian (PSIE).

Mbështetur në VKM nr.749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, si dhe në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian”, INSTAT përditësoi listën e anëtarëve të “Tryezës së Diskutimit “Statistikat” për Kapitullin 18 me 11 përfaqësues nga shoqëria civile, shoqatat e biznesit dhe bota akademike, të cilët kanë shprehur interes dhe janë bërë pjesë e kësaj tryeze, për të kontribuar në kuadër të Platformës së Partneritetit Publik për Integrimin Evropian. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2024, INSTAT-i organizoi 2 takime konsultuese dhe informative.

INSTAT, gjatë vitit 2024, në cilësinë e anëtarit të grupit negociator përgjegjës për Kapitullin 18 “Statistikat”, ka marrë pjesë dhe ka kontribuar rregullisht në takimet periodike të Grupit Negociator dhe gjithashtu ka kryer raportimet tremujore pranë Kryenegociatorit, për rezultatet e arritura dhe problematikat.

Kapitulli 18: Statistikat

Statistikat evropiane zhvillohen, prodhohen dhe shpërndahen nga Shtetet Anëtare të BE-së, duke u udhëhequr nga parimet dhe kriteret e cilësisë të përcaktuara në Rregulloren e Statistikave Evropiane, ku përfshihet pavarësia profesionale, paanshmëria, besueshmëria, aksesueshmëria dhe konfidencialiteti statistikor.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e statistikave dhe ka bërë përparime në përmirësimin e transmetimit të të dhënave drejt Eurostat-it. Megjithatë, rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten ende të vlefshme.

Prioritetet për vitin 2024

Rekomandimi i Progres raportit 2024	Progresi i arritur
Publikimi i të dhënave të detajuara dhe analizat tematike të Censit të Popullsisë dhe Banesave pas publikimit fillestar në qershor 2024.	✓ Më datë 31 Tetor 2024, INSTAT publikoi sipas afateve rezultatet përfundimtare të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 në nivel Qarku, Bashkie dhe Njësie Administrative, ku u publikuan rezultatet për 12 qarqe; ✓ Janë identifikuar tematikat dhe po punohet për ngritjen e grupeve të punës me partnerët ndërkombëtarë dhe botën akademike. Aktualisht puna është fokusuar në përgatitjen e draft-raporteve mbi: • Cilësinë; • Grupet vulnerabël.
Realizimi i Censit të Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së dhe standardet ndërkombëtare përkatëse.	✓ Miratimi i Ligjit për Censin e Bujqësisë nga Kuvendi i Shqipërisë pritet në vitin 2025, i cili ka kaluar për ndjekje në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; ✓ Asistencë teknike nga Delegacioni Evropian mbi metodologjinë; ✓ Mbështetja do vijojë me asistencë teknike në fushën e IT-së; ✓ Organizimi i takimeve me donatorë dhe me FAO-n specifikisht.
Reduktimi i lëvizshmërisë së stafit.	✓ Rritje e numrit të punonjësve përmes Programit të Statistikave Zyrtare 2022 – 2026 me 24 punonjës; ✓ Komunikim i vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse në vend për të konsideruar databazën e INSTAT, si databazë shtetërore; ✓ Trajnim i vazhdueshëm i stafit.

Përmirësimi i sigurisë kibernetike.	Pas sulmit kibernetik, INSTAT ka përfunduar një sërë masash të rëndësishme për përforcimin e sigurisë dhe rindërtimin e infrastrukturës së saj të teknologjisë së informacionit. ✓ Është realizuar një rindërtim i plotë i infrastrukturës IT, duke zbatuar rekomandimet më të fundit të sigurisë kibernetike dhe praktikën më të mira ndërkombëtare; ✓ Janë zbatuar zgjidhje të avancuara për mbrojtjen e pajisjeve fundore (<i>endpoint protection</i>), si për serverat ashtu edhe për pajisjet e përdoruesve, duke garantuar një nivel më të lartë kontrolli dhe reagimi ndaj kërcënimeve; ✓ Është finalizuar kalimi i sistemit të postës elektronike <i>Exchange</i> në një platformë <i>cloud</i> të sigurt, duke rritur sigurinë, disponueshmërinë dhe fleksibilitetin e komunikimit të brendshëm; ✓ Është miratuar shtimi i dy pozicioneve të reja për specialistë, të cilët do të forcojnë kapacitetet e Sektorit të Administrimit të Sistemeve IT dhe Datacenter-it, me detyra të dedikuara për monitorimin dhe garantimin e sigurisë kibernetike të sistemeve të INSTAT.
Rritja e prodhimit dhe transmetimit të të dhënave të përditësuara dhe me cilësi të lartë për shpërndarje nga Eurostat, duke siguruar që statistikën financiare të qeverisë (GFS) të jenë të disponueshme për publikun.	✓ Fokusi kryesor ka qenë rritja e nivelit të përafritimit të treguesve statistikorë me kërkesat e <i>acquis communautaire</i>, duke përmirësuar metodologjitë në përpilimin e treguesve; prodhimin, publikimin dhe transmetimin e treguesve të rinj, si dhe në zgjerimin e serive kohore të transmetuara në EUROSTAT, për treguesit e llogarive kombëtare, statistikën e demografisë së ndërmarrjeve dhe statistikën afatshkurtra; ✓ Finalizimi i Revizionimit Madhor të Llogarive Kombëtare, Shtator 2024, në përputhje të plotë me Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane dhe Politikën e Harmonizuar Evropiane për Rishikimin e Statistikave Makroekonomike.

Përputhshmëria ligjore dhe infrastruktura statistikore vlerësimi dhe rekomandimet për vitet në vijim

Rregullat e përbashkëta për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor janë të përcaktuara në *acquis* të BE-së për statistikën. Legjislacioni i Shqipërisë është në përputhje me standardet evropiane, duke respektuar parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane. Shumica e klasifikimeve statistikore janë gjithashtu të harmonizuara me BE-në.

Plani vjetor i statistikave për vitin 2024 është miratuar nga Parlamenti, por INSTAT vazhdon të përballet me kufizime në kapacitete dhe lëvizje të stafit. Sulmet kibernetike në fillim të vitit 2024 ndikuan në operacionet statistikore, duke theksuar nevojën për investime në infrastrukturën IT dhe forcimin e sigurisë kibernetike.

Statistikat Makroekonomike - vlerësim

Shqipëria është pjesërisht në përputhje me Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA 2010). Ka përmirësime në prodhimin dhe transmetimin e të dhënave në Eurostat, përfshirë:

- Llogaritë Kombëtare dhe Rajonale;
- Tabelat e Njoftimit të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar (EDP);
- Statistikat Financiare të Qeverisë (GFS);
- Tregtinë ndërkombëtare të mallrave

Rekomandimi i Progres raportit 2024	Progresi i arritur
Nevojiten përmirësime në Llogaritë Kombëtare Vjetore sipas Sektorëve Institucionalë.	Në shtator 2024 INSTAT realizoi Rishikimin Madhor të Llogarive Kombëtare. Finalizimi i këtij procesi ishte jo vetëm publikimi i serive të përditësuara kohore të Llogarive Kombëtare, por dhe tregues të rinj statistikor, rritje e plotshmërisë së tabelave të prodhuara dhe transmetuara, aplikimi i metodave të reja statistikore dhe përmirësim të atyre ekzistuese. Rezultatet e këtij rishikimi përfshinë: ✓ Integrimin e plotë të tabelave Burim-Përdorimeve në procesin e vlerësimit të Llogarive Kombëtare; ✓ Integrimin për herë të parë të sistemit të Llogarive të Sektorëve Institucionalë në sistemin e Llogarive Kombëtare; ✓ Publikimin për herë të parë të Prodhimit të Brendshëm Bruto me të tre metodat e vlerësimit: prodhim, shpenzime dhe të ardhura, plotësisht konsistente dhe duke eliminuar mospërputhjet statistikore; ✓ Përpilimin dhe publikimin për herë të parë të setit të plotë të llogarive sipas Sektorëve Institucionalë, 2013 – 2023; ✓ Përmirësime të metodave të vlerësimit statistikor dhe zbatimi i metodave të reja statistikore në përputhje me standardet statistikore ndërkombëtare, të realizuara pas vitit 2014, nën asistencën e Bashkimit Evropian, nëpërmjet projekteve IPA Shumë përfituese dhe Eurostat në fushën e Llogarive Kombëtare; ✓ Përmirësime të burimeve të të dhënave, integrimin e tyre dhe aplikimin e metodave të reja në vlerësimin e treguesve për sektorin e Qeverisjes së Përgjithshme; ✓ Rritje të plotshmërisë së treguesve dhe tabelave të publikuara në faqen zyrtare të INSTAT dhe të transmetuara në Eurostat. ✓ Rritje të cilësisë, nivelit të krahasueshmërisë dhe përputhshmërisë së treguesve statistikorë; ✓ Përmirësim të afateve kohore të përpunimit dhe publikimit të të dhënave në përputhje me standardet Evropiane të prodhimit dhe publikimit të Llogarive Kombëtare. ✓ Përmirësim dhe rritje e konsistencës së statistikave financiare të Qeverisë dhe tabelave të njoftimit të deficitit të tejkaluar (GFS – EDP), të cilat janë transmetuar me statusin “best efforts”; ✓ Harmonizimin e afateve të publikimit të të dhënave me Programin e Transmetimit ESA 2010, duke rritur përputhshmërinë me Eurostat dhe institucionet ndërkombëtare; ✓ Përmirësimin e llogarive kombëtare rajonale; Këto përmirësime kanë kontribuar në rritjen e cilësisë, krahasueshmërisë dhe transparencës së statistikave kombëtare, duke forcuar rolin e tyre në procesin e integritetit evropian dhe në vendimmarrjen ekonomike, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Nevojiten përmirësime në Llogaritë Financiare, si dhe transmetimin e indekseve të harmonizuara të çmimeve të konsumit me norma tatimore konstante.	✓ Rishikimi madhor i Llogarive Kombëtare kontribuoi në përpilimin dhe transmetimin gradual të statistikave financiare të qeverisë dhe tabelave të njoftimit të deficitit të tejkaluar (GFS – EDP).
Nevojiten përmirësime në Bilancin Mjor të Pagesave.	✓ Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar testime për përputhshmërinë e të dhënave mjore të Bilancit të Pagesave me të dhënat 3-mjore. Gjatë vitit 2025 do të realizohet transmetimi në Eurostat i Bilancit të Pagesave me bazë mjore.
Shqipëria duhet të lejojë publikimin e të dhënave të saj të Statistikave të Financiare të Qeverisë (GFS) të dorëzuara në Eurostat, mbi bazën e përpjekjeve më të mira/sipas mundësive.	✓ Në vitin 2024 u rishikuan të gjitha vlerësimet në kuadër të rishikimit madhor dhe u implementuan përmirësimet në seri kohore sipas kërkesave të programit të transmetimit ESA 2010. INSTAT në bashkëpunim me agjencitë statistikore vijon punën për rritjen e cilësisë dhe krahasueshmërisë të Statistikave të Financiare të Qeverisë (GFS).

Statistikat e Biznesit - vlerësim

Statistikat afatshkurtra për industrinë, ndërtimin, tregtinë me pakicë dhe shërbimet e tjera janë pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Ndërkohë vlerësohet niveli i përgjigjeve të larta në anketat e bizneseve dhe të familjeve.

Rekomandimi i Progres raportit 2024	Progresi i arritur
Transmetimi i treguesve si: • Shitjet neto në industri • Orët e punës • Treguesit e regjistrimeve të bizneseve dhe falimentimet	✓ Në dhjetor 2023 u transmetuan për herë të parë treguesi regjistrimet dhe falimentimet e ndërmarrjeve në përputhje me rregulloren, transmetim i cili ka vazhduar rregullisht gjatë vitit 2024; ✓ Transmetimi për herë të parë gjatë vitit 2024 i të dhënave mjore për shitjet neto në industri (seria kohore, Janar 2011-Shtator 2024). Demografia e Ndërmarrjeve: ✓ U krijua Regjistri i serive kohore për qëllime të Demografisë së Ndërmarrjeve për periudhën e referencës 2015-2023. Treguesit kryesorë që janë përpunuar dhe përgatitur për transmetim në Eurostat janë: ○ Ndërmarrje aktive; ○ Ndërmarrje të reja; ○ Ndërmarrje të mbyllura; ○ Numri i të punësuarve dhe të vetëpunësuarve në ndërmarrjet aktive; ○ Numri i të punësuarve dhe të vetëpunësuarve në ndërmarrjet e reja. ✓ Gjatë vitit 2024 u mundësua nga Eurostat e drejta për të transmetuar të dhënat demografike të ndërmarrjeve. ✓ Vazhdon puna për transmetimin e të dhënave demografike të ndërmarrjeve në përputhje me rregulloret evropiane.

Prodhimi i një grupi të plotë të statistikave për kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin.	Në Dhjetor 2024, u prodhuan dhe transmetuan për herë të parë disa tregues kryesorë lidhur me Kërkim Zhvillimin (K&ZH) si: ✓ Shpërndaja e fondeve të K&ZH sipas sektorëve të performancës; ✓ Shpërndaja e shpenzimeve të K&ZH sipas sektorëve të performancës; ✓ Personeli i angazhuar në K&ZH Në lidhje me Inovacionin në ndërmarrje: ✓ Janë përshtatur kërkesat e reja në lidhje me metodologjinë dhe pyetësonin për çdo raund vrojtimi me rregulloren përkatëse të BE-së. ✓ Publikimi i treguesve kryesorë të inovacionit për periudhën referuese 2020-2022, në Qershor 2024. ✓ Transmetimi i të dhënave në Eurostat, në Gusht 2024.
---	--

Statistikat Sociale - vlerësim

- Anketa e Forcave të Punës realizohet rregullisht dhe të dhënat mikro i dërgohen Eurostat;
- Anketa vjetore për të ardhurat dhe kushtet e jetesës (SILC) është e rregullt;
- Statistikat e krimit publikohen çdo vit.

Rekomandimi i Progres raportit 2024	Progresi i arritur
Mungojnë statistikave të vendeve të lira të punës.	✓ Aktualisht INSTAT mbledh të dhënat administrative për vendet e lira të punës. Këto të dhëna kanë periodicitet tremujor dhe burim informacioni është Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), e cila i publikon. INSTAT ka nisur një seri takimesh me institucione kyçe si AKPA, etj, për të punuar në zhvillimin dhe zbatimin e Statistikave të Vendeve të Lira të Punës, në përputhje me rregulloret dhe standardet përkatëse të Bashkimit Evropian. Qëllimi kryesor i këtyre diskutimeve është krijimi i një kuadri të qartë dhe efektiv për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave mbi vendet e lira të punës. ✓ INSTAT po punon për identifikimin e burimeve më të përshtatshme të të dhënave dhe planifikon t'i përfshijë këto statistika në Planin Zyrtar Statistikor 2027–2031.
Statistikat për migracionin dhe azilin janë pjesërisht në përputhje me acquis të BE-së.	✓ INSTAT ka marrë angazhimin të transmetojë deri në vitin 2026 statistikave në lidhje me mbrojtjen ndërkombëtare/azilin dhe migracionin e menaxhuar në Eurostat. ✓ Nga bashkëpunimi me institucionet në vend, do të sigurohen të dhëna mbi: -Azilkërkues sipas gjinisë, moshës, vendit të origjinës; -Aplikime për azil për herë të parë sipas gjinisë, moshës, vendit të origjinës; -Personat që fitojnë mbrojtje të përkohshme në shkallë të parë sipas moshës, gjinisë dhe shtetësisë;

	-Personat me statusin (refugjat, mbrojtje plotësuese, mbrojtje e përkohshme) vendimi përfundimtar sipas moshës, gjinisë dhe shtetësisë në shkallë të parë; -Tërheqjet në shkallë të parë sipas llojit të statusit të tërheqjes; -Fitimi i shtetësisë sipas vitit të lindjes, gjinisë dhe shtetësisë se mëparshme. Sigurimi i këtyre informacioneve do të rrisë shkallën e përputhshmërisë me aktet komunitare.
Klasifikimi Ndërkombëtar i Krimeve për Qëllime Statistike (ICCS) nuk është ende i zbatuar.	✓ INSTAT ka filluar punën dhe deri në vitin 2026 është i angazhuar të zbatojë plotësisht statistikën që lidhen me legjislacionin penal në përputhje me ICCS.
Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje rishikimit të të dhënave për t'i përshtatur ato me kërkesat e raportimit të Eurostat-it, duke marrë në konsideratë vonesat në zbatimin e Censit të Popullsisë dhe Banesave.	✓ Në proces rivekurimit të serisë kohore të të dhënave të popullsisë për periudhën ndërmjet dy censeve (2011-2023).

Statistikat e Bujqësisë - vlerësim

Statistikat bujqësore janë pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Ka përmirësime në përdorimin e regjistrave administrative, por cilësia e të dhënave mbetet sfidë.

Rekomandimi i Progres raportit 2024	Progresi i arritur
Përditësimi i planit të punës dhe buxhetit të Censit të Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore.	✓ INSTAT po rishikon planin e punës, në përputhje me vitin e realizimit të tij; ✓ INSTAT po rishikon draftin e Buxhetit të Censit.
Sigurimi i miratimit të ligjit për Censin e Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore.	✓ Miratimi i Ligjit për Censin e Bujqësisë nga Kuvendi i Shqipërisë pritet në vitin 2025", i cili ka kaluar për ndjekje në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
Finalizimi i pyetësorit dhe logjistikës së nevojshme për Censin e Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore.	✓ Draft pyetësori është përfunduar dhe po konsultohet me asistencën teknike. ✓ INSTAT po zhvillon platformën elektronike për grumbullimin e informacionit në terren.

Statistikat e Mjedisit dhe të Energjisë - vlerësim

Statistikat e mjedisit janë pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Shqipëria mbledh të dhëna mbi mbetjet në nivel bashkie.

Rekomandimi i Progres raportit 2024	Progresi i arritur
Mungojnë statistikën mbi mbetjet industriale dhe plastike.	✓ INSTAT prodhon dhe transmeton informacion mbi statistikën e mbetjeve industriale dhe bashkiake, të kategorizuara sipas llojit dhe origjinës, duke filluar nga viti 2024 e në vazhdim; ✓ Transmetimi vjetor i mbetjeve komunale në nivelin NUTS 2, ka filluar në vitin 2024;

	✓ Po punohet për disponueshmërinë e të dhënave për kapacitetin e objekteve të mbetjeve e cila pritet të finalizohet deri në vitin 2026; ✓ Ngritja e kapaciteteve të stafit, duke marrë pjesë në grupe pune të Eurostat, duke qenë se statistikatat e mbetjeve janë një fushë relativisht e re për INSTAT.
Statistikat e energjisë kërkojnë përmirësime të mëdha për të arritur përputhjen e plotë me kërkesat e BE-së.	✓ Përmirësimi i afatit të raportimit mujor për pyetësorët e energjisë; ✓ Raportimi sipas afateve për çmimet e energjisë; ✓ Përmirësimi i të dhënave për burimet e rinovueshme, për konsumatorët vetjakë, dhe për pompat e nxehtësisë; ✓ Plotësimi i pyetësorëve të konsumit të energjisë për sektorët pranë familjeve, shërbimeve, transportit dhe industrisë.

Përsa i përket kontributit të INSTAT në Nënkomitete, gjatë vitit 2024, INSTAT kontribuoi në Nënkomitetet si vijon:

- Nënkomiteti i 16-të, i “Çështjeve Ekonomike Financiare dhe Statistikat, ECOFIN”;
- Nënkomiteti “Bujqësia dhe Peshkimi” Agrifish;
- Nënkomiteti “Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet”;
- Nënkomiteti “Drejtësia, Liria dhe Siguria”;
- Nënkomitetit “Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale.

1) Në Nënkomitetin e 16-të, të Çështjeve Ekonomike Financiare dhe Statistikat, ECOFIN, organizuar më datë 25 Shtator 2024, INSTAT raportoi mbi:

- Zhvillimet më të fundit të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe Legjislacionit;
- Progresin e bërë në zbatim të rekomandimeve të Peer Review 2018 në Sistemin Kombëtar Statistikor në Shqipëri;
- Përditësimet më të fundit lidhur me Censin e Popullsisë dhe Banesave 2023;
- Përditësimet mbi Llogaritë Kombëtare Tremujore dhe Vjetore sipas ESA 2010, duke përfshirë njoftimin për GFS dhe EDP;
- Statistikat e Bujqësisë, progresin e zbatimit të rekomandimeve të rishikimit sektorial të statistikave të Bujqësisë dhe planet për Censin e ardhshëm të Bujqësisë (përfshirë përgatitjen e ligjit dhe sigurimin e fondeve).

2) Në Nënkomitetin e 16-të, “Bujqësia dhe Peshkimi, Agrifish”, të organizuar më datë 3 Dhjetor 2024, INSTAT raportoi sipas agjendës si vijon:

- Censi i Bujqësisë – rezultate nga censi i vitit 2012 dhe përgatitja për censin e ardhshëm (përcaktim i qartë i roleve të aktorëve të përfshirë (INSTAT, MBZHR, Plani i Veprimit);
- Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të rishikimit të sektorit për statistikatat e bujqësisë;
- Kapaciteti administrativ dhe shkencor, grumbullimi i kapjes, statistikatat e zbarkimit (përfshirë ditarin), si dhe të dhënat përkatëse biologjike dhe socio-ekonomike. Përditësim për forcimin e aktiviteteve të mbledhjes së të dhënave.

3) Në Nënkomitetin e 15-të, “Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet”, të organizuar më datë 23 – 24 Tetor 2024, INSTAT dhe Banka e Shqipërisë raportuan mbi:

- Shkëmbimet e statistikave të tregtisë së mallrave;
- Statistikat e tregtisë së mallrave me vendet e BE-së, CEFTA-s, Rusisë dhe Ukrainës
- Statistikat e Investimeve të huaja direkte

4) Në Nënkomitetin e 15-të, “Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale”, të organizuar më datë 1 Shkurt 2024, INSTAT raportoi mbi:

- Anketën e Forcës së Punës;

- Statistikat e Shoqërisë së Informacionit.

Të udhëhequr nga objektivi strategjik nr.4, i Strategjisë së Zhvillimit të INSTAT 2017-2030 “Rritja e bashkëpunimit të INSTAT-it me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare”, INSTAT vazhdon të angazhohet në paraqitjen e raporteve, ideve dhe studimeve, në arenën ndërkombëtare, në fushën e prodhimit dhe zhvillimit statistikor, duke marrë pjesë dhe kontribuar në forume dhe aktivitete të ndryshme botërore të statistikave, si më poshtë vijon:

- 21 Maj 2024 – Takimi i UN-INSTAT Joint Data Group: Agjencitë e Kombeve të Bashkuara diskutuan mbi rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit. Koordinatorja e Përhershme e OKB-së për Shqipërinë, Znj. Fiona McCluney, vlerësoi punën e INSTAT në Censin e Popullsisë dhe Banesave 2023, duke theksuar mbështetjen për analizat e thelluara që INSTAT do të realizojë pas rezultateve të censit.
- 23 Shkurt - 1 Mars 2024 – Pjesëmarrje në Sesionin e 55-të të Komisionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. INSTAT, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, ishte pjesë e disa paneleve, përfshirë si bashkëdrejtues në Grupin e Nivelit të Lartë për Partneritet, Koordinim dhe Ngritjen e Kapaciteteve për Statistikat për Axfordën 2030 (UN HLG-PCCB). Pjesëmarrja u përqëndrua gjithashtu në fuqizimin e grave në udhëheqjen statistikore dhe mbrojtjen e të dhënave në nivel global.
- 15-17 Maj 2024 – Konferenca IAOS-ISI në Mexico City, me temë “Përmirësimi i vendimmarrjes për të gjithë”. Pjesëmarrësit diskutuan rreth sfidave dhe risive në prodhimin e statistikave dhe përdorimin e teknologjive të reja. INSTAT kontribui në diskutime për gjeoinformacionin dhe përpjekjet për përmirësimin e të dhënave dhe edukimit statistikor.
- 29-30 Maj 2024 – Takimi i UNECE/EFTA në Tiranë, për Modernizimin e legjislacionit statistikor, organizuar nga INSTAT. Në këtë takim u diskutua për përmirësimin e kuadrit ligjor të statistikave dhe menaxhimin e të dhënave, duke theksuar rëndësinë e qasjes dhe transparencës në aksesin e të dhënave.
- 20-21 Qershor 2024 – Sesioni Plenar i 72-të të Konferencës së Statisticienëve Evropiane (CES), në Gjenevë. Shqipëria, si drejtues i workshop-it mbi Etikën në Organizatat Moderne Statistikore, paraqiti rezultatet dhe prioritetet e ardhshme në këtë drejtim. INSTAT ndau me vendet tjera perspektivën mbi zbatimin e Sistemit të Llogarive Kombëtare 2025 (SNA2025).
- 15-17 Tetor 2024 – Workshop dhe Takimi i 8-të i Ekspertëve mbi Statistikat për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), në Tiranë, organizuar nga UNECE dhe INSTAT. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 75 ekspertë nga 33 shtete dhe mbi 20 organizata ndërkombëtare. Diskutimet u fokusuan në mbivendosjen e programeve, inovacionin dhe mënyrat për të përmirësuar monitorimin e zhvillimit të qëndrueshëm.
- 9-10 Tetor 2024 – Takimi i Byrosë së Konferencës së Statistikave Evropiane (CES), organizuar në Varshavë, Poloni. Në këtë takim INSTAT diskutoi zhvillimet dhe përparimet në fushat e statistikave në epokën digjitale dhe kontribui në diskutime për integrimin e teknologjive moderne dhe infrastrukturën statistikore në nivel evropian.
- 12-16 Nëntor 2024 – Forumi i 5-të Botëror i të Dhënave të Kombeve të Bashkuara, organizuar në Medellin, Kolumbi. INSTAT kontribui në diskutime mbi inovacionin për të dhëna gjithëpërfshirëse, besimin në të dhëna dhe partneritetet për zhvillimin e qëndrueshëm. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT mori pjesë në panelet dhe drejtimin e mbledhjeve të Grupit të Nivelit të Lartë për Partneritet dhe Kapacitetet në statistika për Agjendën 2030 (HLG-PCCB).

Në zbatim të nën objektivit 4.5 të Strategjisë së Zhvillimit të INSTAT 2017-2030 “Pjesëmarrje aktive në grupet ndërkombëtare të punës, në nivel rajonal, evropian dhe më gjerë” INSTAT ka vijuar kontributin në takimet e nivelit të lartë, në nivel ndërkombëtar, si më poshtë:

- Në takimet periodike të organizuara nga Divizioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara, si bashkëdrejtues i Grupit të Nivelit të Lartë për Partneritet, Koordinim dhe Zhvillim të kapaciteteve për statistikat, Agjenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm – HLG PCCB.
- Në Komitetin e Programit për organizimin e Forumeve Botërore të të Dhënave të Kombeve të Bashkuara.
- Në Komitetin Ekzekutiv të Shoqatës Ndërkombëtare për Statistikat Zyrtare, si përfaqësues i IAOS për ISI për vitet 2023-2025.
- Si Zëvendës Drejtues i Byrosë së Konferencës së Statisticienëve Evropianë të UNECE për vitet 2023-2025.
- Në takimin e Grupit të Nivelit të Lartë për Modernizimin e Statistikave Zyrtare (HLG-MOS) të UNECE
- Në takimin e Grupit të Modernizimit për Aftësitë dhe Komunikimin
- Në Grupin Drejtues të OZHQ-ve të UNECE

Në kuadër të integritit evropian dhe intensifikimit të bashkëpunimit me institucionet partnere të BE-së INSTAT mori pjesë në takimin me temë “Forumi i Statistikave Euro-Mesdhetare”, të organizuar nga Eurostat, në Tiranë, në Nëntor 2024. Qëllimi i takimit ishte forcimi i Sitemit Kombëtar Statistikor, ku nga INSTAT u prezantua puna e bërë në Koordinimin e Sistemit Kombëtar Statistikor.

Koordinimi i Projekteve

Një pjesë e konsiderueshme e zhvillimit të statistikave zyrtare është realizuar në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes së ofruar nga Bashkimi Evropian, Sida (Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar), Zyra e Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në bashkëpunim me Zyrën Federale të Statistikave (FSO) dhe Kombet e Bashkuara. Në vijim paraqitet informacioni më i detajuar në lidhje me ecurinë e këtij bashkëpunimi gjatë vitit 2024 dhe sektorët ku është fokusuar mbështetja.

1) Granti “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020 në Shqipëri, IPA 2014/AL/07”

Projekti “IPA2014/AL/07” ka mbështetur aktivitetet e Censit të Popullsisë dhe Banesave përmes sigurimit të asistencës teknike, fushatës publicitare, rritjes së kapaciteteve të stafit të INSTAT-it dhe sigurimit të bazës IT.

Bazuar në detyrimet e përcaktuara në Marrëveshjen Operacionale ndërmjet INSTAT, Koordinatorit Kombëtar të IPA (KKIPA) dhe Njesisë për financimet dhe kontraktimet (CFCU), nëpërmjet njesisë IPA, INSTAT ka kontribuar në realizimin e aktiviteteve përkatëse si më poshtë:

- Raportimi pranë Ministrisë së Financave, njesisë për financimet dhe kontraktimet (CFCU) dhe pranë Agjencisë Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), mbi progresin e zbatimit të aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave përmes raporteve mujore, 3 mujore, 6 mujore dhe raporteve vjetore;
- Përgatitja dhe dërgimi pranë autoritetit kontraktues/CFCU, i raporteve narrative dhe financiare 6 mujore të kontratës së Grantit;
- Monitorimi i procedurave të prokurimit, të kryera gjatë këtij viti, si dhe përgatitja dhe monitorimi i procesit të certifikimit ‘ex-post’, të procedurave të prokurimit të financuara nga fondet e Bashkimit Evropian.

Më 31 Janar 2024, INSTAT-i u përball me një sulm kibernetik që synonte infrastrukturën digjitale, duke paraqitur një kërcënim për sigurinë e të dhënave dhe integritetin operativ. Në vijim të kësaj situate, më 22 Shkurt 2024, u zhvillua një takim me donatorët. Ky takim pati si qëllim të ofronte një pasqyrë të zhvillimeve të fundit të procesit të Censit, si dhe prezantimin e planit për periudhën në vijim. Gjatë këtij takimi, u diskutuan pasojat e sulmit kibernetik, si dhe nevojat për mbështetje për të minimizuar pasojat e këtij sulmi. Takimi theksoi

rëndësinë e përmirësimit të masave të sigurisë, duke siguruar mbështetje nga donatorët për infrastrukturën digjitale në mënyrë që të dhënat të jenë të mbrojtura dhe të qëndrueshme. Si rrjedhojë, INSTAT-i organizoi takime dypalëshe me delegacionin e Bashkimit Evropian, Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) dhe Zyrën e Bashkëpunimit Zvicerian për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) për të trajtuar kërkesat për mbështetje financiare.

Kontrata “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020 në Shqipëri, IPA 2014/AL/07” është finalizuar më 11.12.2024, duke shënuar mbylljen e aktiviteteve nën kontributin e BE-së.

2) Kontratë Shërbimi “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022 në Shqipëri”

Kontrata e shërbimit “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022 në Shqipëri,” është pjesë e kontratës së Grantit. Periudha e zbatimit të kësaj kontratë është 21.06.2019-31.07.2024. Qëllimi i kontratës ishte të mbështesë INSTAT-in me asistencë teknike për realizimin e aktiviteteve të Censit. Gjatë vitit 2024 asistenca është fokusuar në përgatitjen e tabelave për publikimin e rezultateve kryesore të Censit.

Konferenca për prezantimin e rezultateve kryesore të Censit u mbajt me datë 28 Qershor 2024. Gjithashtu, në vijim të lancimit të rezultateve kryesore, më 31 tetor 2024, INSTAT organizoi një seminar final për publikimin e rezultateve të Censit në nivel qarku/bashkie/njësie administrative.

3) Programi i Bashkëpunimit Statistikor shumë-përfitues – IPA 2019

Programi i bashkëpunimit statistikor shumë-përfitues IPA 2019 siguron mbështetje statistikore nëpërmjet asistencës teknike dhe zhvillimit të kapaciteteve të stafit të INSTAT dhe Sistemit Kombëtar Statistikor në tërësi. Periudha e zbatimit të kontratës ka filluar më 01.09.2021 dhe përfundoi më 31.03.2024. Objektivi i përgjithshëm i programit ishte të përgatisë Sistemin Statistikor në Shqipëri në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke përshtatur metodologjitë me *acquis communautaire* dhe duke i integruar dhe harmonizuar ato në Sistemin Evropian të Statistikave.

Gjatë vitit 2024, programi IPA 2019 ka mbështetur INSTAT-in përmes ngritjes së kapaciteteve të stafit të INSTAT, në përmirësimin e mëtejshëm të zbatimit të rekomandimeve bazë dhe metodologjisë në transmetimin e vazhdueshëm të të dhënave në lidhje me Statistikat e Financave të Qeverisë (GFS) dhe statistikave të Deficitit të Tejkuluar (EDP), Indekset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumit (HICP) dhe Indeksin e Çmimeve të Banesave (HPI), Matjen e Fuqisë Blerëse (PPP), Statistikat Afatshkurtra të Biznesit, Anketën e Forcave të Punës, Llogaritë Ekonomike në Mjedis, Statistikat e Mbetjeve, si dhe Menaxhimin e Cilësisë së të Dhënave dhe Metadateve.

Më poshtë paraqiten projektet statistikore të zbatuara gjatë vitit të këtij Programi:

- Projekti Statistikor 1.1 “Statistikat e Financiare të Qeverisë dhe Deficitit të Tejkuluar;
- Projekti Statistikor 2.1 “Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (HICP)” dhe “Indeksi i Çmimeve të Banesave (HPI)”;
- Projekti Statistikor 2.2 “Statistikat e Çmimeve”;
- Projekti Statistikor 3.2 “Statistikat Afatshkurtra të Biznesit”;
- Projekti Statistikor 4.1 “Anketa e Forcave të Punës”;
- Projekti Statistikor 5.5 “Llogaritë Ekonomike në Mjedis”;
- Projekti Statistikor 5.6 “Statistikat e Mbetjeve”;
- Projekti Statistikor 6.1 “Menaxhimi i Cilësisë”;
- Projekti Statistikor 6.2 “Metadate”.

4) Programi i Bashkëpunimit Statistikor ShumëPërfitues – IPA 2022

Më datë 22.12.2023 u nënshkrua kontrata e Grantit Nr. 2023.0333 “Programi i Bashkëpunimit Statistikor ShumëPërfitues IPA 2022”. Në Janar 2024 filloi zbatimi i Programit IPA 2022 me Shumë Përfitues. Mbështetja fokusohet në 15 fusha statistikore, në një prej të cilave përfitues është Banka e Shqipërisë. Mbështetja ofrohet përkatësisht për Statistikat si: Statistikat Financiare të Qeverisë dhe Deficitit të Tejkualuar, Indekset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumit (HICP), Indeksi i Çmimeve të Banesave (HPI); Barazitë e Fuqisë Blerëse (PPP), Statistikat Afatshkurtra të Biznesit, Statistikat e Transportit, Statistikat Strukturore të Biznesit, Anketa e Forcave së Punës, Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, Sistemi i Integruar Evropian për Mbrojtjen Sociale, Llogaritë Ekonomike në Mjedis, Statistikat e ujit, Menaxhimi i Cilësisë, Zhvillimi i Qëndrueshëm, Statistikat e qytetit/informacioni gjeografik, si dhe Investimet e huaja direkte (përfitues i së cilës është Banka e Shqipërisë). Mbështetja fokusohet gjithashtu në cilësinë e prodhimit të statistikave dhe transmetimit të të dhënave, sigurimin e ekspertizës, si rritje të kapaciteteve të stafit të INSTAT të përfshirë në këto projekte statistikore.

Objektivat e këtij Programi janë:

- Përmirësimi dhe forcimi i sistemeve statistikore në vendet përfituese dhe forcimi i mëtejshëm i integritetit të përfituesve brenda Sistemit Statistikor Evropian
- Përmirësimi i disponueshmërisë, besueshmërisë, cilësisë dhe krahasueshmërisë së të dhënave statistikore në vendet përfituese, që është thelbësor për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave evropiane (si Strategjia e Ballkanit Perëndimor, Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor, dialogët politikë me Turqinë) dhe për përgatitjen e vendeve partnere për anëtarësimin e ardhshëm në BE.
- Mbështetja e përpjekjeve për të siguruar pavarësinë profesionale të Institucioneve Kombëtare të Statistikave të vendeve përfituese dhe forcimi i rolit të qeverisjes së instituteve statistikore si koordinatorë të sistemit zyrtar statistikor, duke rritur besimin dhe sigurinë në statistikatat zyrtare nga përdoruesit.
- Përmirësimi i efikasitetit të Sistemit Kombëtar Statistikor në vendet përfituese, duke përdorur metoda moderne dhe me kosto efektive për prodhimin e statistikave (si përdorimi i regjistrave administrative dhe burimeve të tjera të reja të të dhënave).

5) Projekti “Financim direkt për të mbështetur INSTAT për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022”, mbështetur nga Sida

Në kuadër të kontratës së Grantit Nr. 12550, nënshkruar ndërmjet Ambasadës Suedeze dhe INSTAT-it, me objekt “Financimin e drejtpërdrejtë për të mbështetur INSTAT-in për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022”, më datë 24.01.2024 është nënshkruar amendimi Nr.2 i marrëveshjes, i cili përfundon më 31.05.2025. Gjatë vitit 2024, mbështetja është fokusuar në përmirësimin e infrastrukturës së IT dhe sigurinë e të dhënave të Censit, duke siguruar mirëmbajtjen e infrastrukturës së IT për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave, si dhe sigurimin e paisjeve për segmentimin e rrjetit të INSTAT-it, duke kontribuar në forcimin e sigurisë së informacionit dhe garantimin e një infrastrukture më të qëndrueshme për përpunimin e të dhënave të Censit. Gjithashtu, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, në kuadër të kontributit të Sida, janë kontraktuar ekspertë për përgatitjen e analizave të thelluara mbi rezultatet e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023. Ky projekt ka mundësuar zhvillimin e raporteve dhe analizave të detajuara për të dhënat e Censit në nivel qarku/bashkie/njësie administrative, duke mbështetur procesin e analizës dhe publikimit të të dhënave.

6) Mbështetje për Statistika të Forta Vendore Shqiptare (SALSTAT)

Projekti “Mbështetje për Statistika të Forta Vendore Shqiptare” (SALSTAT) është pjesë e programit “Bashki të Forta”, financuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. SALSTAT-i është një projekt bashkëpunimi ndërmjet Zyrës Statistikore Federale Zviceriane dhe INSTAT-it, me qëllim sigurimin e përmirësimit të statistikave në nivel lokal dhe rajonal, në mënyrë që bashkitë t’i ofrojnë qytetarëve shërbime efektive, eficiente dhe gjithëpërfshirëse. Projekti ka filluar periudhën e dytë të zbatimit nga viti 2022 deri në vitin 2026. Në kuadër të fazës së re, SALSTAT ka vijuar intensifikimin e bashkëpunimit me bashkitë dhe agjencitë e tjera qeveritare, për të forcuar besimin te statistikatat zyrtare dhe për të përfshirë grupet e interesit në një diskutim lidhur me përfitimet nga statistikatat zyrtare, qeverisjen demokratike dhe procesin e

vendimarrjes, si dhe veçanërisht sa i përket përmbushjes së detyrave, përgjegjësi dhe funksioneve të bashkive.

Gjatë vitit 2024, SALSTAT ka kontribuar në mbështetjen e INSTAT për ndërtimin e Regjistrit Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave, duke ofruar trajnime për bashkitë, si furnizues dhe përdorues të të dhënave dhe duke organizuar seminare në fusha të ndryshme. Temat kryesore të trajnimeve ishin mbi statistikën e mbetjeve dhe përdorimin e gjuhëve të programimit “PYTHON” dhe “R”. SALSTAT ka kontribuar në përgatitjen e pyetësorëve dhe ka mbështetur INSTAT-in, pas sulmit kibernetik të Janarit 2024, me blerjen e mjeteve për sigurinë kibernetike. Gjithashtu, është mbështetur publikimi i të dhënave të Censit 2023, duke përfshirë printimin e 12 botimeve të dedikuara për qarqet e Shqipërisë.

7) Asistencë Teknike – Censi i Bujqësisë

Për realizimin me sukses të Censit të Bujqësisë, INSTAT ka kërkuar mbështetje *ad-hoc* nga Bashkimi Evropian. Më datë 18 Dhjetor 2023, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë ka nënshkruar një marrëveshje kuadër me një kohëzgjatje prej 18 muajsh. Qëllimi i kësaj kontrate është ofrimi i asistencës teknike për INSTAT për realizimin e Censit të Bujqësisë, i fokusuar në dy komponente:

- Aspektet metodologjike, duke përfshirë përgatitjen e pyetësorit të Censit të Bujqësisë;
- Mbështetje në zhvillimin e një aplikacioni për grumbullimin e të dhënave të Censit të Bujqësisë, duke përdorur metodën CAPI (intervistë personale me ndihmën e kompjuterit).

8) Anketa përfaqësuese e familjeve migrante dhe jo-migrante në Shqipëri Financuar nga Banka Botërore

Në Tetor të vitit 2024, në bashkëpunim me Bankën Botërore, nisi anketa mbi Lëvizjet Migratore dhe Karakteristikat Socio-Demografike. Anketa kishte për qëllim mbledhjen e të dhënave të detajuara mbi modelet dhe dinamikën e migracionit, me një fokus të veçantë në mbivlerësimin e zonave me incidencë më të lartë të migracionit ndërkombëtar, të identifikuar, duke përdorur të dhënat nga Censi 2023. Si rezultat, INSTAT realizoi mbledhjen dhe digjitalizimin e të dhënave të anketës dhe siguroi një set të dhënash për Bankën Botërore. Këto rezultate synojnë të ofrojnë një bazë të besueshme të dhënash për të informuar strategjitë dhe programet që adresojnë migracionin dhe ndikimet e tij në Shqipëri.

V. Menaxhimi i Cilësisë

INSTAT-i synon të ofrojë produkte dhe shërbime statistikore në përputhje me nevojat statistikore të informacionit të grupeve të ndryshme të përdoruesve. Përmirësimi i cilësisë së informacionit statistikor kryhet vazhdimisht duke kërkuar kostot më të ulëta të mundshme dhe duke zvogëluar barrën e përgjigjes. Në përputhje me ligjin për statistikën zyrtare, INSTAT-i përdor metoda dhe procese statistikore në linjë me parimet dhe standardet shkencore të njohura ndërkombëtarisht, kryen analiza të vazhdueshme të statistikave me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe siguron që statistikën të jenë sa më të përditësuara. Në kryerjen e detyrave, INSTAT-i ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë nga Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane (*European Statistics Code of Practice*).

Në kuadër të sigurimit të cilësisë statistikore, gjatë vitit 2024, puna është fokusuar në hartimin dhe publikimin e raporteve të cilësisë për përdoruesit, mbështetur në konceptin e cilësisë së Sistemit Statistikor Evropian. Në përputhje me nenin 5 të ligjit për statistikën zyrtare, INSTAT-i ka vijuar me iniciativat si: dokumentimi i proceseve statistikore sipas Modelit për Planifikimin e Fazave të Prodhimit Statistikor (GSBPM) dhe kryerja e auditeve statistikore.

Në përputhje me parimin 9 të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane mbi “Ngarkesën ndaj të intervistuarve”, INSTAT monitoron ngarkesën nëpërmjet dy treguesve bazë që janë: numri i pyetësorëve që ndërmarrjet/familjet duhet të përgjigjen dhe kohëzgjatja e intervistës. INSTAT ka punuar për të ndërtuar një sistem, i cili mundëson vlerësimin e kostove të proceseve dhe aktiviteteve statistikore, i cili është në përputhje

me parimin nr.10 të Kodit të Praktikave Evropiane mbi “Kosto-Efektivitetin”, dhe në përmbushje të rekomandimit nr.19 të *Peer Review 2018* mbi krijimin e një sistemi që mundëson vlerësimin e kostove të proceseve dhe aktiviteteve statistikore për qëllime menaxhimi, duke përfshirë krahasimin e efikasitetit dhe kosto-efektivitetit.

INSTAT-i do të punojë gjatë vitit 2025 për hartimin/përditësimin dhe publikimin e raporteve të cilësisë për përdoruesit, duke u mbështetur në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave. Stafi i INSTAT-it dhe i agjencive statistikore do të trajnohet në lidhje me zbatimin e standardeve sipas GSBPM dhe menaxhimit të cilësisë. Këto trajnime do të shërbejnë për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet statistikore të planifikuara dhe për sigurimin e cilësisë statistikore.

Me qëllim rritjen e besueshmërisë së publikut në statistikat zyrtare, për vitin 2025, parashikohet të vijojë puna për publikimin e raporteve të cilësisë, kryerjen e vetëvlerësimeve dhe auditeve statistikore. Në fund të procesit të vetëvlerësimit apo auditit statistikor do të vlerësohen situatat problematike dhe do të sugjerohet gjetja e rrugëve për përmirësimin e procesit të prodhimit statistikor.

Dokumentimi i proceseve statistikore

Për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet statistikore të planifikuara, INSTAT-i zbaton sistemin e Menaxhimit të Përgjithshëm të Proceseve Statistikore (GSBPM). Ky model përshkruan dhe përcakton tërësinë e proceseve të nevojshme për t’u ndjekur për prodhimin e statistikave zyrtare, duke siguruar një kornizë standarde dhe terminologji të harmonizuar.

INSTAT-i, gjatë vitit 2024, ka vijuar me përdorimin e modelit GSBPM (Versioni 5.1), i cili thekson më shumë rëndësinë e procesit të integritetit të të dhënave statistikore në dispozicion. Gjatë këtij viti ka vijuar procesi i dokumentimit të aktiviteteve sipas GSBPM, duke e çuar në 89 numrin e aktiviteteve të dokumentuara, një rritje me 6 aktivitete krahasuar me një vit më parë, ku deri në fund të vitit 2023 ishin dokumentuar 83 aktivitete statistikore.

Auditi Statistikor

Mbështetur në pikën 3, të nenit 17, të ligjit për Statistikat Zyrtare, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT mund të kryejë auditime statistikore tek prodhuesit e statistikave zyrtare, kur e gjykon të arsyeshme. Auditimi statistikor është rruga konkrete për përmirësimin e cilësisë së një procesi apo aktiviteti statistikor, nëpërmjet të cilit identifikohen pikat e forta dhe përmirësohen pikat e dobëta të komponentëve të tij. Auditimi kryhet nëpërmjet një procesi sistematik, të programuar, të pavarur dhe të dokumentuar, në të cilin bëhet një vlerësim objektiv i hapave të ndjekur gjatë një procesi statistikor. Me synimin kryesor rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së proceseve statistikore, gjatë vitit 2024 është ndjekur plotësimi i pyetësorëve të vetëvlerësimit për 2 aktivitete statistikore: 1. Të Dhënat Administrative të Tregut të Punës; 2. Indeksi i Çmimeve të Kushtimit në Ndërtim për Banesa. Gjithashtu, janë realizuar 2 audite statistikore për aktivitetet si: 1. Tregtia e Jashtme; 2. Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore. Rekomandimet për përmirësime janë përfshirë në Planin Operacional të INSTAT.

Raportet e Cilësisë

INSTAT ka publikuar për përdoruesit Raportet e Cilësisë në nivelin e aktiviteteve statistikore. Në vitin 2024 janë publikuar 57 raporte në faqen elektronike të INSTAT-it, me një rritje prej rreth 1.75 %, krahasuar me vitin 2023, ku numri i raporteve të publikuara ishte 56. Risi në këtë drejtim ishte publikimi për herë të parë i raportit të cilësisë për statistikat e Kërkim-Zhvillimit. Raportet e cilësisë përshkruajnë konceptet dhe metodologjitë statistikore të përdorura për mbledhjen dhe gjenerimin e statistikave zyrtare. Nëpërmjet tyre përdoruesve u sigurohet informacion mbi format dhe standardet që INSTAT përdor në metodat dhe

përkufizimet e aplikuara, si dhe në cilësinë e rezultateve statistikore. Struktura e Raporteve të Cilësisë bazohet në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave (ESS) dhe në parimet lidhur me cilësinë e aktiviteteve statistikore sipas Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.

Ngarkesa e të Intervistuarve

Anketat pranë ndërmarrjeve

Ngarkesa e të intervistuarve është koha dhe përpjekjet e të anketuarve për t'ju përgjigjur pyetësorëve të INSTAT në mënyrë të kënaqshme për një aktivitet statistikor. Në vitin 2024, në 17 vrojtime pranë ndërmarrjeve, janë anketuar rreth 26,614 ndërmarrje, si dhe në 8 vrojtime realizuar pranë familjeve janë intervistuar rreth 53,239 Njësi Ekonomike Familjare (NJEF).

Statistikat pranë ndërmarrjeve dhe statistikat pranë familjeve përdorin dy tregues për të vlerësuar ngarkesën e të intervistuarve (*Response burden*): 1. Numrin e pyetësorëve që ndërmarrjet/familjet duhet të përgjigjen; 2. Kohëzgjatjen e intervistës.

Të gjitha anketat pranë ndërmarrjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2024 kanë si bazën e tyre të zgjedhjes Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve. Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes për vitin 2024, duke marrë në konsideratë gjithë vrojtimit pranë ndërmarrjeve ekonomike, që INSTAT realizon, jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes

Grup_Size	0 pyetësorë	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11 + pyetësorë	Total
1-9 të punësuar	198,712	15,881	451	2,369	217,413
10-19 të punësuar	415	2,901	781	382	4,479
20_49 të punësuar	495	1,123	822	399	2,839
50 + punësuar	542	196	469	840	2047
Total	200,164	20,101	2,523	3,990	226,778

Në vitin 2024 janë anketuar rreth 11.74 % e ndërmarrjeve nga 226,778 ndërmarrje të regjistruara në vitin 2023, janë intervistuar të paktën një herë gjatë vitit 26,614 ndërmarrje, 75.53 % e tyre kanë marrë pjesë vetëm në pesë ose më pak vrojtime dhe 24.47 % e tyre kanë marrë pjesë në më shumë se 5 vrojtime të realizuar nga INSTAT, pranë ndërmarrjeve, gjatë vitit 2024.

Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve nga 2020-2024, duke marrë në konsideratë gjithë vrojtimit pranë ndërmarrjeve ekonomike që INSTAT realizon, jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve 2020-2024

	2020	%	2021	%	2022	%	2023	%	2024	%
0 pyetësorë	139,289	85.80	143,377	86.20	155,589	85.70	184,567	88.03	200,164	88.26
Të paktën 1 pyetësor	23,053	14.20	23,009	13.82	25,960	14.30	25,103	11.97	26,614	11.74

Në lidhje me “Ngarkesën e të intervistuarve”, për indikatorin “Numri i pyetësorëve që INSTAT i dërgon ndërmarrjeve për t’u përgjigjur” nuk mund të krahasohet në seri me vitet e mëparshme, pasi ndryshon numri i aktiviteteve dhe frekuenca e tyre. Gjatë vitit 2024 INSTAT ka realizuar 17 vrojtme pranë ndërmarrjeve dhe numri i ndërmarrjeve që kanë marrë të paktën një anketë rezulton të jetë afërsisht i njëjtë në pikë përqindje. Diferenca në rritje e numrit të ndërmarrjeve vjen si rezultat i rritjes së numrit të ndërmarrjeve në regjistrë.

Tabela 4: Shpërndarje e ngarkesës në përqindje për çdo grup-madhësi të ndërmarrjes

Grup_Size	0 pyetësorë	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11 + pyetësorë	Total
1 -9 të punësuar	91.40%	7.30%	0.21%	1.09%	100%
10- 19 të punësuar	9.27%	64.77%	17.44%	8.53%	100%
20 49 të punësuar	17.44%	39.56%	28.95%	14.05%	100%
50 + punësuar	26.48%	9.57%	22.91%	41.04%	100%
Total	88.26%	8.86%	1.11%	1.76%	100%

Në grupin e ndërmarrjeve të vogla (1-9 të punësuar), ku është i përqendruar numri më i madh i ndërmarrjeve të vendit, pjesa më e madhe e tyre, rreth 91.40 %, nuk kanë për të plotësuar asnjë pyetësor, 7.30 % kanë për të plotësuar 1 deri në 5 pyetësorë dhe 1.30 % e tyre ngarkohen me mbi 5 pyetësorë. Siç shikohet nga grafiku, në grupin e ndërmarrjeve me 20 deri 49 të punësuar, 85.95 % e tyre ngarkohen deri në maksimumi 10 pyetësorë për t’u përgjigjur dhe vetëm 14.05 % e tyre ngarkohen me mbi 10 pyetësorë. Ngarkesa e përgjigjes është relativisht e lartë në grupin e ndërmarrjeve me 50 të punësuar e lart, ku rreth 73.52 % e tyre duhet t’i përgjigjen të paktën 1 pyetësori.

Anketat pranë familjeve

Të gjitha anketat pranë familjeve, të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2024, kanë si bazën e tyre të zgjedhjes rezultatet e Censit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011. Në vitin 2024 janë anketuar rreth 7.37 % Njësi Ekonomike Familjare (NjEF) nga 722,262 të regjistruara në Cens. Janë intervistuar gjithsej 53,239 NJEF, nga të cilat 74.59 % (39,709) e tyre kanë marrë pjesë vetëm në një vrojtim, ndërsa 25.41 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 ose më shumë vrojtme të realizuar nga INSTAT, pranë familjeve, gjatë vitit 2024. Shpërndarja e numrit të vrojtmeve sipas qarqeve për vitin 2024, duke marrë në konsideratë të gjitha vrojtmet pranë familjeve që realizon INSTAT, jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5: Shërndarja e numrit të vrojtimeve sipas qarkut, për vitin 2024

Kodi_Qark	Emër_Qarku	0 pyetësorë	1 pyetësor	2+ pyetësorë	Total Familje
01	BERAT	35,645	2,144	704	38,493
02	DIBËR	27,252	1,683	638	29,573
03	DURRËS	61,528	3,821	1,301	66,650
04	ELBASAN	67,536	4,073	1,435	73,044
05	FIER	75,672	4,881	1,521	82,074
06	GJIROKASTËR	19,479	1,278	530	21,287
07	KORÇË	55,702	3,304	1,165	60,171
08	KUKËS	15,566	1,097	463	17,126
09	LEZHË	29,694	1,771	771	32,236
10	SHKODËR	50,118	3,141	1,170	54,429
11	TIRANË	18,3576	9,830	2,812	196,218
12	VLORË	47,255	2,686	1,020	50,961
	Total	669,023	39,709	13,530	722,262

Gjatë vitit 2024 në qarkun e Tiranës janë intervistuar gjithsej 12,642 NJEF ose 6.44 përqind e tyre. Rreth 93.56 % e familjeve të qarkut Tiranë nuk kanë marrë pjesë në ndonjë vrojtim, 5.01 % e tyre kanë marrë pjesë në 1 vrojtim dhe vetëm 1.43 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 ose më shumë vrojtime të realizuara nga INSTAT.

Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve nga 2024-2016, duke marrë në konsideratë gjithë vrojtimit pranë njësisë ekonomike familjare, që INSTAT realizon, jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 6: Shërndarja e numrit të pyetësorëve për vrojtimit pranë NJEF, 2016-2024

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Të paktën 1 herë	40,804	46,940	59,702	81,870	51,302	54,489	51,295	51,133	53,239
0 pyetësorë	68,1458	675,322	662,560	640,392	670,960	667,773	670,967	67,1129	669,023
Total	722,262	722,262	722262	722262	722262	722262	722262	722262	722262

Indikatori “Numri i pyetësorëve që INSTAT i dërgon familjeve për t’u përgjigjur” nuk mund të krahasohet në seri të gjatë kohore pasi ndryshon numri i aktiviteteve dhe frekuenca e tyre.

Gjatë vitit 2024 në krahasim me vitin 2023, INSTAT ka realizuar aktivitete të reja statistikore pranë familjeve, si psh Anketa e Vlerësimit të Bankës Qendrore. Numri i familjeve që kanë marrë të paktën një pyetësor gjatë vitit 2024 ka një rritje të papërfillshme, krahasuar me vitin 2023.

Tabela 7: Shërndarja e numrit të vrojtimeve sipas qarkut, për vitin 2024


Kodi_Qark	Emër_Qarku	0 pyetësorë	1 pyetësor	2+ pyetësorë	Total Familje
01	BERAT	92.60%	5.57%	1.83%	38,493
02	DIBËR	92.15%	5.69%	2.16%	29,573
03	DURRËS	92.32%	5.73%	1.95%	66,650
04	ELBASAN	92.46%	5.58%	1.96%	73,044
05	FIER	92.20%	5.95%	1.85%	82,074
06	GJIROKASTËR	91.51%	6.00%	2.49%	21,287
07	KORÇË	92.57%	5.49%	1.94%	60,171
08	KUKËS	90.89%	6.41%	2.70%	17,126
09	LEZHË	92.11%	5.49%	2.39%	32,236
10	SHKODËR	92.08%	5.77%	2.15%	54,429
11	TIRANË	93.56%	5.01%	1.43%	196,218
12	VLORE	92.73%	5.27%	2.00%	50,961
	Total	92.63%	5.50%	1.87%	722,262

Anketat e kryera pranë familjeve në Shqipëri kanë si karakteristikë faktin që mbledhin informacion mbi karakteristikat të familjeve dhe individëve, që nuk gjenden në regjistra apo rekorde administrativë. Si rrjedhim, përpjekjet për të ulur shkallën e ngarkesës janë fokusuar në lehtësitë që mund t'i krijohen familjeve, përsa i përket kuptueshmërisë dhe rëndësisë së informacionit, aplikimit të formave elektronike që shkurtojnë kohën dhe automatizojnë administrimin e intervistimit, si dhe përpjekjeve për të regjistruar dhe para-printuar atë pjesë të informacionit, që mund të jetë i disponueshëm.

Kohëzgjatja mesatare e intervistës në minuta

Në lidhje me indikatorin e dytë, kohëzgjatja mesatare e intervistës për anketat pranë familjeve dhe ndërmarrjeve për vitin 2024, të dhënat jepen në figurën e mëposhtme.

Figura 1: Kohëzgjatja mesatare e intervistës në minuta



Kohëzgjatja e intervistës, gjatë vitit 2024, për anketat pranë familjeve është mesatarisht rreth 32.8 minuta, një ulje e lehtë krahasuar me vitin 2023, ku kjo vlerë ishte 33.9 minuta.

Ndërsa për intervistat pranë ndërmarrjeve kohëzgjatja e intervistës, për vitin 2024 është 29.0 minuta, një ulje e lehtë krahasuar me vitin 2023, ku kohëzgjatja ishte 29.1 minuta.

INSTAT, për të reduktuar ngarkesën e të intervistuarve, punon vazhdimisht për të përmirësuar cilësinë e pyetësorëve, programeve të mbledhjes së të dhënave, manualeve dhe për trajnimin e anketueseve.

Planet e vazhdimësisë së Aktiviteteve Statistikore

INSTAT-i përqëndrohet maksimalisht për të siguruar vazhdimësinë dhe cilësinë e produkteve statistikore ku deri më tani janë hartuar dhe aprovuar planet e vazhdimësisë për 73 aktivitete statistikore.

Sistemi online për aksesimin nga jashtë të të dhënave mikro (SIMONA)

Sistemi “SIMONA” është vënë në dispozicion të kërkuesve shkencorë që prej vitit 2020 dhe mundëson aksesimin e informacionit statistikor në distancë. Ky sistem mundëson aksesin e të dhënave mikro në interes të proceseve kërkimore-shkencore nga të gjithë përdoruesit brenda dhe jashtë vendit, si edhe të stafit të INSTAT. Në INSTAT, gjatë vitit 2024, janë depozituar kërkesa për akses në të dhëna mikro, nga të cilët 5 përdorues kanë pasur akses për 3 projekte të reja. Ky akses sigurohet përmes Dhomës së Sigurtë në hapësirat e INSTAT dhe sistemit të aksesit në distancë SIMONA.

Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve të Statistikave

Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve mbi statistikën që prodhon INSTAT-i është një mjet i rëndësishëm për të identifikuar nevojat e përdoruesve dhe adresuar reagimet e tyre, aty ku është e mundur, në procesin e planifikimit të statistikave zyrtare. Anketa është realizuar mbi të dhënat e përdoruesve që kanë kërkuar statistika pranë INSTAT, duke u kombinuar edhe me pyetësin online. Kampioni përbëhej nga përdoruesit që kanë kërkuar të dhëna statistikore në INSTAT nëpërmjet kanaleve zyrtare të komunikimit dhe nëpërmjet vendosjes së një linku për plotësim në web-in e INSTAT.


INSTAT-i zhvilloi raundin e tetë të Anketës së Kënaqësisë së Përdoruesve në Dhjetor të vitit 2024. Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë së përdoruesve në vitin 2024 arriti vlerën 4.03 pikë nga 5 pikë të plota, duke shënuar një rritje me 0.01 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, ku kjo vlerë ishte 4.02 pikë. Rritje kanë pësuar gjithashtu dhe treguesit si: Kënaqësia me cilësinë e të dhënave dhe shërbimet, Kënaqësia me të dhënat, Kënaqësia me punonjësit e INSTAT, Besimi në të dhënat e INSTAT. Treguesi mbi kënaqësinë me faqen e internetit ka pësuar një ulje me 0.45 pike krahasuar me një vit më parë. Në tabelën më poshtë paraqiten vlerat e këtyre treguesve për vitet 2022-2023.

Tabela 8: Treguesit kryesorë të Anketës së Matjes së Kënaqësisë së Përdoruesve

Treguesi	2023	2024	Trendi
Kënaqësia me cilësinë e të dhënave dhe shërbimet	4.18	4.20	↑
Kënaqësia me të dhënat	3.89	4.03	↑
Kënaqësia me punonjësit e INSTAT	4.01	4.19	↑
Kënaqësia me faqen e internetit	3.97	3.52	↓
Besimi - INSTAT ka të dhëna të besueshme	4.04	4.19	↑

Grafiku i mëposhtëm paraqet progresin e nivelit të kënaqësisë së përdoruesve përgjatë 5 viteve të fundit 2020-2024.

Figura 2: Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë së përdoruesve sipas viteve 2020-2024



Metodologjia e Vrojtimeve

Metodologjia e vrojtimeve përfshin disa procese kryesore, si përzgjedhjen e kampionit, përgjithësimin e rezultateve statistikore dhe vlerësimin e gabimeve për treguesit kryesorë. Këto procese janë thelbësore për të siguruar që të dhënat e grumbulluara janë të sakta dhe për të minimizuar gabimet.

Në kuadër të vazhimit të përmirësimeve metodologjike për të plotësuar rregulloret e BE për çdo tregues që llogaritet, INSTAT, edhe gjatë vitit 2024, ka vijuar të përmirësojë proceset, si të kampionimeve me eficiente ashtu dhe të përpunimit të të dhënave. Të dhënat administrative po përdoren gjithnjë e më shumë për rritjen e krahasueshmërisë dhe integritetit të treguesve. Në anketën e PRODCOM ka patur përmirësim në mbulimin e saj në nivel më të detajuar. Në anketën e Forcave të Punës është punuar mbi rishikimin e serisë kohore të të dhënave në përputhje me të dhënat e rishikuara bazuar në rezultatet e Censit 2023.

Gjithashtu, për kampionimet pranë familjeve pritet një përmirësim në vazhdim për faktin që kemi tashmë Bazën e Vrojtimeve CENS 2023.

VI. Teknologjia e Informacionit

INSTAT në vitin 2024 u përball me një sulm kibernetik, që preku përkohësisht disa sisteme kritike të informacionit. Menjëherë pas identifikimit të incidentit, u aktivizua plani i rimëkëmbjes nga katastrofat (Disaster Recovery Plan), duke mundësuar izolimin e shpejtë të kërcënimit dhe rivendosjen graduale të funksionaliteteve të prekura. U zbatuan masa të menjëhershme sigurie, duke përfshirë monitorimin e zgjeruar të trafikut të rrjetit, forcimin e protokolleve të autentifikimit dhe rritjen e mbikëqyrjes mbi aksesin në sistemet e brendshme. Një auditim i detajuar i ngjarjes u krye në bashkëpunim me ekspertë të sigurisë kibernetike për të analizuar vektorin e sulmit dhe për të adresuar dobësitë e identifikuara. Për më tepër, u forcua enkriptimi i të dhënave dhe mekanizmat e kopjeve rezervë për të siguruar rikuperimin e shpejtë të informacionit në rast emergjencash.

Gjatë vitit 2024, INSTAT ndërmori disa investime strategjike për të rritur mbrojtjen kibernetike dhe për të forcuar infrastrukturën e sigurisë. Një nga arritjet kryesore ishte implementimi i sistemit *Security Information and Event Management (SIEM)*, i cili mundëson mbledhjen dhe analizimin në kohë reale të log-eve të sigurisë, duke përmirësuar ndjeshëm aftësinë për të zbuluar dhe reaguar ndaj incidenteve kibernetike. Po ashtu, u forcua siguria e serverave dhe përdoruesve fundorë, përmes implementimit të antivirusëve të gjeneratës së fundit, të cilët mundësojnë mbrojtje të avancuar ndaj sulmeve të sofistikuara. Një tjetër hap i rëndësishëm ishte migrimi i shërbimit të postës elektronike, duke rritur sigurinë dhe qëndrueshmërinë e komunikimeve të brendshme dhe duke përmirësuar mbrojtjen ndaj sulmeve të tipit *phishing* dhe *malware*.

Në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të sigurisë kibernetike, INSTAT ka planifikuar investime për të garantuar mbrojtje më të lartë ndaj kërcënimeve të mundshme në të ardhmen. Po ashtu, do të investohet në rekrutimin e specialistëve të rinj në fushën e sigurisë kibernetike dhe zhvillimin e programeve të trajnimit të vazhdueshëm për stafin ekzistues. Me këto masa, INSTAT synon të krijojë një infrastrukturë më të fortë dhe më të sigurt lidhur me mbrojtjen e të dhënave dhe funksionimin e pandërprerë të sistemeve të tij në të ardhmen.

Mirëmbajtja e sistemeve/aplikacioneve për mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave në terren, si edhe për llogaritjen e statistikave zyrtare, ka vijuar edhe gjatë vitit 2024. U zhvillua 1 aplikacion CATI, 3 aplikacione të reja CAWI dhe 1 aplikacion CAPI për të mundësuar kalimin e një vrojtimi nga mbledhja me letër (PAPI) në mbledhjen me tablet. Aplikacionet janë të ndërtuara në platforma të ndryshme si: *Net*, *CSPRO*, *LimeSurvey*; me baza të dhënash në *SQL Server*.

Janë menaxhuar bazat e të dhënave dhe databaza statistikore PX-web. Janë arkivuar të dhënat fillestare dhe ato të përpunuara.

Në kuadër të bashkëpunimit me Eurostat, gjatë kësaj periudhe është përdorur platforma *Edamis 4* për të transmetuar të dhënat. Metadat transmetohen përmes platformës *Metadata Handler*, duke u fokusuar në rritjen e cilësisë dhe sasisë së metadatave të dërguara përmes kësaj platforme. INSTAT ka vijuar punën për harmonizimin e listave të kodeve në bazën e të dhënave statistikore, bazuar në listat e kodeve të Eurostat (RAMON), të cilat janë të përshtatur me listat e kodeve kombëtare.

VII. Komunikimi dhe Publikimet

INSTAT-i ka ndërtuar një strategji të veçantë drejtuar të gjithë grupeve të përdoruesve, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në rëndësinë e statistikave zyrtare.

Ecuria e vlerave të treguesve matës të vizibilitetit gjatë vitit 2024 është si vijon:

- **Publikimet:** Numri i publikimeve të INSTAT arriti në 175, me një rritje me 4 publikime, krahasuar me vitin 2023, ku u realizuan 171 publikime.
- **Kërkesat e përdoruesve:** Sa i takon kërkesave, duke iu referuar databazës së kërkesave të përdoruesve, e cila është krijuar për herë të parë në vitin 2009, numri i kërkesave për të dhëna statistikore në vitin 2024 është 563, ku 7 prej tyre kanë qenë kërkesa për mikrodata.
- **Edukimi statistikor:** Në vitin 2024, INSTAT riorganizoi seksionin *Këndi i Edukimit Statistikor*, në të cilin janë përmbledhur produkte statistikore të nevojshme për edukim statistikor të përdoruesve. Projekti “Statistika në shkollë” është krijuar për t’i ardhur në ndihmë të gjithë nxënësve, studentëve dhe atyre që kanë interes për statistikën, për të qenë në gjendje të kuptojnë më mirë statistikën dhe disa nga konceptet themelore të saj. Gjatë vitit 2024, janë përditësuar me infografikë temat e publikuara në seksionin e Edukimit Statistikor. Këtij aktiviteti i shtohet dhe bashkëpunimi i ngushtë me hartuesit e politikave, si përdoruesit kryesorë të statistikave zyrtare. Revista “Kërkimi” dhe “INFOSTAT”, janë vlerë tjetër e shtuar, me pasurimin e dijeve jo vetëm me analiza jo vetëm të karakterit shkencor, por edhe të karakterit informativ mbi prodhimin e statistikave zyrtare.
- **Rrjeti social facebook:** Pëlqimet në faqen e Institutit të Statistikave në facebook gjatë vitit 2024 arritën në 8,275, një rritje e lehtë, krahasuar me vitin 2023, ku numri i pëlqimeve ishte 8,150. Ndërkohë, shikueshmëria në vitin 2024 ishte 59,000 shikime, duke shënuar një ulje të ndjeshme, krahasuar me vitin 2023, ku numri i shikimeve ishte 496,312. Kjo rënie i dedikohet rritjes së klikimeve gjatë vitit 2023, për shkak të Censit të Popullsisë dhe Banesave dhe vizibilitetit të këtij aktiviteti madhor.


➤ **Vizibiliteti në media:** INSTAT, gjatë vitit 2024, ka publikuar 3 reagime/njoftime për mediat në Seksionin e Reagimeve në faqen zyrtare INSTAT, të cilat kanë qenë komunikime me mediat dhe publikun në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave. Sa i takon vizibilitetit në media, gjatë vitit 2024, përmendja dhe citimi i INSTAT dhe Drejtorit të Përgjithshëm në artikuj dhe kronika të lidhura me aktivitetin e INSTAT është si më poshtë:

- 2.870 herë në përmbajtjen e 1,477 artikujve të botuar në shtypin shqiptar;
- 37 herë në faqet e para të gazetave dhe revistave të përditshme;
- 1,320 herë në përmbajtjen e 1,162 kronikave, në lajmet kryesore të televizioneve më të ndjekura në Shqipëri;
- 17,625 herë në përmbajtjen e 8,586 artikujve të publikuara në portalet online.

Publikimet

Gjatë vitit 2024 janë realizuar 175 publikime dhe janë përgatitur vizualisht 7 publikime libër, në të cilët janë paraqitur treguesit kryesorë që INSTAT publikon.

Figura 3: Numri i publikimeve përgjatë viteve 2018-2024



Librat

“Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri 2023”

Nëpërmjet këtij publikimi paraqiten rezultatet përfundimtare mbi numërimin dhe karakteristikat e popullsisë banuese dhe banesave në Shqipëri. Mesnata e 17-18 Shtatorit 2023 shënoi momentin e fotografimit të popullsisë banuese në Shqipëri. Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023 është censi i tretë i kryer në Shqipëri, që nga viti 1990, dhe i dymbëdhjeti në historinë e censeve në vend, prej vitit 1913. Censi është aktiviteti statistikor më madhor, kompleks, i kryer nga Instituti i Statistikave, në periudha dhjetëvjeçare. Censet historikisht kanë siguruar të dhëna të vlefshme për të informuar politikbërësit, për të hartuar strategji kombëtare për zhvillim dhe për të kuptuar nevojat në ndryshim të popullsisë sonë. Kohët e fundit ky aktivitet ofron informacion thelbësor për matjen e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm.

“Regjistrat e biznesit 2023”

Statistikat zyrtare bazuar në regjistrat e biznesit i shërbejnë gjithë komunitetit të biznesit, politikë-bërësve, dhe akademikëve, për të analizuar situatën ekonomike në vend. Gjithashtu, këto statistika shërbejnë për të ndërmarrë iniciativa dhe vendime të drejta, për të përmirësuar klimën dhe zhvillimin e bizneseve.

“Tregtia e jashtme e mallrave dhe ndërmarrjet 2023”

Botimi pasqyron disa nga kërkesat themelore dhe nevojat e disa grupeve të përdoruesve për të dhënat mbi tregtinë e mallrave dhe ndikimin e tyre në ekonominë shqiptare. Ky publikim i dedikuar paraqet me anë të shifrave realitetin ekonomik në vend, përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencorë dhe akademikëve në Shqipëri.

“Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta 2022”

Statistikat në lidhje me ndërmarrjet private të huaja dhe të përbashkëta (shqiptare dhe të huaja) synojnë të tregojnë strukturën, masin treguesit ekonomikë, format e organizimit, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. INSTAT, nëpërmjet këtij publikimi, plotëson disa prej kërkesave gjithnjë e në rritje për informacion statistikor të përdoruesve.

“Transporti në shifra 2023”

Transporti është një sektor i rëndësishëm i ekonomisë dhe luan një rol jetik në shoqërinë e sotme të lëvizshme. Ky publikim i dedikuar paraqet me anë të shifrave situatën reale në vend, si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencorë dhe akademikëve në Shqipëri. Përgatitja e këtij materiali është mundësuar nga burime administrative të treguesve statistikorë lidhur me transportin hekurudhor, rrugor, detar dhe ajror, lidhur me sasinë e mallrave dhe numrin e pasagjerëve që lëvizin çdo vit, mjetet e përdorura, si dhe treguesit e sigurisë në transport.

“Tregu i Punës 2023”

Botimi mbi Tregun e Punës është një burim i rëndësishëm informacioni mbi situatën dhe tendencat e tregjeve kombëtare të punës. Ky informacion ndihmon për të monitoruar politikat dhe strategjitë kryesore për punësimin dhe pagat, strukturën gjinore dhe moshore, shkallën arsimore, aktivitetin ekonomik dhe profesionet. Botimi i dedikuar mbi Tregun e Punës përmban një analizë të zgjeruar të publikimeve tremujore bazuar në burime administrative dhe Anketën e Forcave të Punës.

“Statistikat mbi Sigurinë Rrugore 2023”

INSTAT publikon për herë të parë një botim të veçantë mbi treguesit kryesorë të sigurisë rrugore. Analiza e statistikave të aksidenteve dhe ecuria përkatëse e tyre mbeten një nga elementet kryesorë në sigurinë e shoqërisë së sotme. Përgatitja e këtij botimi është e mundësuar nga burime administrative që përmbajnë të dhëna mbi aksidentet rrugore. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni, i cili i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.




Kërkesat e përdoruesve

INSTAT regjistron çdo kërkesë të përdoruesve për informacion statistikor në databazën e përdoruesve dhe nëpërmjet saj INSTAT përcakton dhe njihet më mirë me kërkesat dhe nevojat që kanë përdoruesit për statistika. Nëse i referohemi historikut të kësaj databaze, që nga krijimi në vitin 2009, mund të themi që kërkesat e përdoruesve kanë pësuar rritje ndër vite. Nga viti 2020 deri në vitin 2024, kërkesat kanë qenë më konstante. Në vitin 2024 numri i kërkesave të përdoruesve është 563, ku 7 prej tyre janë kërkesa për të dhëna mikro.

Figura 4: Numri i kërkesave të përdoruesve 2020 – 2024

Duke e thelluar analizën e statistikave lidhur me plotësimin e kërkesave të përdoruesve, vërehet që numri i kërkesave të përdoruesve në vitin 2024 ka pësuar rënie me 444 kërkesa. Në vlerësimin e numrit të kërkesave, ka ndikuar kryesisht pasurimi i databazës statistikore me tregues të rinj, ndërtimi i platformave me të dhëna dhe grafikë dinamikë, gjë që i ndihmon përdoruesit t'i gjenerojnë tabelat sipas nevojës së tyre, pa patur nevojën e dërgimit të kërkesës pranë INSTAT. Vizualizimi i statistikave rrit ndjeshëm përdorimin e drejtëpërdrejtë të të dhënave të shfaqura në faqen zyrtare të INSTAT.



Nëse do të bënim specifikimin e mëtejshëm të këtyre kërkesave, mund të themi se numrin më të madh të kërkesave të plotësuar në vitin 2024 e zënë statistikat e çmimeve - 253 kërkesa, pasuar nga statistikat për popullsinë - 71 kërkesa, statistikat e tregtisë së jashtme - 32 kërkesa, si dhe statistikat e turizmit, transportit dhe aksidenteve - 56 kërkesa, etj. Një pasqyrë e hollësishme e numrit të kërkesave sipas temave statistikore paraqitet në figurën dhe tabelën e mëposhtme:

Figura 5: Klasifikimi i numrit të kërkesave të përdoruesve sipas temave specifike statistikore




Tabela 9: Numri i kërkesave të përdoruesve sipas temave specifike statistikore

Lënda e Kërkesës	Numri i kërkesave 2023	Numri i kërkesave 2024
Çmimet	365	253
Bujqësia dhe blegtoria / mjedisi	14	14
Tregtia e jashtme	50	32
Anketa e strukturës së ndërmarrjeve	8	13
Regjistri statistikor i ndërmarrjeve	30	20
Llogaritë kombëtare	21	12
Popullsia/lindjet-vdekjet/martësat/divorcet/emigracioni	201	71
Ndërtimi	5	5
Shkaqet e vdekjeve /shëndetësia/ krimet	32	16
Punësimi/papunësia/pagat	79	26
Turizmi/transporti/aksidentet	99	60
Konsumi i familjeve / niveli i jetesës / shpenzimet e	40	28
Të tjera/ të ndryshme/ Të dhëna të 2 ose më shumë fushave statistikore / Pyetësorë të ndryshëm	49	6
Mikrodata	14	7
Totali	1.007	563

Edukimi statistikor

Projekti “Statistika në shkollë” është krijuar për t’i ardhur në ndihmë të gjithë nxënësve, studentëve, si dhe atyre që kanë interes për statistikat, për të qenë në gjendje të kuptojnë më mirë statistikat dhe disa nga konceptet themelore të saj. Gjatë vitit 2024, janë përditësuar temat e publikuara në seksionin e Edukimit Statistikor me infografikë dhe janë shtuar tema të reja, si p.sh Indeksi i Pabarazisë Gjimore.

Edukimi statistikor është njohja e publikut të gjerë me informacione dhe njohuri statistikore, të cilat nevojiten për të kuptuar apo për të qenë në gjendje për të gjykuar nëse një njoftim, një shifër, një çmim apo një reklamë është e arsyeshme apo jo.

Qëllimi i edukimit statistikor është forcimi i sistemit statistikor dhe statistikave zyrtare përmes literaturës statistikore për përdoruesit e rinj dhe jo-ekspertë të statistikave. Nëpërmjet edukimit statistikor synohet ndërgjegjësimi i të rinjve për rëndësinë e statistikave zyrtare dhe përdorimin e tyre. Në kuadër të këtij projekti, INSTAT ka përgatitur dhe publikuar disa artikuj statistikorë, të trajtuar në mënyrë të tillë që të nxisin interes për të rinjtë dhe personat e interesuar që të mësojnë rreth statistikave.

Temat janë si më poshtë:

- Popullsia e Shqipërisë
- Shpenzimet e konsumit në Shqipëri
- Piramida e popullsisë
- Çmimet e konsumit në Shqipëri
- Arsimi në Shqipëri
- Prodhimi i Brendshëm Bruto

- Regjistri i ndërmarrjeve në Shqipëri
- Statistikat e tregut të punës
- Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës
- Indeksi i Pabarazisë Gjimore

Rrjeti Social Facebook dhe Instagram

Pëlqimet në faqen e Institutit të Statistikave në Facebook gjatë vitit 2024 arritën në 8,275, një rritje e lehtë, krahasuar me vitin 2023, ku numri i pëlqimeve ishte 8,150. Nërkohë, shikueshmëria në vitin 2024 ishte 59,000 shikime, duke shënuar një ulje të ndjeshme, krahasuar me vitin 2023, ku numri i shikimeve ishte 496,312. Kjo rënie i dedikohet rritjes së klikimeve gjatë vitit 2023, për shkak të Censit të Popullsisë dhe Banesave dhe vizibilitetit të këtij aktiviteti madhor.

Shikueshmëria në Facebook, 2024

- Nga 59,000 shikimet total, rezulton se 42,000 shikime kanë qenë nga jo-ndjekës të faqës zyrtare të INSTAT në Facebook.


Figura 6: Shikueshmëria në Facebook, 2024



- Gjithashtu, kuptojmë se orari në të cilin vizitohet më shumë faqja e Facebook është ora 9 e mëngjesit.

Figura 7: Orari kur faqja vizitohet më shumë


The majority of your followers are active on Facebook around 9am PST.



Shikueshmëria në Instagram, 2024

- Ndjekësit në faqen e Institutit të Statistikave në Instagram gjatë vitit 2024 arritën në 3,638. Shikueshmëria në Instagram gjatë vitit 2024 ishte 74,000 shikime. Postimi më i ndjekur në Instagram ka qenë postimi dedikuar aktivitetit për “100-vjetorin e Statistikave Zyrtare”.

Figura 8: Postimi më i ndjekur në vitin 2024




Statistikat e Website të INSTAT³

³ Shënim: Të dhënat për vitin 2024 janë imputuar duke përdorur mesataren e viteve 2018-2023.

Në vitin 2024, vërehet një rënie e ndjeshme në numrin gjithsej të klikimeve nga 3,020,981 në vitin 2023 në 1,190,082 në vitin 2024. Kjo rënie i dedikohet dy faktorëve:

- Rritjes së ndjeshme të vizibilitetit dhe aktiviteteve që lidhen me vitin e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 dhe fushatës promovionale.
- Sulmit kibernetik në fillim të vitin 2024, ku faqja e INSTAT nuk ka funksionuar për një periudhë ose me orare te kufizuara.

Figura 9: Numri i klikimeve në faqen web të INSTAT



Programi i transparencës

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur Programi i Transparencës për Institutin e Statistikave. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit. Programi vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës INSTAT-i ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale.

INSTAT-i përditëson herë pas here Programin e Transparencës. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparente veprimtarinë e punës së INSTAT-it, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.instat.gov.al, si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i Transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e publikimit, si dhe në strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të Programit të Transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Faqja zyrtare elektronike e INSTAT-it është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë, në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes pasqyrohen edhe informacione që

karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

Parime të Përgjithshme

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi i Transparencës së INSTAT-it janë:

- “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
- Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: INSTAT-i ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e INSTAT-it dhe përkatësisht Ligji nr. 17/2018 "Për statistikën zyrtare" dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore për zbatimin e tij.
- Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme.
- Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Rishikimi i Programit të Transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë përmes së cilës është bërë miratimi i tij.

-Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:

- i plotë;
- i saktë;
- i përditësuar;
- i thjeshtë në konsultim;
- i kuptueshëm;
- lehtësisht i aksesueshëm;
- i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

VIII. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

INSTAT vazhdon t'i kushtojë një rëndësi të veçantë zbatimit të Agjendës 2030 për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, pasi statistikën janë instrumenti i zgjedhur për të vendosur bazën për monitorimin e zbatimit të këtyre qëllimeve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Politikën dhe strategjitë që duhet të zhvillohen për arritjen e 17 objektivave dhe 169 targeteve duhet të mbështeten nga treguesit statistikorë për të siguruar një vendimmarrje të bazuar në evidenca.

Aktualisht INSTAT prodhon 66 indikatorë statistikorë, të cilët përditësohen në platformën për OZHQ-të, në faqen zyrtare të INSTAT , <https://www.instat.gov.al/al/sdg/>.


INSTAT filloi zbatimin e një projekti statistikor për OZHQ-në, gjatë vitit 2024,, në kuadër të Programit Shumëpërfitues IPA 2022, i cili do të ketë në fokus rritjen e indikatorëve të OZHQ-ve, përmirësimin e dashbordit për OZHQ-të, paraqitjen në mënyrë sa më të kuptueshme dhe pranë përdoruesit të indikatorëve, si dhe komunikimin e tyre. Grupi i punës i ngritur brenda INSTAT, po punon për identifikimin e indikatorëve që mund të prodhohen në vitin në vijim.

IX. Organigrama dhe baza ligjore

Struktura e Institutit të Statistikave

Gjendja faktike në INSTAT në fund të vitit 2024 ishte 230 punonjës dhe 6 pozicione vakante, nga 236 pozicione të organikës, nga të cilët 224 punonjës në shërbimin civil, 12 punonjës administrativë. Në figurën e mëposhtme paraqitet organigrama në fuqi e INSTAT.

Figura 10: Organigrama e Institutit të Statistikave



Kuadri Rregulator për fushën e prodhimit të statistikave zyrtare

Veprimtaria e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe INSTAT-it, si pjesë kryesore përbërëse e tij, ushtrohet në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Programin e Statistikave Zyrtare për periudhën 2022-2026, miratuar me ligjin Nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”. Sistemi Kombëtar Statistikor mbështetet edhe në normat ligjore, të cilat rregullojnë veprimtarinë sektoriale të prodhuesve të tjerë të statistikave zyrtare, çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale, etj.

Në kuadrin rregulator të Sistemit përfshihen edhe konventat e marrëveshjet e tjera me institucionet ndërkombëtare në interes të zhvillimit statistikor në vend, si dhe aktet komunitare të BE-së në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Institucionet prodhuese të statistikave zyrtare në vend synojnë të përarrfrojë standardet statistikore të përcaktuara veçanërisht në Rregulloren (KE) nr. 223/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 11 Mars, 2009, “Mbi statistikat evropiane”, ndryshuar me rregulloren (KE) të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 Prill, 2015.

Instrumente të tjerë rregullatorë të veprimtarisë statistikore të SKS janë edhe marrëveshjet e mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit, të nënshkruara nga INSTAT me institucionet që furnizojnë prodhuesit me të dhëna administrative, si edhe institucionet që mbështesin kryerjen e aktiviteteve.

Vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e klasifikimeve statistikore janë gjithashtu pjesë e kornizës ligjore që siguron harmonizimin e emërtimeve dhe kodifikimeve të produkteve, mallrave e shërbimeve nga të gjitha institucionet publike, dhe për rrjedhojë, edhe harmonizimin e definicioneve të tyre nga pikëpamja statistikore, në përputhje me klasifikimet statistikore ndërkombëtare.

a) Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij

Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në zbatim të rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë, në lidhje me forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe rritjen e pavarësisë profesionale të prodhuesve të statistikave zyrtare. Miratimi i ligjit u cilësua nga partnerët ndërkombëtarë si hapi më i rëndësishëm në fushën e prodhimit statistikor për të garantuar cilësinë statistikore dhe përmbushjen e kërkesave të përdoruesve për këto produkte. Me pozicionimin e INSTAT-it si institucion publik i pavarur, i cili raporton drejtpërdrejt në Kuvend, është mundësuar rritja e besueshmërisë së publikut në vlefshmërinë e statistikave të prodhuara, si dhe bashkëpunimi profesional ndërmjet aktorëve të tjerë të Sistemit Kombëtar Statistikor.

Në zbatim të ligjit për statistikat zyrtare, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë miratuar akte nënligjore, të cilat rregullojnë më tej funksionimin e sistemit statistikor dhe organeve të përfshira në drejtimin e tij:

- i. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 7.11.2018 “Për miratimin e procedurave, të kriterëve të vlerësimit dhe afateve të njoftimit për përzgjedhjen e kandidaturave për t’u emëruar në pozicionin “Drejtör i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave”. Ky akt është hartuar në vijim të frymës së ligjit për të forcuar pavarësinë profesionale të organit drejtues të INSTAT. Ai përcakton në mënyrë të detajuar procedurat që duhen ndjekur për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, duke ndjekur procedurën transparente dhe publike të përzgjedhjes së tij.
- ii. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 7.11.2018 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblyerjes të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”. Vendimi është nxjerrë si pasojë e ndryshimit të natyrës së përfaqësimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave. Sipas kërkesave të ligjit, Këshilli i Statistikave duhet të përbëhet nga përfaqësues të përdoruesve të statistikave zyrtare, si grupi i drejtpërdrejtë i interesuar për produktin statistikor. Në përbërje të tij janë përfshirë anëtarë përfaqësues të

përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare, organet e vetëqeverisjes vendore, medias, botës akademike, shoqërisë civile, Bankës së Shqipërisë, ministrisë përgjegjëse për financën, Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.

- iii. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 07.11.2018 “Për ngritjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën”. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën është organ i cili udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it dhe përbëhet nga përfaqësues të institucioneve, të cilat përpunojnë të dhëna administrative. Ky komision ka për detyrë të kryejë përditësimin, përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve zyrtare ekonomike e sociale, në përputhje me nomenklaturat evropiane dhe ndërkombëtare. Harmonizimi i nomenklaturës finalizohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave sipas propozimit të këtij komisioni.
- iv. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 19.06.2019 “Për llojet e shërbimeve statistikore që ofron Instituti i Statistikave ndaj të tretëve kundrejt tarifave të paracaktuara”. Ky vendim është miratuar në mbështetje të pikës 2 të nenit 36 të ligjit për statistikën zyrtare, në vijim të rritjes së autonomisë së INSTAT-it në menaxhimin e të ardhurave që krijon gjatë shërbimeve statistikore të kryera përtej atyre të parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare dhe Planin Vjetor për zbatimin e tij.
- v. Vendimi i Kuvendit nr. 16/2024, datë 15.02.2021 “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 127/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Statistikave (INSTAT)”.
Për shkak të ligjit të ri për statistikën zyrtare, INSTAT ka ndryshuar statusin nga institucion qendror në varësi të ekzekutivit, në institucion publik të pavarur. Struktura organizative e institucioneve të pavarura rregullohet me ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar.
- vi. Vendimet e Kuvendit nr. 61/2021 datë 01.07.2021 dhe 32/2023, 33/2023, 34/2023, 35/2023 datë 25.05.2023, 22/2024 dhe 23/2024, datë 21.03.2024 për lirin/emërimin/zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave. Referuar ligjit për statistikën zyrtare, anëtarët e Këshillit gëzojnë mandat 5-vjeçar me të drejtë riemërimi jo më shumë se një herë.

Aktualisht janë 4 vende vakante për të cilët ka filluar procesi i përzgjedhjes së kandidaturës në përputhje me kërkesat e vendimit nr. 670, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”.

b) Programi i Statistikave Zyrtare

Programi i Statistikave Zyrtare (PSZ) është dokumenti bazë që parashikon prodhimin nga Sistemi Kombëtar Statistikor të të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, për një hark kohor prej pesë vitesh. Programi është dokumenti kryesor mbi të cilin bazohen veprimtaritë e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare. Ai përcakton institucionet prodhuese të statistikave, njësitë që detyrohen të ofrojnë të dhënat administrative etj, metodologjinë e prodhimit dhe frekuencën e publikimit të tyre.

Programi respekton garancinë e zbatimit të parimeve statistikore të parashikuara në legjislacionin për statistikën zyrtare, në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane⁴ dhe Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara (Fundamental principles).

⁴<http://ec.europa.eu/eurostat/web/quality/european-statistics-code-of-practice>

Programi aktual përfshin periudhën 2022-2026 dhe është miratuar me Ligjin Nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026”.

c) Memorandume Mirëkuptimi


Për të rritur bashkëpunimin ndërinstitucional në interes të përmirësimit të statistikave zyrtare, besueshmërisë së publikut në to dhe për t’iu përshtatur standardeve të reja të përcaktuara nga ligji për statistikën zyrtare, INSTAT ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi me një sërë institucionesh furnizuese me të dhëna administrative.

INSTAT ka nënshkruar gjatë vitit 2024 marrëveshjet si vijon:

1. Pas sulmit kibernetik që iu bë INSTAT në fund të Janarit 2024, INSTAT më 6 Shkurt 2024 nënshkroi marrëveshje bashkëpunimit me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike. Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin në funksion të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike për të mbrojtur informacionin statistikor nga sulmet e mundshme kibernetike.
2. INSTAT, me mbështetjen e Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor, nënshkroi më 22 Maj 2024 një memorandum bashkëpunimi me Bashkitë e vendit. Në zbatim të këtij memorandumi, çdo bashki e vendit do të ketë një zyrë, ku do të mbledhë të dhëna për qëllime statistikore.
3. Me datë 24 Maj 2024 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet INSTAT dhe UN WOMEN. Qëllimi i këtij Memorandumi është të mundësojë një klimë bashkëpunimi dhe të lehtësojë bashkëveprimin midis palëve në fushat e statistikave gjinore. Bashkëpunimi synon të rrisë koordinimin, prodhimin, analizimin dhe shpërndarjen e statistikave gjinore në Shqipëri.
4. Më datë 13 Qershor 2024 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet INSTAT dhe Autoritetit Portual Durrës. Qëllimi i këtij Memorandumi është bashkëpunimi i ndërsjellë ndërinstitucional me qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator dhe operacional mbi mbarëvajtjen e proceseve logjistike dhe shërbimeve publike në fushën e logjistikës detare dhe zinxhirëve të furnizimit, si dhe rritjen e kapaciteteve dhe performancës së personelit përgjegjës për analizën e të dhënave dhe statistikave në institucionet pjesëmarrëse në këtë iniciativë. Bashkëpunimi synon në agregimin e kapaciteteve në mbledhjen, analizën dhe interpretimin e të dhënave, zhvillimin e metodave dhe metodologjive të qëndrueshme për analizën e të dhënave si edhe këshillimi në përdorimin e teknologjive inovative në fushën e logjistikës detare, si dhe zinxhirëve të furnizimit.
5. Më 24 Qershor 2024 INSTAT nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me Agjencinë Kombëtare të Rinisë (AKR), me fokus bashkëpunimi për statistikën mbi rininë. Përmes kësaj marrëveshje synohet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve për shkëmbimin e të dhënave statistikore dhe studimore për rininë. Qëllimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve është përf forcimi, promovimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit të tyre reciprok mbi informacionin statistikor për rininë dhe vënia në dispozicion të kapaciteteve që disponon INSTAT, në organizimin e trajnimeve për rritjen profesionale të stafit të AKR, në fushën e prodhimit statistikor.
6. Në datat 3-5 Korrik 2024 u zhvillua një vizitë studimore në Institutin e Statistikave të Francës, ku u nënshkrua marrëveshja dypalëshe e bashkëpunimit INSTAT - INSEE (Institut i Statistikave të Francës). INSEE mori angazhimin për të suportuar INSTAT-in kryesisht në ndërtimin e platformës që do të përdoret për grumbullimin e të dhënave të Censit të Bujqësisë.

Grafiku më poshtë paraqet situatën aktuale të MoU-ve.

Figura 11. Situata aktuale e Memorandumeve/Marrëveshjeve të bashkëpunimit



Lista e memorandumeve të mirëkuptimit dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara ndërmjet INSTAT dhe institucioneve të tjera është paraqitur në aneksin nr. 3 të këtij dokumenti.

X. Veprimtaria e organizmave mbështetës të prodhimit statistikor

Referuar legjislacionit për statistikat zyrtare, organizmat mbështetës për prodhimin statistikor janë:

- Bordi Drejtues i INSTAT-it
- Këshilli i Statistikave
- Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën

Veprimtaria e Bordit Drejtues

Bordi Drejtues është organ i cili vepron brenda INSTAT-it dhe ka për detyrë të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të institucionit, të propozojë planet për zbatimin e buxhetit dhe mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave të tij, si dhe t'i propozojë Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT udhëzime dhe standarde, të cilat sigurojnë zbatimin e parimeve statistikore nga Sistemi Kombëtar Statistikor. Detyrat specifike të Bordit përcaktohen në nenin 20 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”.

Bordi Drejtues përbëhet nga nëpunësit civilë të INSTAT-it, të cilët janë të paktën të nivelit të mesëm drejtues, duke iu referuar strukturës organizative të miratuar me vendimin e Kuvendit. Në interes të transparencës me publikun, si dhe në përmbushje të rekomandimeve të Peer Review 2018, veprimtaria e Bordit Drejtues është publikuar në faqen zyrtare të internetit të INSTAT-it.

Bordi Drejtues ka zhvilluar 5 mbledhje gjatë vitit 2024, përkatësisht në datat: 18.03.2024, 8.07.2024, 19.09.2024, 26.11.2024, 18.12.2024.

Në katërmujorin e parë të vitit është zhvilluar një mbledhje e Bordit Drejtues, më 18.03.2024, në të cilën u rishikua Rregullorja e Bordit Drejtues. Pas diskutimeve, me vendim të Bordit Drejtues u miratuan ndryshimet në rregulloren e Bordit Drejtues - vendimi nr. 2, datë 20.03.2024 i Bordit Drejtues.

Në katërmujorin e dytë Bordi Drejtues zhvilloi 1 mbledhje, më 08.07.2024. Në këtë mbledhje u shqyrtuan ndryshimet e Rregullores së brendshme të INSTAT, për shkak të ndryshimit të strukturës organizative të INSTAT (Vendimi i Kuvendit nr. 16/2024, datë 15.02.2021¹⁴ “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 127/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Statistikave (INSTAT)”. Pas diskutimeve, Bordi Drejtues miratoi ndryshimet në Rregulloren e brendshme të INSTAT - vendimi nr. 5, datë 08.07.2024 i Bordit Drejtues.

Në katërmujorin e tretë Bordi Drejtues zhvilloi tre mbledhje, më 19.09.2024, 26.11.2024, 18.12.2024. Në mbledhjen e datës 19.09.2024 u shqyrtuan ndryshimet e nevojshme në Rregulloren e INSTAT në zbatim të VKM nr. 530/01.08.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 568, datë 6.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”. Pas diskutimeve, Bordi Drejtues miratoi ndryshimet në Rregulloren e brendshme të INSTAT, vendimi nr. 7, datë 23.09.2024 i Bordit Drejtues. Në mbledhjen e dytë të datës 26.11.2024 Bordi shqyrtoi Projekt-Planin Vjetor 2025 për zbatimin e PSZ 2022-2026. Në mbledhje u shqyrtuan rekomandimet e Këshillit të Statistikave mbi këtë dokument. Pas diskutimeve, Bordi miratoi Projekt-Planin Vjetor 2025 për zbatimin e PSZ 2022-2026 – vendimi nr. 8, datë 26.11.2024 i Bordit Drejtues. Në mbledhjen e fundit të vitit 2024, të zhvilluar më 18.12.2024, Bordi shqyrtoi dhe miratoi Projekt-Udhëzimin “Për zbatimin e një kornize të përbashkët për Statistikat Evropiane në lidhje me personat dhe njësitë ekonomike familjare, bazuar në të dhënat në nivel individual, të mbledhura nga kampioni”, vendimi nr. 9, datë 18.12.2024 i Bordit Drejtues, si dhe miratoi Planin për funksionimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për vitin 2025 – vendimi nr. 10, datë 18.12.2024 i Bordit Drejtues. Gjithashtu në këtë mbledhje u shqyrtuan manualët e procedurave të drejtorive, të rishikuara sipas strukturës së re organizative të INSTAT.

Veprimtaria e Këshillit të Statistikave

Këshilli i Statistikave mbështet INSTAT-in në rolin e tij për të siguruar se Programi i Statistikave Zyrtare është hartuar në përputhje me parimet themelore të Kombeve të Bashkuara për statistikën zyrtare.

Këshilli i Statistikave përbëhet nga 11 anëtarë, të cilët përfaqësojnë përdoruesit e statistikave zyrtare, botën akademike, shoqërinë civile, sipërmarrësit privatë, organet e vetëqeverisjes vendore dhe median.

Emërimi i anëtarëve bëhet me vendim të Kuvendit. Këshilli i Statistikave e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare” dhe VKM-në nr. 670, datë 7.11.2018 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”.

Këshilli i Statistikave mblidhet të paktën tri herë në një vit kalendarik. Kuorumi përbëhet nga të paktën shtatë anëtarë të Këshillit. Sekretariati i Këshillit të Statistikave sigurohet nga INSTAT-i.

Këshilli i Statistikave zhvilloi 5 mbledhje gjatë vitit 2024, përkatësisht në datat: 8.02.2024, 25.03.2024, 4.06.2024, 17.10.2024, 20.11.2024.

Në katërmujorin e parë të vitit Këshilli zhvilloi dy mbledhje. Në mbledhjen e datës 8.02.2024 Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT informoi Këshillin e Statistikave mbi çështjet si: Situata e Sulmit Kibernetik ndaj INSTAT; Miratimi nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave/Kuvendi i Planit Vjetor të PSZ 2024 dhe i Projekt-Strukturës së INSTAT; Seancën dëgjimore në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave lidhur me informimin mbi zhvillimin e Censit të Bujqësisë, strukturat e IT në INSTAT pas situatës së sulmit kibernetik. Znj. Dhuli informoi Këshillin për ftesën e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave që anëtarët këshillit t'i bashkoheshin kësaj seance. Në mbledhjen e dytë të këtij katërmujori, datë 25.03.2024, Këshilli shqyrtoi Draft-Raportin Vjetor të INSTAT, si dhe raportin 4 mujor mbi ecurinë e zbatimit të PSZ, për periudhën Shtator-Dhjetor 2024.

Në katërmujorin e dytë të vitit Këshilli zhvilloi një mbledhje, në datë 4.06.2024. Pikat e agjendës mbi të cilën u zhvillua mbledhja ishin: Prezantimi i anëtarëve të rinj të Këshillit të Statistikave; Informacion para publikimit të të dhënave të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023; Informacion mbi pyetjet dhe komentet nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave në Kuvend mbi Raportin Vjetor të INSTAT 2023.

Në katërmujorin e tretë të vitit Këshilli i Statistikave zhvilloi dy mbledhje. Në mbledhjen e datës 17.10.2024 Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, Znj. Elsa Dhuli, prezantoi për Këshillin ecurinë e zbatimit të PSZ gjatë periudhës Maj-Gusht 2024, duke evidentuar ecurinë e zbatimit të Planit Vjetor sipas fazave kryesore të prodhimit statistikor. Gjithashtu, pika të tjera të agjendës mbi të cilën u zhvillua mbledhja ishte informacioni për publikimin e të dhënave të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, si dhe informacion mbi Censin e Bujqësisë. Në mbledhjen e datës 20.11.2024 Këshilli shqyrtoi Projekt-Planin Vjetor 2025 për zbatimin e PSZ 2022-2026, dokument i cili u prezantua për Këshillin nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, Znj. Dhuli.

Veprimtaria e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën drejton aktivitetet për përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve zyrtare ekonomike dhe sociale, në përputhje me nomenklaturat evropiane dhe ndërkombëtare.

Komisioni e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe aktet nënligjore që rregullojnë ngritjen, funksionimin, detyrat dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të këtij komisioni.

KKN kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT dhe anëtarët e komisionit përfaqësojnë institucionet sipas VKM Nr. 671, datë 07.11.2018.

Komisioni Kombëtar i Nomenklaturave përbëhet nga 19 anëtarë, të cilët përfaqësojnë përdoruesit kryesorë të nomenklaturave, pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor.

Nomenklaturat përdoren si bazë për mbledhjen, përpilimin dhe shpërndarjen e të dhënave në çdo fushë statistikore. Ato ofrojnë koncepte të standardizuara, të përdorura për të përshkruar fenomene të tilla si aktiviteti ekonomik, produktet, shpenzimet, profesioni, shëndetësia etj, si dhe shërbejnë për të matur në mënyrë të vazhdueshme këto fenomene brenda vendit dhe në të gjithë vendet dhe rajonet gjeografike. Klasifikimet ndërkombëtare vendosin standarde për klasifikimet e përdorura, të cilat shërbejnë si modele për zhvillimin e klasifikimeve statistikore përkatëse kombëtare. Nomenklaturat bëjnë të mundur krahasimin e të dhënave me rajonin, Evropën apo edhe me shtetet e tjera në mbarë botën. Ato janë mjete që përdoren

nga organizatat kombëtare të statistikave, agjencitë ndërkombëtare, akademitë dhe përdoruesit e tjerë, përfshirë edhe përfaqësuesit ligjorë.

Komisioni Kombëtar i Nomenklaturave ka zhvilluar tre mbledhje gjatë vitit 2024, përkatësisht në datat 11.06.2024, 14.10.2024 dhe 13.12.2024.

Në datën 11.06.2024 u zhvillua mbledhja e parë e KKN-së. Diskutimet u fokusuan në çështje si: Prezantimi i materialeve në versionin shqip të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (të rishikuar), versioni NVE Rev 2.1; Diskutime mbi planin e trajnimeve mbi vënien në zbatim të NVE Rev 2.1; Çështje të tjera.

Në datën 14.10.2024 u zhvillua mbledhja e dytë e vitit. Diskutimet u fokusuan në çështje si: Puna e kryer nga INSTAT dhe KKN mbi Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike të rishikuara NVE Rev. 2.1; Hapat për finalizimin e miratimit të NVE Rev 2.1; Çështje të tjera.

Në datën 13.12.2024 u zhvillua mbledhja e fundit për vitin 2024. Diskutimet u fokusuan në çështje si: Miratimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të rishikuar, NVE Rev 2.1; Prezantimi mbi rishikimin e Nomenklaturës së Konsumit Individual sipas Qëllimit, COICOP.


Gjithsej, aktualisht, janë të miratuara 11 akte ligjore në drejtim të klasifikimeve.

XI. Zbatimi i Rekomandimeve

Zbatimi i rekomandimeve të Kuvendit

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit prot. 1296/2, datë 26.07.2024 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave për vitin 2023” INSTAT gjatë vitit 2024 ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit. Nga 11 rekomandime të lëna nga Kuvendi, janë realizuar 3 prej tyre, ndërsa 8 të tjera janë në proces realizimi.

Figura 12: Ecuria e zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit



Në vijim paraqitet në mënyrë të detajuar ecuria për çdo rekomandim dhe aktivitetet e ndërmarra nga INSTAT për përmbushjen e plotë të tyre:

Rekomandimi nr.1. Pas përpunimit të të dhënave me cilësi dhe profesionalizëm të Censit të popullsisë dhe të banesave 2023, të publikojë brenda afateve të përcaktuara rezultatet përfundimtare të Censit, por edhe publikime të tjera gjeoreferenciale dhe me karakter social, sipas kalendarit të shpallur, të cilat do të shërbejnë si një bazë e fortë për planifikimin e politikave publike dhe do të ndihmojnë në zhvillimin e programeve që synojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Statusi: Realizuar

Publikimi i të dhënave të Censit të Popullsisë dhe Banesave u realizua në Qershor 2024, sipas Kalendarit të Publikimeve, me botimin *Rezultate kryesore të Censit të Popullsisë dhe Banesave, 2023* dhe në Tetor 2024 u realizua publikimi i rezultateve në nivel të detajuar rajonal, Qark/Bashki/Njësi Administrative (12 publikime të dedikuara për çdo qark).

INSTAT ka ndërtuar *Geodata Hub*, që është platforma online e të Dhënave Gjeohapësinore, e cila ofron akses në informacionin statistikor dhe gjeohapësinor. Pjesë e kësaj platforme është edhe *Web GIS*, që ndihmon në analizimin, shkarkimin, ndarjen e të dhënave gjeohapësinore përmes internetit, si edhe vizualizimin e tyre me anë të komponentit gjeografik, pa pasur nevojë për programe të specializuara. Kjo platformë mundëson hartëzimin interaktiv, analizat hapësinore, duke e bërë më të lehtë për përdoruesit nga fusha të ndryshme qasjen dhe përdorimin e të dhënave të gjeoreferuara. Gjithashtu në këtë platformë janë publikuar të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.

Rekomandimi nr.2. Të ndërmarrë iniciativa që të përdorë të dhënat e Censit për të përditësuar platformën e SDG/OZHQ për të gjithë treguesit dhe nën treguesit, që tashmë janë pjesë e platformës.

Statusi: Në proces

Të dhënat e Censit janë një burim i konsiderueshëm informacioni për llogaritjen e treguesve për zhvillim të qëndrueshëm. Ky është objektiv me prioritet për INSTAT dhe një proces në vazhdimësi, pasi treguesit e popullsisë nga Censi duhet të kombinohen edhe me informacione nga burime të tjera informacioni.

Rekomandimi nr. 3. Të marrë masat e nevojshme për të bërë të mundur realizimin me cilësi dhe në kohë të Censit të Ekonomive Bujqësore në përputhje me acquis të BE-së dhe standardet ndërkombëtare, si dhe bazuar në vizionin dhe objektivat strategjike për kryerjen e tij.

Statusi: Në proces

Censi i Bujqësisë është një aktivitet madhor dhe me rëndësi të veçantë, për realizimin e së cilit kërkohet edhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë në vend, të lidhur drejtëpërdejt me fushën e Bujqësisë dhe Blektorisë. Për këtë aktivitet, INSTAT është në bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me të cilën ka nënshkruar edhe një Memorandum Bashkëpunimi, si dhe me aktorë të tjerë në vend. Grumbullimi i të dhënave kërkon një bazë populsi (statistikore) cilësore, të rekomanduar edhe nga ekspertët të FAO dhe BE, për të cilën duhet të përdoren *dataset*-i i të dhënave nga censi i popullsisë, regjistrat administrativë të MBZHR dhe Kadastrës. Bashkërendimi dhe bashkëfunksionimi cilësor dhe i unfikuar i këtyre *dataset*-eve kërkon ekspertizë, e cila është në proces, si dhe platformë specifike për grumbullimin e të dhënave në terren. Ekspertët e INSTAT dhe të MBZHR po bashkëpunojnë me asistencën teknike për përgatitjen statistikore të këtyre *dataset*-eve. Jemi në diskutime me partnerët tanë evropianë për mbështetjen me ekspertizë dhe fonde. Nga situata e faktorëve të jashtëm, ky cens përkon edhe me zgjedhjet elektorale kombëtare, të cilat këtë vit kanë filluar përgatitjet më shpejt, për shkak të planifikimit. Me nisjen

e një aktiviteti të tillë, nuk rekomandohet dhe lejohet organizimi i një censi, i cili kërkon përfshirjen edhe të aktorëve të tjerë për mbështetje administrative dhe logjistike. Në këto kushte, INSTAT vazhdon përgatitjet, ndërkohë që grumbullimi do të kryhet në një moment të përshtatshëm, mbi një bazë cilësore statistikore dhe teknologjike dhe situatë kombëtare.

Rekomandimi nr.4. Në kuadër të rritjes së sigorisë kibernetike, të marrë masat e nevojshme për përditësimin dhe përmirësimin e sistemeve hardware dhe software të institucionit, si dhe të bashkëpunojë me AKSK (AKCESK) për të forcuar më tej sigurinë ndaj sulmeve të mundshme kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave statistikore, si dhe informacionit konfidencial.

Statusi: Realizuar

Pas sulmit kibernetik të ndodhur në fund të Janarit 2024, INSTAT, në bashkëpunim me autoritetin shtetëror për sigurinë kibernetike në vend AKSK, AKSHI, Ministrinë e Financave dhe partnerët tanë, ka përmirësuar infrastrukturën teknologjike, për mbrojtje të informacionit statistikor nga sulmet e mundshme kibernetike.

Gjithashtu, INSTAT po punon me institucionet përgjegjëse në vend dhe ato evropiane për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e brendshëm të sigorisë së informacionit dhe sistemeve.

Rekomandimi nr.5. Në kuadër të transparencës dhe plotësimit më të mirë të nevojave të përdoruesve, të marrë masat e nevojshme për të bërë sa më shpejt aktive përgjatë 24 orëve faqen web të INSTAT.

Statusi: Realizuar

Pas situatës kritike të krijuar, INSTAT, për arsye procedurale të ringritjes së serverave, sistemit, migrimit të platformave në sistemet e reja, menaxhoi faqen e web me reduktim orari funksionimi dhe aksesit. Pas rivendosjes së sistemeve, faqja e INSTAT është në funksionim 24/7 dhe e aksesueshme nga çdo përdorues i brendshëm apo i jashtëm.

Rekomandimi nr.6. Për të përmirësuar transparencën dhe besueshmërinë e të dhënave tona kombëtare, të rrisë nivelin e transmetimit të të dhënave në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), duke ndjekur Standardin Special të Shpërndarjes së të Dhënave (Special Data Dissemination Standard-SDDS). Përmeshja e standardeve të SDDS-së do të rrisë më shumë transparencën dhe besueshmërinë e të dhënave, të cilat janë thelbësore për vendimarrje të informuar drejt nxitjes së rritjes ekonomike.

Statusi: Në proces

Në kuadër të vlerësimit të cilësisë dhe transparencës me institucionet ndërkombëtare, si FMN, Shqipëria momentalisht është anëtare e platformës (Enhanced General Data Dissemination System (eGDDS), ku koordinator vendi është INSTAT, i cili koordinon punën me institucionet vendase si Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave. Për të kaluar në platformën SDDS, tre institucionet Shqiptare kanë marrë iniciativat për prodhimin dhe sigurimin e të dhënave të reja të përshtatura sipas kërkesave të kësaj platforme. Ky është një hap i rëndësishëm, jo vetëm për transparencë raportimi, por edhe për vlerësimin e cilësisë së veprimtarisë ekonomike financiare të Shqipërisë nëpërmjet shifrave.

Rekomandimi nr. 7. Në zbatim të objektivit strategjik për forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor, të luajë një rol pro aktiv, duke komunikuar me institucionet publike të vendit për ngritjen e strukturave të dedikuara për statistikat zyrtare, duke i konsideruar ato si shumë të rëndësishme për burimet administrative të të dhënave, për planifikimin e politikave publike në zhvillimin dhe transformimin ekonomiko-social të vendit.

Statusi: Në proces

Në zbatim të këtij rekomandimi, INSTAT është fokusuar në dy drejtime: Forcimin e kapaciteteve të INSTAT-it për forcimin e rolit si koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor dhe forcimin e kapaciteteve të tjera prodhuese dhe furnizuese me të dhëna statistikore. Përsa i takon drejtimit të parë, INSTAT ka përgatitur strategjinë e zhvillimit të institucionit, ku një ndër objektivat është edhe forcimi i koordinimit. Gjithashtu, ka përgatitur strategjinë e trajnimit të stafit për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e infrastrukturës së koordinimit, si sistemi për planifikim dhe monitorim. Kryerja e trajnimit të personave të identifikuar, nëpunës civilë, të cilët janë të angazhuar në dhënie, përpunimin dhe prodhimin e të dhënave administrative, është fokusi i drejtimit të dytë. Në këtë mënyrë, INSTAT parashikon jo vetëm rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve të tjera publike për pasurimin e të dhënave që disponojnë, por edhe për marrjen e masave në institucionet që përfaqësojnë për përgatitjen e një infrastrukture më të mirë të bazës së të dhënave administrative, që të shërbejnë në mënyrë të përshtatshme për gjenerimin e statistikave cilësore.

Memorandumet e Bashkëpunimit që janë nënshkruar me institucionet publike për transmetimin e të dhënave administrative për qëllime statistikore janë një aspekt tjetër që ndikon në zgjerimin e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe forcimin e burimeve të të dhënave që ky Sistem përdor.

Rekomandimi nr. 8. Të rrisë prodhimin dhe transmetimin e të dhënave në kohë dhe me cilësi të lartë për shpërndarje (publikim) nga Eurostat, si dhe të vërë në dispozicion të publikut të dhënat lidhur me statistikave financiare të qeverisë, siç theksohet edhe në progresraportin e KE-së.

Statusi: Në proces

INSTAT publikoi në Shtator të vitit 2024 serinë e rishikuar të Llogarive Kombëtare, për pesë vitet e fundit, duke i prodhuar ato në përputhje me standardet evropiane, (ESA 2010), në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë (BSH) dhe Ministrinë e Financave (MF). Ky rishikim i të dhënave përmbushi një nga rekomandimet e Progres Raportit për Shqipërinë (kapitulli 18, Statistikat), duke siguruar një transmetim të saktë dhe në kohë të statistikave në Eurostat. INSTAT është duke punuar për përgatitjen e serive të të dhënave, nga viti 1995, për të rritur përputhshmërinë dhe plotësimin e kërkesave për transmetimin e treguesve të Llogarive Kombëtare në Eurostat.

Një nga arritjet kryesore ka qenë gjithashtu edhe përgatitja e dokumenteve të nevojshme për zbatimin e NVE rev.2.1 (NACE rev 2.1) në versionin shqip të certifikuar, duke përfshirë diskutimin dhe miratimin e projekt-vendimit, nga Komisioni Kombëtar i Nomenklaturave, përpara dërgimit në Këshillin e Ministrave. Ky akt ligjor është i rëndësishëm për përputhshmërinë e statistikave të Shqipërisë me standardet evropiane dhe për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian, si dhe është planifikuar në kuadër të Procesit të Integritetit Evropian (PKIE).

Në kuadër edhe të PKIE, 2024-2026, në Dhjetor 2024 INSTAT miratoi një udhëzim të ri “Për krijimin e një kornize të përbashkët për statistikave evropiane në lidhje me personat dhe familjet, bazuar në të dhënat në nivel individual të mbledhura nga kampioni”. Ky udhëzim ka për qëllim të rrisë përputhshmërinë e statistikave sociale me aktet komunitare përkatëse (të drejtën e BE-së).

Në përputhje me Planin Vjetor dhe rekomandimet e Progres Raportit, në Dhjetor 2024 u publikuan edhe treguesit kryesorë mbi shpenzimet dhe personelin e angazhuar për aktivitetet e Kërkimit dhe Zhvillimit.

Rekomandimi nr. 9. Me gjithë përmirësimet e bëra, duhet të rrisë përpjekjet për të ulur numrin e punonjësve që largohen nga institucioni përmes, përmirësimit të procesit të rekrutimit, shpërblimit të punonjësve dhe trajnimit të tyre, krijimit të një ambienti konkurrues, transparent për rritjen në detyrë të tyre, duke bërë të mundur krijimin e një stafi, i cili ka eksperiencën dhe profesionalizmin e nevojshëm për përballimin e sfidave me të cilat përballlet institucioni.

Statusi: Në proces

Lidhur me rekomandimin për uljen e lëvizjes së punonjësve dhe përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore, INSTAT ka ndërmarrë disa masa konkrete për të adresuar këtë çështje, duke angazhuar stafin në trajnime afatshkurtra dhe afatmesme, seminare, workshop-e, përfaqësim në grupe pune, task force, si brenda ashtu dhe jashtë vendit, duke mundësuar promovimin e rritjes profesionale të tyre, krijimin dhe forcimin e bashkëpunimit në rrjet ndërkombëtar dhe marrjen e eksperiencave më të mira. Gjithashtu, INSTAT promovon pjesëmarrjen e stafit në konferenca ndërkombëtare, për një qasje akademike, pasi një pjesë e punonjësve prej 6 persona, janë studentë doktore, por jo vetëm, edhe punonjës të tjerë janë motivuar të marrin pjesë në këto konferenca.

Për vitin 2025 sipas kërkesës së INSTAT është miratuar një shtesë stafi prej 24 punonjësish në strukturën e institucionit për të përmbushur nevojat në rritje, lidhur me aktivitetet statistikore dhe për të rishpërndarë ngarkesën e punës në mënyrë më efektive, për përmbushjen e detyrimeve statistikore kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përmirësuar performancën e përgjithshme të institucionit. Kjo shtesë ka për qëllim jo vetëm përmirësimin e efikasitetit të punës, por edhe krijimin e një mjedisi më të qëndrueshëm profesional.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i motivimit për rritjen e pagave, i adresuar nga INSTAT, është edhe përgatitja e projekt-aktit normativ (VKM) për rritjen e pagave të punonjësve në fushën e IT-së, në rolin e tyre si prodhues dhe menaxhues të bazës së të dhënave shtetërore. Kjo masë ka për qëllim motivimin e tyre, rritjen e qëndrueshmërisë dhe reduktimin e lëvizshmërisë në këtë sektor strategjik për institucionin.

Rekomandimi nr. 10. Të hartojë dhe të zbatojë një strategji të dedikuar komunikimi për Censin e Ekonomive Bujqësore, e cila të ketë si synim rritjen e ndërgjegjësimit dhe evidentimin e rëndësisë së Censit për audiencën përkatëse.

Statusi: Në proces

Strategjia e komunikimit nuk është finalizuar ende, për hartimin dhe zbatimin e saj dhe deri tani janë ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

Draft-buxheti është përgatitur, duke përfshirë zërat kryesorë për aktivitetet që do të realizohen gjatë Censit të Bujqësisë. Janë identifikuar audiencat kryesore dhe janë parashikuar kanalet dhe metodat që do të përdoren për komunikim. INSTAT po punon intensivisht për të siguruar mbështetje financiare nga donatorët ndërkombëtarë dhe partnerë të tjerë për të mundësuar zbatimin e këtij aktiviteti.

Rekomandimi nr. 11. Duke i konsideruar statistikatat zyrtare si një të mirë publike në drejtim të prioritetëve kombëtare për zhvillim dhe integritet, të rrisë përpjekjet për zbatimin e metodave inovative dhe bashkëkohore në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare, të intensifikojë përdorimin e teknologjisë së inovacionit në funksion të përmirësimit të proceseve të prodhimit statistikor, të integritetit të burimeve të ndryshme të të dhënave dhe përmirësimit të përpunimit të tyre, duke rritur përdorimin e të dhënave, që janë pjesë përbërëse e platformave të ndërveprimit qeveritar.

Statusi: Në proces

INSTAT, si institucion koordinator i Sistemit Kombëtar statistikor dhe kryesor për prodhimin e statistikave zyrtare, ka intensifikuar përpjekjet për përfshirjen e metodave inovative jo vetëm në fushën e teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimit, por edhe në zbatimin e metodave të avancuara për prodhimin e statistikave. Zëvendësimi i metodave tradicionale të grumbullimit të të dhënave me mjete digjitale, si tabletë/laptopë/telefon dhe web-forms, përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt zbatimit të parimit kosto-efektivitet. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2024 u përdorën 30 aplikacione për mbledhjen e të dhënave përmes metodave CAPI, CATI dhe CAWI. Gjithashtu, janë ndërmarrë hapa për përdorimin e software open source në disa faza të përpunimit të informacionit statistikor, si proceset e kampionimit dhe analizës së cilësisë së të dhënave.

XII. Burimet financiare dhe njerëzore

Burimet Financiare

Instituti i Statistikave është institucion publik qëndror, i pavarur. Burimet e financimit për kryerjen e aktiviteteve statistikore dhe aktiviteteve mbështetëse sigurohen kryesisht nga buxheti i shtetit. Ndikim domethënës kanë edhe financimet e huaja, nëpërmjet donatorëve apo granteve të alokuara nga ata, si dhe të ardhurat dytësore apo fondet jashtë limitit, të cilat sigurohen nga veprimtaritë dytësore që kryen INSTAT.

Për vitin 2024 janë shpenzuar nga buxheti i shtetit 774.4 milion lekë, dhe në total, së bashku me donatorët, janë shpenzuar 971.7 milion lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 10: Shpenzimet 2020-2024 (mijë/lekë)

FAKT					
SHPENZIMET	2020	2021	2022	2023	2024
Paga + kontribut	423,142	455,530	457,882	610,195	624,235
Mallra dhe shërbime të tjera	47,888	37,092	59,827	599,390	91,874
Totali korente	471,030	492,621	517,709	1,209,585	716,109
Investime	44,767	15,135	11,719	296,350	15,205
Totali buxheti	515,796	507,756	529,427	1,505,935	731,314
Paga + kontribut	32,445	35,269	32,046	37,649	30,649
Mallra dhe shërbime të tjera	26	11	53	55	12,447
Totali korente	32,471	35,280	32,098	37,704	43,096
Investime	0	0	0	0	0
Totali të ardhurat	32,471	35,280	32,098	37,704	43,096
Paga + kontribut	9,426	3,174	1,478	1,823	721
Mallra dhe shërbime të tjera	18,407	86,566	7,634	3,997	8,290
Totali korente	27,832	89,741	9,112	5,819	9,011
Investime	21,348	0	0	0	0
Të ardhura jashtë limiti	49,180	89,741	9,112	5,819	9,011
Paga + kontribut	7,071	7,094	0	0	0
Mallra dhe shërbime të tjera	14,456	97,608	170,143	317,002	188,316
Totali korente	21,528	104,701	170,143	317,002	188,316
Investime	8,095	6,452	0	0	0
Të ardhura donator	29,623	111,153	170,143	317,002	188,316
Paga + kontribut	472,084	501,067	491,405	649,667	655,605
Mallra dhe shërbime të tjera	80,776	221,277	237,657	920,443	300,928
Totali korente	552,861	722,344	729,062	1,570,110	956,533
Investime	74,209	21,587	11,719	296,350	15,205
TOTALI	627,070	743,930	740,781	1,866,460	971,739

Tabela 11: Realizimi i shpenzimeve për vitin 2024 me fondet e buxhetit të shtetit

(mijë/lekë)


VITI 2024					
Art.	SHPENZIMET	Plan Vjetor	Plan i Rishikuar	Fakti	Real ne %
600	Paga	476,751	569,162	561,965	98.7
601	Kontribute sigurime shoq-shënd.	83,149	95,102	92,919	97.7
602	Mallra dhe shërbime të tjera	371,026	111,037	97,874	88.1
604	Transferime korente	1,574	1,574	751	47.7
606	Transferime buxhetesh familjare	0	6,035	5,696	94.4
	SHUMA	932,500	782,910	759,205	96.9
231	Investime buxheti	150,000	89,485	12,138	13.6
230	Investime buxheti	0	3,516	3,067	87.2
	TOTALI	1,082,500	875,910	774,410	88.4

Tabela 12: Realizimi i shpenzimeve me fondet e buxhetit të shtetit për vitet 2020-2024

(mijë/lekë)

	2020	2021	2022	2023	2024
Paga dhe Sigurime	455,587	490,799	489,928	647,844	654,884
Mallra dhe shërbime të tjera	47,913	37,103	59,880	599,445	104,321
Investime	44,767	15,135	11,719	296,350	15,205
Totali buxhetit	548,267	543,037	561,526	1,543,639	774,410

Figura 13: Realizimi i shpenzimeve me fondet e buxhetit të shtetit për vitet 2020-2024



Siç shihet nga grafiku, volumin kryesor të shpenzimeve ndër vite e zë pjesa e pagave të stafit të INSTAT-it dhe pagat e personave të kontraktuar me kohë të pjesshme.

Instituti të Statistikave për vitin ushtrimor 2024 i janë akorduar nga buxheti i shtetit 774.4 milion lekë, nga 1,543.6 milion lekë të akorduara në vitin 2023, ose 769.2 milion lekë më pak.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2024 janë shpenzuar nga fondet e buxhetit të shtetit 774.4 milion lekë.

Realizimi i shpenzimeve të Aparatit Qëndror, Insituti i Statistikave dhe Zyrave Rajonale Statistikore në rrethe, sipas zërave.

Tabela 13: Realizimi i shpenzimeve Janar - Dhjetor 2024

(mijë/lekë)

Aparati Qendror Instat dhe Zyrat Rajonale Statistikore				
Art.	SHPENZIMET	Plan vjetor	Plan i rishikuar	Fakti 12-mujor Real ne %
600	Paga	476,751	569,162	561,965 98.7
	Zyrat Rajonale	48,641	51,461	48,087 93.4
	Aparati Qëndror nga buxheti	393,846	490,437	488,115 99.5
	Aparati Qëndror nga të ardhurat	34,264	27,264	25,764 94.5
601	Kontribute sig shoq-shënd	83,149	95,102	92,919 97.7
	Zyrat Rajonale	8,120	8,596	8,035 93.4
	Aparati Qëndror nga buxheti	69,144	81,621	79,999 98.0
	Aparati Qëndror nga të ardhurat	5,885	4,885	4,885 100.0
602	Mallra dhe shërbime të tjera	371,026	111,037	98,024 88.2
	Zyrat Rajonale	6,670	6,670	5,331 79.9
	Aparati Qëndror nga buxheti	362,356	90,017	80,246 89.1
	Aparati Qëndror nga të ardhurat	2,000	14,350	12,447 86.7
604	Transferime korente	1,574	1,574	751 47.7
	Aparati Qëndror nga buxheti	1,574	1,574	751 47.7
606	Transferime buxhetesh familjare	0	6,035	5,696 94.3
	Zyrat Rajonale	0	0	0 0.0
	Aparati Qëndror nga buxheti	0	6,035	5,696 94.3
	SHUMA	932,500	782,910	759,355 96.9
	Investime Aparati Qëndror	150,000	93,000	15,205 16.3
230	Studime dhe projekte	0	3,516	3,067 87.2
231	Investime buxheti	150,000	89,485	12,138 13.6
	Financim i huaj	100,000	110,000	188,316 171.2
	Te ardhura jashte limitit	0	0	9,011 0.0
	TOTALI	1,182,500	985,910	971,739 98.5

- Siç shihet nga pasqyra, në artikullin 600, Paga janë shpenzuar 561.9 milion lekë, e barabartë kjo me 98.7% të vlerës së parashikuar në planin vjetor.
- Në artikullin Sigurime shoqërore e shëndetësore janë shpenzuar 92.9 milion lekë, e barabartë kjo me 97.7% të vlerës së parashikuar në planin vjetor.
- Në zërin Mallra dhe shërbime të tjera, për vitin 2024, janë shpenzuar 98 milion lekë, e barabartë kjo me 88.2% të vlerës së parashikuar në planin vjetor.

- Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2024 për zërin *Transferta korrente të brendshme* është 1.6 milion lekë, nga të cilat janë shpenzuar 751 mijë lekë, ose 47.7% e fondit.
- Gjatë vitit 2024 për zërin *Transferta për buxhete familjare* janë shpenzuar 5.7 milion lekë ose 94.3%.
- Realizimi i zërit *Studime dhe projekte* është 3.1 milion lekë, ose 87.2% e totalit.
- Realizimi i *Investimeve me financim të brendshëm* është 12.1 milion lekë, ose 13.6% e totalit.
- Realizimi i shpenzimeve me *Financim të huaj* për vitin 2024 është 188.3 milion lekë.
- *Shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit* për vitin 2024 janë 9 milion lekë.

INSTAT i administron fondet në një program “Veprimtaria Statistike”.


Tabela 14: Buxheti sipas programit “Veprimtaria Statistike”

(mijë/lekë)

Shpenzimet	Plani	Fakti	Realizimi %
Veprimtaria Statistike	875,910	774,410	88.4%
Të ardhura jashtë limitit	0.0	9,011	0.0%
TOTALI	875,910	783,421	89.4%

Për programin e *Veprimtarisë Statistike* për vitin 2024 janë shpenzuar nga fondet e buxhetit të shtetit 774.4 milion lekë, ose 88.4 % e vlerës së parashikuar në Planin Vjetor, nga të ardhurat jashtë limitit janë shpenzuar 9 milion lekë dhe në total janë shpenzuar 783.4 milion lekë.

Figura 14: Buxheti 2024



Siç shihet nga të dhënat e tabelës dhe figurës së mësipërme, plani i shpenzimeve të buxhetit në artikullin 600+601 (paga dhe sigurime) zë rreth 67% të tij, në artikullin 602 *mallra dhe shërbime të tjera* zë 12% të buxhetit dhe për artikullin 230+231 *studime, projekte dhe shpenzime për investime* zë 21%.

Burimet Njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore është i orientuar në zhvillimin e aftësive të punonjësve, mbështetjen në punë, identifikimin dhe trajnimin e tyre, duke synuar përfshirjen e personelit dhe rritjen e angazhimit drejt zhvillimit të qëndrueshëm institucional dhe rritjes së vazhdueshme të performancës.

Në këtë kuadër, INSTAT ka ndërmarrë disa hapa dhe është në proces të vazhdueshëm të hartimit të politikave dhe strategjive që ndihmojnë në arritjen e objektivave institucionale dhe zhvillimin e aftësive të punonjësve.

Në funksion të matjes së kënaqësisë së punonjësve, INSTAT kryen anketën e kënaqësisë së punonjësve, si një strategji të vazhdueshme mbi analizën e faktorëve që ndikojnë në uljen apo rritjen e kënaqësisë së punonjësve dhe hartimin e planit të veprimit mbi rritjen e kënaqësisë së punonjësve.


Në zbatim të Strategjisë së Trajnimeve të INSTAT, Planit Vjetor dhe Kalendarit Vjetor të Trajnimeve, gjatë vitit 2024 janë realizuar trajnime të vazhdueshme si brenda, ashtu edhe jashtë vendit me qëllim ngritjen, përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale.

Gjithashtu, INSTAT ka zhvilluar gjatë vitit 2024 procedurat e rekrutimit për shërbimin civil, në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për pozicionet vakante.

Në organikën e INSTAT, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 16/2024, datë 15.02.2024 “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 127/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Statistikave (INSTAT)”, numri i punonjësve të miratuar është 236 punonjës (187 punonjës në qendër dhe 49 punonjës në zyrat rajonale). Gjendja faktike në INSTAT në fund të vitit 2024 ishte 230 punonjës dhe 6 pozicione vakante, nga 236 pozicione të organikës, nga të cilët 224 punonjës në shërbimin civil, 12 punonjës administrativë.

Përsa i përket raportit gjinor të punonjësve të INSTAT, ashtu si dhe në vitet e mëparshme, në përbërjen e stafit të INSTAT kryeson gjinia femërore. Përqindja që zënë femrat në raport me numrin e përgjithshëm të punonjësve është 73%, kundrejt meshkujve që zënë 27% të numrit gjithsej të punonjësve.

Figura 15: Numri i punonjësve në raportin femra/meshkuj:



Rekrutime

Rekrutimi i nëpunësve të INSTAT-it kryhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar. Njësia Përgjegjëse në INSTAT, ka përfunduar gjatë vitit 2024, procedurat e rekrutimeve për 37 pozicione vakante, të publikuara në faqen e INSTAT dhe në faqen e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Rekrutimet për kategorinë ekzekutive të shërbim civil (Specialistë)

Kanë përfunduar procedurat e rekrutimeve për 25 punonjës, nga të cilët:

- 2 punonjës janë rekrutuar me procedurë të lëvizjes paralele;
- 18 punonjës janë rekrutuar me procedurën e pranimit në shërbimin civil;
- 4 pozicione janë plotësuar nga lista e pritjes, ndërkohë që ka dhe 1 fitues në listë pritje;
- 1 pozicion është plotësuar me zbatim të vendimit të gjykatës.

Rekrutime për kategorinë e nivelit të ulët drejtues (Përgjegjës Sektori)

Kanë përfunduar procedurat e rekrutimit për 8 punonjës, nga të cilët:

- 2 punonjës janë rekrutuar me procedurë të lëvizjes paralele;
- 6 punonjës janë rekrutuar me procedurë të ngritjes në detyrë.

Rekrutime për nëpunës civil të nivelit të mesëm drejtues (Drejtor Drejtorie)

Kanë përfunduar procedurat e rekrutimit për 4 punonjës, nga të cilët:

- 2 punonjës janë rekrutuar me procedurë të ngritjes në detyrë;
- 1 punonjës me lëvizje paralele;
- 1 pozicion u plotësua me pranim nga jashtë shërbimit civil.

Punonjës me kontratë afatgjatë dhe me kontratë afatshkurtër

Gjatë vitit 2024 janë kontraktuar 488 punonjës me kontratë afatgjatë në pozicionet si: teknik të specialiteteve të ndryshme (kontrollor), kontrollor anketimi, operator dhe anketues. Numri i punonjësve me kontratë afatshkurtër ka qenë 1027, të punësuar në pozicionet si: anketues me kontratë të përkohshme në pozicionet sipas anketave, anketues, operatorë dhe kontrollorë ankete.

Trajnimet e stafit

- Në zbatim të Programit shumëpërfitues të bashkëpunimit IPA 2019 dhe IPA 2022 gjatë vitit 2024 është zhvilluar 1 trajnim afatgjatë, ku është trajnuar 1 punonjës i INSTAT dhe gjithashtu janë zhvilluar 62 trajnime afatshkurtra, me 68 të trajnuar.
- Instituti i Statistikave, në zbatim të ligjit 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", si dhe të Planit Vjetor të Trajnimeve, ka zhvilluar 9 trajnime për punonjësit e INSTAT, ku janë trajnuar 127 punonjës.
- Me mbështetjen e Projektit SALSTAT (Mbështetje për Statistika të Forta Vendore Shqiptare) financuar nga Zyra e Bashkëpunimit Zvicerian për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) janë kryer 9 trajnime, në të cilat kanë marrë pjesë 295 punonjës nga INSTAT dhe Bashkitë.
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike gjatë vitit 2024 ka kryer një sërë trajnimesh me tema, të cilat përfshijnë kategori të ndryshme njohurish dedikuar nivelit ekzekutiv apo drejtues. I janë nënshtruar trajnimit të detyrueshëm për marrjen e statusit të nëpunësit civil 24 punonjës të INSTAT.

Aneksë të Raportit:

- Aneksi Nr.1 Të dhënat kryesore; Aneksi Nr.2 Informacion mbi konferencat për publikimin e të dhënave të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023; Aneksi Nr. 3 Memorandumet e Mirëkuptimit; Aneksi Nr. 4 Lista e Nomenklaturave në fuqi.

Aneksi nr. 1 Të dhënat kryesore

- Censi i Popullsisë dhe Banesave, më 18 Shtator 2023, vlerësoi në territorin shqiptar 2,402,113 banorë rezidentë dhe 755,950 Njësi Ekonomike Familjare;
- Rritja Ekonomike Vjetore 3.96 %;
- Në Shqipëri shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç, në tremujorin e katërt 2024, është 68.3 %, ndërsa shkalla zyrtare e papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart, është 8.8 %;
- Ndryshimi mesatar vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit 2024 është 2.2 %;
- Të ardhurat mesatare mujore të disponueshme për frymë/të ekuivalentuara, në vitin 2023 u vlerësuan 42,209 lekë;
- Shpenzimet mesatare mujore për konsum për një Njësi Ekonomike Familjare, në vitin 2023 u vlerësuan me 91,675 lekë.
- Në Republikën e Shqipërisë, në vitin 2024 kanë hyrë 11.7 milionë shtetas të huaj;
- Numri i udhëtimeve për qëllime personale apo biznesi (brenda apo jashtë Shqipërisë), të kryera nga individët banues në Shqipëri të moshës mbi 15 vjeç gjatë vitit 2023 ishte 4,399,859;
- 31.2% e ndërmarrjeve drejtohen nga gratë;
- Eksportet e mallrave në vitin 2024 arritën vlerën 373 miliardë lekë. Vendet kryesore ku Shqipëria ka eksportuar mallra ishin Italia (44 %), Kosova (10 %) dhe Greqia (6 %);
- Eksportet e shërbimeve në vitin 2024 arritën vlerën 7.4 miliardë euro. Vendet kryesore ku Shqipëria eksporton janë Kosova, Italia dhe Greqia. Shërbimet e udhëtimit zënë pjesën më të madhe të shërbimeve, me rritje 2-shifrore në dy vitet e fundit;
- Investimet direkte në vitin 2024 arritën 1.57 milionë euro;
- Numri i zonave të mbrojtura për vitin 2023 rezultoi 776 zona;
- Menaxhimi i mbetjeve për vitin 2023 është 844,157 tonë.

Aneksi nr.2 Publikimi i të dhënave të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023

1. Konferenca për rezultatet kryesore të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023

Më 28 Qershor 2024, Instituti i Statistikave zhvilloi Konferencën Finale të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, ku u prezantuan rezultatet kryesore të Censit.

Gjatë kësaj Konference Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, znj. Elsa Dhuli, mbajti fjalën hyrëse, ku paraqiti rezultatin e Censit mbi numrin e popullsisë në Republikën e Shqipërisë.



2. Prezantimi i Rezultateve Përfundimtare të Cens 2023 në nivel Qarku dhe Bashkie

Më 31 Tetor 2024, Instituti i Statistikave (INSTAT) organizoi seminarin për publikimin e rezultateve përfundimtare të Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave 2023 në nivel Qarku dhe Bashkie.

Në këtë seminar, i cili u mbajt në ambientet e Hotel Tirana, morën pjesë personalitete dhe përfaqësues të rëndësishëm, si z. Arbjan Mazniku, Ministër i Shtetit për Qeverisjen Vendore, përfaqësues të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, përfaqësues të Delegacionit Evropian, përfaqësues të bashkive të ndryshme, si dhe donatorë.

Gjatë seminarit, INSTAT prezantoi të dhënat përfundimtare të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, në përputhje me kalendarin e publikimeve të institutit. Këto të dhëna përfshijnë informacione të rëndësishme mbi numrin e popullsisë, numrin e ndërtesave për qëllime banimi, madhësinë e Njësive Ekonomike Familjare dhe tregues të tjerë të rëndësishëm në nivel vendor. Gjithashtu, u prezantua metodologjia e përdorur për mbledhjen dhe shpërndarjen e këtyre të dhënave.



Aneksi nr. 3 Memorandumet e Mirëkuptimit

Nr.	Memorandume Mirëkuptimi dhe Marrëveshje Bashkëpunimi	Data e nënshkrimit
Prodhues të statistikave zyrtare		
1	Banka e Shqipërisë	12.05.2008
2	Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë	03.10.2016
3	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	09.02.2018
Ofrues të të dhënave administrative / Përdorues		
4	Ministria e Punëve të Brendshme	11.11.2010
5	Ministria e Mbrojtjes	13.06.2017
6	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	03.05.2023
7	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	06.02.2018
8	Ministria e Kulturës	14.07.2017
9	Ministria e Arsimit, Sportit	22.01.2020
10	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	19.11.2018
11	Qendra Kombëtare e Biznesit	22.01.2020
12	Instituti i Sigurimeve Shoqërore	28.10.2019
13	Drejtoria e e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	24.02.2020
14	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	11.12.2019

15	Prokuroria e Përgjithshme	30.10.2019
16	Agjencia Kombëtare Elektronike dhe Postare	14.12.2017
17	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	20.12.2017
18	Instituti i Shëndetit Publik	30.10.2019
19	Avokati i Popullit	03.09.2020
20	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	09.07.2020
21	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	30.03.2021
22	Ministria e Drejtësisë	11.11.2021
23	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile	
24	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	
25	Këshilli i Investimeve	
26	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Tiranës	
27	SESRIC-Statistical Economic and Social Research and Training Center for Islamic	
28	AKSK (AKCESK)	
29	UN WOMAN	
30	Pushteti Vendor (54 bashki)	
31	Autoriteti Portual Durrës	
32	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	
33	Agjencia Kombëtare e Rinisë	
34	Instituti Kombëtar i Statistikave dhe Studimeve Ekonomike INSEE	
Bota akademike / përdorues të tjerë		
35	Universiteti i Tiranës – Fakulteti i Ekonomisë	25.10.2022
36	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë	02.02.2022
37	UNICEF	31.05.2022
38	Agjencia e Statistikave të Kosovës	07.06.2021
39	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	12.09.2023
40	Universiteti Politeknik i Tiranës	16.02.2023
41	Universiteti Polis	28.09.2023
42	Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi	30.08.2023

Aneksi nr. 4 Lista e Nomenklaturave në fuqi

Nr	Emri i nomenklaturës	Bazaligjore kombëtare	Baza ligjore evropiane/ndërkombëtare	Përmbajtja e bazës ligjore
1	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev2	Vendim i KM nr. 320, datë 28.5.2014 "Për miratimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të Revizionuara (Rev.2)"	Rregullore e Komisionit (EC) Nr 1893/2006 e 20 Dhjetorit 2006 mbi Klasifikimin statistikor të aktiviteteve ekonomike NACE Revision 2	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev2

2	Nomenklatura e Mallrave dhe Tarifave	1. Ligj nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. 2. VKM nr. 651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”	Rregullorja e Këshillit të Evropës, Nr 2658/87, të datës 23 korrik mbi nomenklaturën tarifore dhe statistikore dhe mbi tarifën e përbashkët doganore (Rregullorja bazë)	http://www.dogana.gov.al/dokument/1179/ligj-nr-102-2014-date-3172014-i-ndryshuar http://www.dogana.gov.al/dokument/1497/dz-vkm-nr-651-date-10112017
3	Nomenklatura e produkteve	Vendim i KMNr. 433 datë 17.6.1996 "Për miratimin e zbatimit të nomenklaturës së produkteve"	Rregullorja e Këshillit të Evropës Nr. 1232/98 datë 17 Qershor 1998, ndryshuar nga Rregullorja e Këshillit të Evropës Nr. 3696/93 mbi Klasifikimin statistikor të produkteve sipas Aktiviteteve (CPA).	http://www.instat.gov.al/media/1841/nomenklatura_e_produkteve_sipas_aktiviteteve.pdf
4	Nomenklatura e Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICO)	Vendim i Këshillit të Ministrave nr.515, datë 20.9.2017 për “Miratimin e zbatimit të klasifikimit të produkteve të konsumit sipas qëllimit (COICOP)”.	Rregullorja e Këshillit të Evropës Nr.1749/1999, datë 23 Korrik 1999 “Mbi klasifikimin e konsumit individual sipas qëllimit”.	http://www.instat.gov.al/media/3959/02_nomenklatura_coicop_5digit_i_plotë_final_al.pdf
5	Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Profesioneve (LKP) është një mjet për grupimin e vendeve të punës në grupe të përcaktuara qartë sipas detyrave të ndërmarra në punë.	Vendim i Këshillit të Ministrave nr.514, datë 20.9.2017 Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar	Rregullorja e Këshillit të Evropës Nr.1022/2009, datë 29 Tetor 2009 “Mbi Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Profesioneve”.	Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Profesioneve (LKP)
6	Klasifikimi i llojeve të Ndërtimit	Vendim i Këshillit të Ministrave nr.136, datë 20.3.2019 “Për Miratimin e Nomenklaturës së Klasifikimit të Llojeve të Ndërtimit (KN)		Klasifikimi i llojeve të Ndërtimit

7	Klasifikimi Standard i Mallrave për Statistikat e Transportit	Vendimi i KM Nr. 137, datë 20.03.2019 "Për miratimin e Nomenklaturës së Statistikave të Transportit".	Rregullorja e Komisionit Evropian Nr.1304/2007, datë 7 Nëntor 2007, amenduar me Direktivën e Këshillit Nr. 95/64, Rregulloren e Këshillit Nr. 1172/98, Rregulloret e KE Nr. 91/2003 dhe Nr. 1365/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me themelimin e NST 2007 si klasifikimin unik për mallrat e transportuara në mënyrat e caktuara të transportit.	<u>Nomenklatura Standarde e Transporte</u>
8	Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin	Vendimi i KM Nr. 135, datë 20.03.2019 "Për miratimin e Nomenklaturës Ndërkombëtare të Sëmundjeve ICD-10".		<u>Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin/Revizioni i 10-të/vëllimil</u> <u>Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin/Revizionimi i 10-të/vëllimil</u>
9	Klasifikimi i Shteteve dhe Territoreve për Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave dhe Ndarjen Gjeografike për Statistikat e Tjera të Biznesit. (GEONOM)	Vendimi i KM, Nr. 541, datë 29.09.2021 "Për miratimin e Nomenklaturës së Shteteve dhe të Territoreve për Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave dhe Ndarjen Gjeografike për Statistikat e Tjera të Biznesit"	Rregullore e Komisionit të Bashkimit Evropian 2020/1470, datë 12 Tetor 2020 mbi Nomenklaturën e Shteteve dhe Territoreve për Statistikat Evropiane për Tregtinë Ndërkombëtare të Mallrave dhe Ndarjen Gjeografike për Statistikat e Tjera të Biznesit.	<u>Klasifikimi i Shteteve dhe Territoreve për Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave dhe Ndarjen Gjeografike për Statistikat e Tjera të Biznesit. (GEONOM)</u>
10	Nomenklatura e produkteve sipas aktiviteteve	Baza ligjore kombëtare: Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 142, datë 11.3.2022 "Për miratimin e nomenklaturës së produkteve sipas aktiviteteve (NPA 2.1)"	Baza ligjore evropiane: Rregullorja e Komisionit Evropian (BE) Nr. 1209/2014 e datës 29.10.2014 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 451/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për vendosjen e një klasifikimi të ri statistikor të produkteve sipas aktivitetit (CPA) dhe duke shfuqizuar Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 3696/93	<u>Nomenklatura e produkteve sipas aktiviteteve</u>
11	Klasifikimi Standard i Arsimit, KSNA 2011 Fushat e	Baza ligjore kombëtare: Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 11.5.2022 "Për		<u>Klasifikimi Standard i Arsimit, KSNA 2011 Fushat e arsimit dhe trainimit, KSNA-F 2013</u>

	arsimit dhe trajnimit, KSNA-F 2013	miratimin e Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit KSNA 2011 (ISCED 2011), të fushave të Arsimit dhe të Trajnimit të KSNA 2013 (KSNA-F 2013) dhe të përshkrimeve të tyre të detajuara".		
--	------------------------------------	--	--	--